



Historia e tij mund të
ndryshojë tënden

Më shumë se zdrukthëtar

Mbi 15 milionë kopje të botuara

Khosh Mek-Dauell
Shon Mek-Dauell



Më shumë se zdrukthëtar

Khosh Mek-Dauell
Shon Mek-Dauell



Titulli në original: More Than a Carpenter
Copyright © 1977, 2005, 2009 by Josh McDowell.

Përktheu: Blerta Qiriazhi, Brunilda Rustani

Redaktoi: Blerta Qiriazhi

Përgatiti për botim: Afrim Karoshi

Copyright ©: Instituti Jeta e Re

ISBN: 978-99956-851-4-0



Instituti Jeta e Re,
K.P. 2420/1, Tirana, Shqipëri.
info@ijr.al
www.ijr.al

Kushtuar Dik dhe Çarlotë Deit,
jetët e të cilëve kanë reflektuar gjithmonë faktin
që Jezusi ishte më shumë se zdrukthëtar

Përmbajtja

Parathënie	7
Historia ime	9
Çfarë e bën Jezusin kaq të ndryshëm?	17
Zot, Gënjeshhtar apo i Çmendur	35
Po shkenca?	49
Sfida e Ateizmit të Ri	55
A janë të besueshme dokumentet biblike?	75
Kush do të vdiste për një gënjeshhtar?	103
Ç'na duhet një Mesi i vdekur?	119
A keni dëgjuar se çfarë i ndodhi Saulit?	127
A mund ta mposhtësh një njeri të mirë?	139
A mund të ngrihet më këmbë Mesia i vërtetë, ju lutem?	159
A nuk ka ndonjë rrugë tjetër?	171
Ai ndryshoi jetën time	179
Shënime	189
Rreth Autorit	197

Parathënie

Kur u ula fillimisht në vitin 1976 me dymbëdhjetë fletore, dyzet e tetë orë kohë të lirë dhe *shumë* kafe për të shkruar librin që do të bëhej *Zot, gënjeshhtar apo i çmendur*, shpresa ime ishte që ai t'i ndihmonte ndjekësit e Jezusit për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me besimin e tyre, dhe të frymëzonte ata që ishin në një kërkim shpirtëror për të hetuar me sinjeritet deklaratat e Jezusit. Nuk më shkonte mendja kurrë se historia e udhëtimit tim nga skepticizmi në besim do të shitej në më shumë se njëzet milion kopje, do të përkthehej në afro njëqind gjuhë dhe do të frymëzonte lexues anembanë botës për ta shqyrtuar më nga afër dhe më thellë mundësinë e besimit. Vazhdoj të ndihem i nderuar dhe i përlulur sa herë dikush më thotë se libri im ka patur ndikim në jetën e tij apo të saj. Megjithatë ende vazhdoj të mahnitem me sa shumë gjëra kanë ndodhur në botë që kur *Zot, gënjeshhtar apo i çmendur* doli në shtyp për herë të parë. Janë bërë (dhe vazhdojnë të bëhen) zbulime që hedhin dritë mbi historicitetin e Jezu Krishtit. “Ateistët e rinj” kanë hyrë në skenë me libra që shpallin fundin e besimit dhe përmbysjen e Perëndisë. Dhe ndërsa brezi i sotëm përballet me një mori të tërë çështjesh dhe zgjedhjesh të reja, pyetja e lashtë ende qëndron: Kush është Jezusi? Çfarë provash ka që ai ishte Biri i Perëndisë? Dhe nëse kjo është e vërtetë, çfarë do të thotë për jetën time?

Bazuar në gjithë këto, unë vendosa se ishte koha që ta ripunoja *Zot, gënjeshhtar apo i çmendur* për shekullin e 21-të. Kështu që ftova tim bir, Shonin, një folës i mirënjohur, mësues dhe autor mbi apologjetikën dhe Biblën, për ta ripunuar librin bashkë me mua. Shoni solli në tavolinë kredencialet e tij të forta akademike (dy diploma masteri, një në filozofi dhe një në teologji) bashkë me përvojën e tij si autor, duke hedhur një këndvështrim të mirëpritur mbi besimin postmodern. Të dy punuam për të krijuar një kapitull krejt të ri, rishikuam materialin, shtuam pyetjet e diskutimit, dhe i dhamë një pamje të freskët. Rezultati është një botim i ri i *Zot, gënjeshhtar apo i çmendur* që, megjithatë, ruan shijen origjinale të shqyrtimit me rigorozitet të fakteve dhe kërkimit pa kompromis për të vërtetën. Është dëshira ime dhe e Shonit që ky libër të ketë ndikim transformues në një brez të ri njerëzish që janë në kërkim të qartësisë shpirtërore.

—*XhM*

Historia ime

FILOZOFI I SHEKULLIT TË PESËMBËDHJETË, TOMAS AKUINAS shkruan: “Brenda çdo shpirti ekziston një etje për lumturi dhe kuptim.” Unë fillova ta ndieja këtë etje së pari kur isha adoleshent. Doja të isha i lumtur. Doja që jeta ime të kishte kuptim. Torturohesha nga ato tri pyetjet kyçe që s’i lënë rehat njerëzit: Kush jam? Pse jam këtu? Ku po shkoj? Doja përgjigjie, dhe kur isha student fillova të kërkoj për to.

Në vendin ku u rrita dukej sikur të gjithë ishin fetarë, kështu që mendova se mund t’i gjeja përgjigjet duke qenë fetar. Iu futa kishës 150 përqind. Shkoja në kishë sa herë që hapeshin dyert – në mëngjes, pasdite, në mbrëmje. Por me sa dukej nuk kisha zgjedhur kishën e duhur, sepse ndihesha më keq brenda sesa jashtë. Meqë isha rritur në një fermë në Miçigan, kisha trashëguar një praktikitet fshatarak që thotë se kur diçka nuk të jep rezultat, flake. Kështu që e flaka fenë.

Pastaj mendova se arsimi mund të kishte përgjigjet për kërkimin tim për kuptim, kështu që u regjistrova në universitet. Shpejt u bëra studenti më i papëlqyer për profesorët. I mbërtheja në zyrat e tyre dhe u kërkoja me këmbëngulje përgjigjet e pyetjeve. Kur më shikonin që vija, ata fiknin dritat, ulnin grilat dhe kyçnin dyert. Në universitet mund të mësosh shumë gjëra, por aty nuk i gjeta përgjigjet që po kërkoja. Stafi i fakultetit dhe bashkëstudentët kishin po aq probleme, zhgënjime dhe pyetje pa përgjigje sa edhe unë.



Si mendoni?

A jeni dakord me filozofin Tomas Akuinas se “Brenda çdo shpirti ekziston një etje për kuptim dhe lumturi”?

Një herë pashë një student që ecte në kampus me një bluzë që shkruante, “Mos më ndiq - jam i humbur.” Kështu më dukej kushdo në universitet. Pra arsimi, e vendosa, nuk ishte përgjigjia.

Fillova të mendoj se ndoshta mund të gjeja lumturi dhe kuptim në prestigj. Do të gjeja një kauzë fisnike, t'i përkushtohesha dhe duke e bërë këtë, të bëhesha i njohur në kampus. Njerëzit me më shumë prestigj në universitet ishin udhëheqësit studentorë, që gjithashtu kishin në kontroll edhe financat. Kështu që u zgjodha në disa poste studentore. Ishte interesante të njihja çdo njeri në kampus, të merrja vendime të rëndësishme, të shpenzoja paratë e universitetit duke thirrur folësit që doja dhe të shpenzoja paratë e studentëve duke organizuar mbrëmje argëtimi.

Por edhe ethet e prestigjit më lanë si çdo gjë tjetër që kisha provuar. Çohesha të hënën në mëngjes, zakonisht

me dhimbje koke nga nata e kaluar, duke patur frikë të përballës me pesë ditë të tjera të mjera. Duroja që nga e hëna deri të premten, duke jetuar vetëm për netët e të premtes, të shtunës dhe të dielës. Pastaj, të hënave fillonte përsëri cikli i pakuptimtë.

Nuk e bëja veten që jeta ime nuk kishte kuptim; isha shumë krenar. Të gjithë mendonin se isha njeriu më i lumtur në kampus. Nuk iu shkonte mendja kurrë se lumturia ime ishte shtirje. Ajo varej nga rrethanat. Nëse

**Të gjithë
mendonin se
isha njeriu
më i lumtur
në kampus.
Por jeta që po
jetoja ishte ferr.**

gjërat shkonin mirë, ndihesha mirë. Nëse gjërat shkonin keq, ndihesha keq, por thjesht nuk e tregoja.

Isha si një anije në oqean që e çonin dallgët andej-këtej. Nuk kisha timon – nuk kisha drejtim, as kontroll. Por nuk mund të gjeja ndonjë që jetonte ndryshe nga unë. Nuk mund të gjeja ndonjë që të më thoshte si të jetoja ndryshe. Isha i dëshpëruar. Jo isha më keq: ka një term të fortë që përshkruan jetën që jetoja – ferr.

Në atë kohë vura re një grup të vogël njerëzish – tetë studentë dhe dy anëtarë të personelit të fakultetit – që dukeshin ndryshe nga të tjerët. Ata dukeshin se e dinin cilët ishin dhe ku po shkonin. Ata kishin bindje. Është gjë e bukur të gjesh njerëz me bindje, dhe mua më pëlqen të rri me të tillë. Edhe kur nuk jam dakord me bindjet e tyre, i admiroj ata njerëz që besojnë në diçka dhe e mbrojnë atë gjë.

Ishte e qartë për mua që këta njerëz kishin diçka që unë nuk e kisha. Ata ishin neverisht të lumtur. Dhe

lumturia e tyre nuk ulej e ngrihej sipas rrethanave të jetës universitare; ishte konstante. Ata dukeshin se kishin një burim të brendshëm lumturie, dhe unë pyesja veten nga u vinte.



Si mendoni?

A ju pëlqen të rrini afër njerëzve që kanë bindje? Pse janë tërheqës këta njerëz? Pse ndonjëherë janë bezdisës?

Ishte edhe diçka tjetër që më tërhoqi vëmendjen tek ky grup. Ishin qëndrimet dhe veprimet ndaj njëri-tjetrit. Ata e donin me të vërtetë njëri-tjetrin, dhe jo vetëm njëri-tjetrin, por edhe njerëzit jashtë grupit të tyre.

Nuk po them që thjesht flisnin për dashurinë; ata përfshiheshin në jetët e njerëzve, duke i ndihmuar ata në nevojat dhe problemet që kishin. Kjo ishte diçka krejt e huaj për mua, e megjithatë më tërhiqte shumë.

Si shumica e njerëzve, kur shoh diçka që e dua por nuk e kam, filloj të mendoj për një mënyrë si mund ta kem. Kështu që vendosa të bëhesha shok me këta njerëz.

Pas disa javësh isha ulur në tavolinë në unionin studentor duke folur me disa prej tyre. Biseda u kthye

**“Krishtërimi!”
thashë. “Ai është
për të dobët e
mendjengushtë, jo
për intelektualët.”
Patjetër, nën gjithë
këtë maskë, unë
vërtet e doja atë
që ata kishin.**

tek Perëndia. Unë isha shumë dyshues dhe i pasigurt në lidhje me këtë temë, kështu që mora një pozë prej kapadaui. U mbështeta në karrige sikur nuk doja t’ia dija. “Krishtërimi!” thashë. “Ai është për të dobët e mendjengushtë, jo për

intelektualët.” Patjetër, nën gjithë këtë maskë, unë vërtet e doja atë që ata kishin, por krenaria nuk donte që ata ta dinin urgjencën e nevojës sime. Kjo temë më trazonte, por nuk e lija dot mënjanë. Kështu që iu ktheva një studenteje aty, një vajze simpatike (më parë mendoja se të gjithë të krishterët ishin të shëmtuar), dhe thashë, “Më thuaj, pse jeni kaq ndryshe nga gjithë studentët e tjerë në këtë fakultet dhe në qendrën studentore? Çfarë e ka shkaktuar këtë ndryshim në jetën tuaj?”

Pa hezitim dhe pa u vënë në siklet, ajo më pa drejt në sy, shumë serioze, dhe shqiptoi dy fjalë që nuk e prisja kurrë t’i dëgjoja në një diskutim inteligjent në një ambient universiteti: “Jezu Krishti.”

“Jezu Krishti?!” iu ktheva unë. “Oh, mos më fol për këto gjepura. Jam ngopur me fenë; jam ngopur me kishën; jam ngopur me Biblën.”

Po menjëherë ajo ma ktheu, “Nuk thashë feja, thashë Jezu Krishti,” Ajo vuri në dukje diçka që nuk e kisha ditur: Krishtërimi nuk është fe. Fe është kur njerëzit përpiqen të arrijnë tek Perëndia nëpërmjet veprave të mira. Krishtërimi është Perëndia që vjen tek njerëzit nëpërmjet Jezu Krishtit.

**Krishtërimi
nuk është
fe. Fe është
kur njerëzit
përpiqen të
arrijnë tek
Perëndia
nëpërmjet
veprave të mira.
Krishtërimi
është Perëndia
që vjen tek
njerëzit
nëpërmjet Jezu
Krishtit.**

Këtë nuk e haja. I shokuar pak nga guximi dhe bindja e fortë e asaj vajze i kërkoja falje për qëndrimin tim. “Por jam lodhur nga fetarët,” i shpjegova. “Nuk dua të kem të bëj me ta.”



Si mendoni?

Si do ta
përkufizonit ju
fenë?

Pastaj miqtë e mi të rinj më
bënë një sfidë të pabesueshme.
Ata më sfiduan të bëja një
shqyrtim rigoroz, intelektual të
pretendimeve të Jezu Krishtit –

që ai është Biri i Perëndisë; që ai banoi në një trup njeriu
dhe jetoi midis njerëzve të vërtetë; që vdiq në kryq për
mëkatet e njerëzimit; që u varros dhe u ringjall pas tri
ditësh; dhe që është ende i gjallë dhe mund ta ndryshojë
jetën e një njeriu edhe sot.

Mendova se kjo sfidë ishte shaka. Kushdo që kishte
pak mend e dinte se krishtërimi bazohej në një legjendë.
Unë mendova se vetëm një i mangët mund ta besonte se
Krishti ishte ringjallur. Unë e kisha zakon që prisja që të
fliste ndonjë i krishterë në klasën time që pastaj ta bëja

**Nëse u
demonstroja se
Bibla nuk ishte
historikisht e
besueshme,
atëherë mund
të demonstroja
se krishtërimi
ishte një fantazi
e sajuar nga
ëndërrues
fetarë.**

fërtele. Unë mendoja që nëse një i
krishterë kishte një qelizë truri, ajo
do të vdiste nga vetmia.

Por e pranova sfidën e miqve
të mi, kryesisht nga dëshira për të
vërtetuar që ata e kishin gabim. Unë
isha i bindur që historia e krishterë
nuk mund t'iu qëndronte provave.
Isha student juridiku dhe dija diçka
për provat. Do të hetoja pretendimet
e krishtërimin nga të gjitha anët dhe do të kthehesha t'iu
përmbysja shkopinj të ku mbështetej feja e tyre e rremë.

Vendosa të filloja me Biblën. E dija që po të zbuloja
prova të pakundërshtueshme që Bibla nuk është e

besueshme si dokument, i gjithë krishtërimi do të shkërmoqej. Patjetër, të krishterët mund të më tregonin që libri i tyre thoshte se Krishti kishte lindur nga një virgjëreshë, që bëri mrekulli, dhe që u ringjall nga vdekja. Por sa vlente kjo? Nëse u demonstroja se Bibla nuk ishte historikisht e besueshme, atëherë mund të demonstroja se krishtërimi ishte një fantazi e sajuar nga ëndërrues fetarë.

E mora seriozisht sfidën. Kalova muaj duke bërë kërkime. Madje lashë edhe shkollën për njëfarë kohe për të studiuar në bibliotekat e pasura me dokumente të Evropës.

Dhe gjeta prova. Prova me bollëk. Prova që nuk do t'i kisha besuar po të mos i kisha parë me sytë e mi. Më në fund mund të dilja vetëm në një përfundim. Po që se doja të isha i sinqertë intelektualisht, duhej ta pranoja se dokumentet e Dhiatës së Vjetër dhe të Re ishin nga shkrimet më të besueshme në gjithë lashtësinë. Dhe po që se ishin të besueshme, ç'mund të thoshim për këtë Jezus që e kisha hedhur mënjanë si një zdrukthëtar të zakonshëm që ishte i përpirë nga vizionet e tij të madhështisë në një qytet të harruar në një vend të vogël e të shtypur? Duhej ta pranoja se ai ishte më shumë se zdrukthëtar. Ai ishte ai që thoshte se ishte.

Kjo punë kërkimore jo vetëm që ndryshoi krejt qëndrimin tim intelektual, por iu përgjigj atyre tri pyetjeve

**Dhe gjeta
prova. Prova me
bollëk. Duhej
ta pranoja se
dokumentet
e Dhiatës së
Vjetër dhe të
Re ishin nga
shkrimet më
të besueshme
në gjithë
lashtësinë.**



Si mendoni?

Nëse Perëndia u
bë vërtet njeri, cila
do të ishte mënyra
më e mirë për të
komunikuar me
krijimin e Tij?

të cilat më shtynë t'i hyja
kërkimit për lumturi dhe
kuptim në jetë. Por siç thotë
Pol Harvi, kjo është “pjesa
tjetër e historisë.” Atë do
t’jua tregoj në fund të librit.

Në fillim dua t’ju tregoj thelbin e atyre që mësova në ato
muaj kërkimesh që edhe ju të shikoni që krishtërimi nuk
është përrallë, as fantazi utopike e disa ëndërrimtarëve,
dhe as një lojë në kurriz të naivëve. Është një e vërtetë
solide. Dhe ju garantoj se kur të filloni ta pranoni atë të
vërtetë, do të jeni në prag të gjetjes së përgjigjeve për ato
tri pyetjet: Kush jam? Cili është qëllimi im? Cili është fati
im?

Çfarë e bën Jezusin kaq të ndryshëm?

DISA KOHË PAS ZBULIMEVE TË MIA në lidhje me Biblën dhe krishtërimin, isha në një taksi në Londër dhe i thashë diçka për Jezusin shoferit. Menjëherë ai m'u kthye, "Nuk dua të flas për fenë, sidomos për Jezusin." Nuk mund të mos e vija re ngjashmërinë midis reagimit të tij dhe reagimit tim kur ajo vajza e krishterë më tha që Jezu Krishti i kishte ndryshuar jetën. Thjesht emri i Jezusit duket sikur i shqetëson njerëzit. I zë ngushtë, i zemëron, ose i bën të duan të ndryshojnë temë. Mund të flasësh për Perëndinë dhe nuk shqetësohet njeri, por zër në gojë Jezusin dhe njerëzit duan ta mbyllin bisedën. Pse nuk kanë të njëjtin efekt emrat e Budës, Muhamedit, Konfucit?

Unë mendoj se arsyeja është se këta udhëheqës fetarë nuk thanë se ishin Perëndi. Midis tyre dhe Jezusit ka ndryshim të madh. Njerëzve që e njohnin Jezusin nuk iu desh shumë ta kuptonin se ky zdrukthëtar nga Nazareti

po bënte deklaratat bombastike për veten e vet. U bë e qartë se ato deklaratat po e nxirrnin atë në pah si më shumë sesa thjesht profet apo mësues. Ai po thoshte se ishte hyjnor. Ai po e paraqiste veten si e vetmja rrugë e shpëtimit dhe i vetmi burim i faljes së mëkateve – gjëra që ata e dinin se vetëm Perëndia mund t'i shpallte për Vetën.

Për shumë njerëz sot kjo deklaratë është tepër ekskluzive. Në kulturën tonë pluraliste, ajo duket tepër e ngushtë dhe bie erë fanatizëm. Nuk duam ta besojmë. Megjithatë çështja nuk është çfarë duam të besojmë, por kush tha Jezusi se ishte. Dhe a është e vërtetë ajo që ai tha për veten e tij. Këtë shkova të gjeja kur e pranova sfidën nga miqtë e mi të universitetit.



Si mendoni?

Jezusi tha se ishte Biri i Perëndisë. Pse kjo temë diskutimi është problem për shumë njerëz? Pse është më e pranueshme të flasësh për Perëndinë sesa për Jezusin?

Fillova duke eksploruar gjithçka që mundesha në lidhje me dokumentet e Dhiatës së Re për të parë çfarë mund të na thoshin ato në lidhje me këto deklaratat. Fillova ta analizoja frazën, “hyjnia e Krishtit,” për të parë çfarë kuptimi kishte tamam deklaratat se Jezu

Krishti ishte Perëndi. A. H. Strong, ish-president i Seminarit Teologjik Roçester (Rochester Theological Seminary), në veprën e tij *Teologjia Sistematike* (*Systematic Theology*) e përkufizon Perëndinë si “shpirt i pafund dhe i përsosur në të cilin të gjitha gjërat kanë

burimin, mbështetjen dhe fundin.”¹ Ky përkufizim është i përshtatshëm jo vetëm për të krishterët, por për të gjithë teistët, duke përfshirë këtu myslimanët dhe hebrenjtë. Teizmi mëson se Perëndia është personal dhe se gjithësia u planifikua dhe u krijua prej Tij. Perëndia e mban dhe e sundon atë në të tashmen. Por teizmi i krishterë i shton përkufizimit edhe këtë: “dhe që u mishërua si Jezusi i Nazaretit.”

Jezu Krishti nuk është emri dhe mbiemri; është emri dhe titulli. Emri Jezus vjen nga forma greke e emrit hebraik *Jeshua* ose Joshua, që do të thotë “Jehova-Shpëtimtar” ose “Perëndia shpëton.” Titulli Krisht vjen nga fjala greke Hristos për fjalën hebraike Mesia (ose hebraisht *Mashiach*—Danieli 9:26)

**Emri “Jezus”
do të thotë
“Jehova –
Shpëtimtar”
ose “Zoti
shpëton.” Titulli
“Krisht” vjen
nga fjala greke
për Mesian dhe
do të thotë “I
vajosuri.”**

dhe do të thotë “i vajosuri.” Me këtë titull hebrenjtë nënkuptonin dy pozicione, atë të mbretit dhe të priftit. Ky titull e shpall Jezusin si prifti dhe mbreti i premtuar i profecive të Dhiatës së Vjetër. Kjo deklaratë është kyçe për ta kuptuar si duhet Jezusin dhe krishtërimin.

Dhiata e Re e paraqet qartë Krishtin si Perëndi. Emrat që i jepen Krishtit mund t’i jepeshin me të drejtë vetëm Perëndisë. Për shembull, Jezusi është quajtur drejtpërdrejt Perëndi në frazën, “duke pritur shpresën e lume dhe të shfaqurit e lavdisë të të madhit Perëndi dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.” (Tit 2:13; krahaso edhe Gjoni 1:1; Hebrenjve 1:8; Romakëve 9:5; 1 Gjonit 5:20,

21). Bibla i atribuon atij karakteristika që mund të jenë të vërteta vetëm për Perëndinë. Ajo e paraqet Jezusin si vetë-ekzistent (Gjoni 1:4; 14:6); të kudogjendur (Mateu 28:20; 18:20); të gjithëdijshëm (Gjoni 4:16; 6:64; Mateu 17:22-27); të gjithëfuqishëm (Zbulesa 1:8; Luka 4:39-55; 7:14, 15; Mateu 8:26, 27); dhe si ai që ka jetën e përjetshme (1 Gjoni 5:11, 12, 20; Gjoni 1:4).

**Jezusi mori
nderin
dhe adhurimin
që vetëm
Perëndia
duhet ta marrë.**

Jezusi mori nderin dhe adhurimin që vetëm Perëndia duhet ta marrë. Në një përballje me Satanin, Jezusi tha, "...sepse është shkruar: 'Adhuro Zotin, Perëndinë tënd, dhe shërbeji vetëm Atij'" (Mateu 4:10). Megjithatë

Jezusi pranoi adhurim si Perëndi (Mateu 14:33; 28:9) madje disa herë kërkoi të adhurohej si Perëndi (Gjoni 5:23; krahaso Hebrenjve 1:6; Zbulesa 5:8-14).

Shumica e ndjekësve të parë të Jezusit ishin hebrenj të devotshëm që besonin në një Perëndi. Ata ishin monoteistë deri në palcë, megjithatë, siç tregojnë shembujt e mëposhtëm, ata e pranuan atë si Perëndinë e mishëruar.

Apostulli Pal, për shkak të mësimëve të rij rabinike, do të ishte i fundit që t'i atribuonte Jezusit tipare hyjnore, që të adhuronte një njeri nga Nazareti dhe do ta quante atë Zot. Por Pali bën pikërisht këtë. Ai e quajti Jezusin Perëndi kur tha, "Tregoni kujdes, pra, për veten tuaj dhe për gjithë tufën, në mes të së cilës Fryma e Shenjtë ju ka vënë ju kujdestarë që të kullotni kishën e Perëndisë, të cilën ai e ka fituar me gjakun e tij" (Veprat 20:28).

Simon Pjetri rrëfeu, pasi Krishti e pyeti, “Kush mendon ti se jam unë?” dhe tha, “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë” (Mateu 16:16). Jezusi iu përgjigj rrëfimit të Pjetrit jo duke korigjuar përfundimin e tij, por duke e pohuar vlefshmërinë e tij dhe duke përmendur burimin nga e kishte marrë: “I lumur je ti, o Simon, bir i Jonas, sepse këtë nuk ta zbuloi as mishi as gjaku, por Ati im që është në qiej” (Mateu 16:17).

Marta, një mike e afërt e Jezusit, i tha, “Po, Zot, unë besoj se ti je Krishti, Biri i Perëndisë, që duhet të vinte në botë” (Gjoni 11:27). Pastaj kemi Natanaelin që i thoshte gjërat troç, që nuk besonte se mund të dilte ndonjë gjë e mirë nga Nazareti. Ai e pranoi para Jezusit, “Mësues, ti je Biri i Perëndisë, ti je mbreti i Izraelit!” (Gjoni 1:49).

Stefani, dëshmori i parë, kur po e vrisnin me gurë tha me zë të lartë, “Zot Jezus, pranoje frymën time” (Veprat 7:59). Autori i librit të hebrenjve e quan Krishtin Perëndi kur shkruan, “Ndërsa për të Birin thotë: ‘Froni yt, o Perëndi është në shekuj të shekujve; skeptri i mbretërisë sate është skeptër drejtësie.’” (Hebrenjve 1:8).

Pastaj patjetër kemi Thomain, të njohur më shumë si “Dyshuesi.” Ai tha, “Nuk besoj po nuk e vura dorën në shenjat e gozhdëve.” Unë identifikohem me Thomanë. Ai po thoshte pak a shumë, “Nuk ndodh përditë që një njeri të ngjallet nga të vdekurit apo të shpallë se është Perëndia në mish. Më duhen prova që të besoj.” Tetë ditë pasi Thomai u kishte shprehur dishepujve dyshimet në lidhje me Jezusin, “...Jezusi erdhi, ndonëse dyert ishin të mbyllura, dhe u prezantua midis tyre dhe tha: “Paqja

me ju!” Pastaj i tha Thomait: ‘Vëre gishtin këtu dhe shiko duart e mia; shtrije edhe dorën dhe vëre në brinjën time; dhe mos ji mosbesues, por besues!’ Atëherë Thomai u përgjigj dhe i tha: ‘Zoti im dhe Perëndia im!’

Jezusi i tha: ‘Sepse më ke parë, Thoma, ti ke besuar; lum ata që nuk kanë parë dhe kanë besuar!’” (Gjoni 20:26-29). Jezusi e pranoi adhurimin e Thomait. Ai e qortoi Thomain për mosbesimin, jo për adhurimin.



Si mendoni?

A do ta konsideronit veten më shumë si Marta (gjithmonë me besim), një Thoma (dysgues), apo një Nataniel (cinik) në lidhje me qëndrimin rreth Jezusit?

Në këtë pikë një kritik mund të ndërhyjë e të thotë se të gjitha këto thënie janë nga të tjerët për Krishtin, dhe jo nga Krishti për veten e Tij. Njerëzit që jetonin në kohën e Krishtit e keqkuptuan atë siç e keqkuptojmë edhe sot. Ata i atribuon atij tipare

hyjnore, por ai vetë nuk tha se ishte Perëndi.

Kur gërmojmë më thellë në faqet e Dhiatës së Re, shohim se ai vërtet e shpalli një gjë të tillë. Referencat janë të bollshme dhe kuptimi i qartë. Një biznesmen që e hetoi me kujdes Dhiatën e Re për të verifikuar nëse Krishti shpalli se ishte Perëndi tha, “Të lexosh Dhiatën e Re dhe të mos arrish në përfundimin se Jezusi shpalli se ishte hyjnor, është sikur të dalësh jashtë në një ditë me diell dhe të thuash ‘nuk e shoh diellin.’”

Në ungjillin e Gjonit na jepet një konfrontim midis Jezusit dhe një grupi judenjsh. Konfrontimi nisi për shkak se Jezusi kishte shëruar një të çalë të shtunën.

(Judenjve u ndalohej të bëjnë punë të shtunën.) “Për këtë Judenjtë e përndiqnin Jezusin dhe kërkonin ta vrisnin, sepse bënte këto gjëra të shtunave. Por Jezusi u përgjigj atyre: “Im Atë vepron deri më tash, e edhe unë veproj.” Për këtë Judenjtë kërkonin edhe më tepër ta vrisnin, sepse jo vetëm se shkelte të shtunën, por edhe se thoshte se Perëndia ishte ati i vet, duke e barazuar veten me Perëndinë” (Gjoni 5:16-18).

Mund të thoni, “Po kjo nuk provon ndonjë gjë. Jezusi e quajti Perëndinë Atin e tij. E çfarë pastaj? Të gjithë të krishterët e quajnë Perëndinë Atin e tyre, por me këtë nuk po thonë se janë Perëndi.” Por judenjtë e kohës së Jezusit kuptuan nga fjalët e Jezusit diçka që ne nuk e kuptojmë sot. Sa herë



Si mendoni?

Sipas mendimit tuaj, pse ishin udhëheqësit hebrenj aq të zemëruar me Jezusin pasi ai kishte kryer një shërim të shtunën? A ishin të zemëruar për shkak se shërimi ndodhi në një ditë të shenjtë apo kishte ndonjë arsye tjetër?

që studiojmë një dokument, duhet të marrim parasysh gjuhën, kulturën, dhe veçanërisht personin apo personat të cilëve u drejtohet ky dokument. Në këtë rast, kultura është hebreje, dhe personat të cilëve u drejtohet janë udhëheqës fetarë judenj. Dhe nga fjalët e Jezusit diçka vërtet i irritoi. “Për këtë Judenjtë kërkonin edhe më tepër ta vrisnin, sepse jo vetëm se shkelte të shtunën, por edhe se thoshte se Perëndia ishte ati i vet, duke e barazuar veten me Perëndinë” (Gjoni 5:18). Çfarë tha Jezusi që shkaktoi

Mund të thoni, “Po kjo nuk provon ndonjë gjë. Jezusi e quajti Perëndinë Atin e tij. E çfarë pastaj? Të gjithë të krishterët e quajnë Perëndinë Atin e tyre, por me këtë nuk po thonë se janë Perëndi.”

një reagim kaq të fortë? Le të marrim pasazhin dhe të shikojmë si i kuptuan judenjtë fjalët e Jezusit 2,000 vjet më parë në kulturën e tyre.

Problemi i tyre ishte se Jezusi tha “Ati *im*,” dhe jo “Ati *ynë*.” Sipas rregullave të gjuhës së tyre, përdorimi i kësaj fraze nga Jezusi ishte shpallje se Ai ishte i barabartë me Perëndinë. Hebrenjtë nuk i referoheshin Perëndisë si “Ati im.” Ose nëse do ta thoshin këtë, gjithmonë do ta përcaktonin deklaratën duke shtuar, “në qiell.” Por Jezusi nuk e shtoi atë frazë. Ai bëri një shpallje që judenjtë nuk mund ta keqinterpretinin kur e quajti Perëndinë “Ati im.”

Edhe më keq akoma, duke thënë, “Im Atë vepron deri më tash, e edhe unë veproj” Jezusi po e vendoste veprimtarinë e tij në një plan të barabartë me atë të Perëndisë. Përsëri, judenjtë e kuptuan se ai po shpallte se ishte Biri i Perëndisë. Si rezultat, urrejtja e tyre për të u rrit. Nëse më parë ishin munduar thjesht ta përndiqnin, tani filluan të dëshironin ta vrisnin.

Jezusi jo vetëm që shpalli barazi me Perëndinë kur e quajti ‘Ati i tij,’ por tha edhe se ishte një me Atin. Gjatë Festës së Përkushtimit në Jerusalem disa nga udhëheqësit e tjerë judenj iu afruan dhe e pyetën nëse ishte Krishti. Jezusi i mbylli komentet e tij duke thënë, “Unë dhe Ati jemi një” (Gjoni 10:30). “Prandaj Judenjtë

morën përsëri gurë për ta vrarë me gurë. Jezusi u përgjigj atyre: ‘Ju tregova shumë vepra të mira nga Ati im; për cilën nga këto më vrisni me gurë?’ Judenjtë u përgjigjën duke thënë: “Ne nuk të vrasim me gurë për asnjë vepër të mirë, po për blasfemi, dhe sepse ti, duke qenë njeri, e bën veten Perëndi” (Gjoni 10:31-33).

Ndoshta mund të pyesni veten pse reaguesit aq fort judenjtë kur Jezusi tha se ishte një me Atin. Struktura e frazës në greqisht na jep një përgjigje. A. T. Robertson, studiuesi më i shquar i kohës së tij, shkruan se në greqisht “një” në këtë pasazh është në gjininë asnjënjë, jo mashkullore, dhe nuk tregon një në person apo qëllim, por një në “thelb ose në natyrë.” Robinsoni pastaj shton, “Kjo deklaratë pikante është kulmi i shpalljeve të Krishtit për sa i përket marrëdhënies midis Atit dhe atij [Birit]. Kjo i inatosi farisenjtë pa masë.” ²

Është e dukshme se në këtë deklaratë judenjtë e dëgjuan qartë se Jezusi shpalli se ishte Perëndi. Kështu Leon Morris, ish-drejtor i Ridli Kollixh (Ridley College) në Melburn, shkruan, “judenjtë mund t’i merrnin fjalët e Jezusit vetëm si blasfemi, dhe e morën gjykimin në duart e tyre. Në Ligj ishte shkruar se ai që blasfemonte duhej vrarë me gurë (Levitiku 24:16). Por këta njerëz nuk po lejonin që procesi që kërkonte ligji të merrte rrugën e vet. Ata nuk po përgatitnin një aktakuzë në mënyrë që autoritetet të ndërmerrnin veprimet e duhura. Në zemërimin e tyre ata po përgatiteshin të ishin edhe gjykatës, edhe ekzekutues.”³

Judenjtë e kërcënuan Jezusin për ta vrarë me gurë për “blasfemi,” gjë që na tregon se ata e kuptuan patjetër

shpalljen e tij se ishte Perëndi. Por, mund të pyesim ne, a ndaluan ata për të shqyrtuar nëse kjo deklaratë ishte e vërtetë?

Ata që thonë se Jezusi ishte thjesht më afër ose më ngushtë me Perëndinë sesa të tjerët duhet ta marrin parasysh këtë deklaratë të tij, “Nëse nuk më nderoni siç nderoni Atin, ju nuk nderoni asnjërin prej nesh.”

Jezusi shpalli në mënyra të ndryshme se ishte një në thelb dhe natyrë me Perëndinë. Ai tha troç, “Po të më njihnit mua, do të njihnit edhe Atin tim” (Gjoni 8:19). “Dhe kush më sheh mua, sheh atë që më ka dërguar” (Gjoni 12:45). “Kush më urren mua, urren edhe Atin tim” (Gjoni 15:23). “...që të gjithë ta nderojnë Birin ashtu siç nderojnë Atin; kush nuk e nderon Birin, nuk nderon Atin që e ka dërguar” (Gjoni 5:23). Këto referenca tregojnë pa asnjë ekuivok

se Jezusi e konsideronte veten më shumë sesa thjesht njeri; ai shpalli se ishte i barabartë me Perëndinë. Ata që thonë se Jezusi ishte thjesht më afër ose më ngushtë me Perëndinë sesa të tjerët duhet ta marrin parasysh këtë deklaratë të tij, “Nëse nuk më nderoni siç nderoni Atin, ju nuk nderoni asnjërin prej nesh.”

Kur po jepja leksion në një orë letërsie në Universitetin e Uest Virxhinias, një profesor më ndërpreu dhe tha se i vetmi ungjill në të cilin Jezusi shpalli se ishte Perëndi, ishte ungjilli i Gjonit, dhe ai ishte shkruar më vonë se të tjerët. Ai pastaj tha se ungjilli sipas Markut, që ishte më i hershmi, nuk e përmend asnjëherë që Jezusi shpalli se ishte Perëndi. Ky njeri thjesht nuk e kishte lexuar me kujdes Markun.

Për t'iu përgjigjur u ktheva tek ungjilli i Markut ku Jezusi tha se falte mëkatet. “Jezusi, kur pa besimin e tyre, i tha të paralizuarit: ‘O bir, mëkatet e tua të janë falur!’” (Marku 2:5; shih edhe Luka 7:48-50). Sipas teologjisë hebreje vetëm Perëndia mund ta thoshte një gjë të tillë; Isaia 43:25 e kufizon faljen e

mëkateve si një të drejtë vetëm të Perëndisë. Kur skribët dëgjuan që Jezusi po i falte mëkatet atij njeriu, ata thanë, “Pse vallë ky po flet blasfemi? Kush mund të falë mëkatet, veç Perëndisë vetë?” (Marku 2:7). Pastaj Jezusi pyeti çfarë do të ishte më e lehtë t'i thuhej paralitikut, “Mëkatet të janë falur,” apo “ngrihu, merre vigun tënd dhe ec”?

Sipas Komentarit *The Wycliffe Bible Commentary*, kjo është “një pyetje që nuk mund të marrë përgjigje. Si fraza të dyja janë njëlloj të lehta për t'u shqiptuar, por t'i thuash ato duke i bërë, kërkon fuqi hyjnore. Një që shtirej, patjetër, për të mos u zbuluar, do të kishte më të lehtë të parën. Por Jezusi e shëroi sëmundjen që njerëzit ta dinin se ai kishte autoritet për t'u marrë me shkaqet e saj.”⁴ Në këtë moment, udhëheqësit fetarë e akuzuan për blasfemi. Luis Sperry Çefër (Lewis Sperry Chafer), themelues dhe president i parë i Seminarit Teologjik të Dallasit, shkruan,

Si mendoni?

Hebrenjtë donin të godisnin me gurë Jezusin për blasfemi. A po i brente ndërgjegjia për shkak të mosbesimit që i shtynte drejt ndëshkimit të Jezusit? Apo thjesht ishin xhelozë për shkak të popullaritetit të tij?



Si mendoni?

Në këtë rast, pse mendoni që Jezusi i tha të paralizuarit: “Mëkatet e tua të janë falur”, në vend që ti thoshte: “Ngrihu dhe ec!”

“Askush në tokë nuk ka as autoritetin, as të drejtën të falë mëkatet. Askush nuk mund t’i falë mëkatet përveç Atij kundër të Cilit të gjithë kanë mëkatuar. Kur Krishti fali mëkat, siç bëri, Ai nuk

po ushtronte një të drejtë njerëzore. Meqenëse askush nuk mund të falë mëkatet përveç Perëndisë, atëherë pa asnjë dyshim demonstrohet se Krishti, meqë fali mëkate, është Perëndi.” ⁵

Ky koncept i faljes më ngacmoi për shumë kohë, sepse nuk e kuptoja. Një ditë, në orën e filozofisë, në përgjigjie të një pyetjeje për hyjninë e Krishtit, unë citova vargjet e mësipërme nga Marku. Një asistent e sfidoi përfundimin tim se falja e mëkateve nga Krishti tregonte hyjninë e tij. Ai tha që edhe vetë mund të falte njerëzit, por kjo nuk tregonte se ishte Perëndi. Njerëzit falin gjithë kohës. Ndërsa mendohesha mbi ato që thoshte ai, papritur më erdhi në mendje përgjigjia. E kuptova pse udhëheqësit fetarë reagueshan aq ashpër kundër Krishtit. Po, dikush mund të thotë, “të kam falur,” por vetëm nëse mëkati është bërë ndaj tij. Nëse ti mëkaton kundër meje, unë kam të drejtën të të fal. Por nëse ti mëkaton ndaj dikujt tjetër, unë nuk e kam këtë të drejtë. Paralitiku nuk kishte mëkatuar ndaj njeriut Jezus; ata as nuk ishin takuar më parë. Ai kishte mëkatuar ndaj Perëndisë. Dhe Jezusi me autoritetin e tij i tha, “Mëkatet të janë falur.” Po, mund të falim mëkate që janë bërë kundër nesh, por në asnjë

mënyrë nuk mund të falim mëkate që janë bërë ndaj vetë Perëndisë. Megjithatë Jezusi tha se e bëri këtë.

Nuk është çudi që judenjtë reaguan aq ashpër kur një zdrukthëtar nga Nazareti bëri një deklaratë aq të fuqishme. Kur ai tha se mund të falte mëkatet, ai po ushtronte, për habinë e atyre që e dëgjuan, një të drejtë që i takonte vetëm Perëndisë.

Gjithashtu në Ungjillin e Markut kemi edhe gjyqin e Jezusit (14:60-64). Zhvillimi i gjyqit përmban disa nga shpalljet më të qarta të Jezusit për hyjninë e tij. “Atëherë kryeprihti u ngrit në mes të kuvendit dhe e pyeti Jezusin duke thënë: ‘Nuk përgjigjesh fare? Çfarë po dëshmojnë këta kundër teje?’ Por ai heshti dhe nuk u përgjegj fare. Përsëri kryeprihti e pyeti dhe i tha: ‘A je ti Krishti, Biri i të Bekuarit?’ Dhe Jezusi tha: ‘Unë jam. Dhe ju do ta shihni Birin e njeriut të ulur në të djathtën e Pushtetit dhe duke ardhur me retë e qiellit.’ Atëherë kryeprihti, duke i shqyer rrobat, tha: ‘Ç’nevojë kemi më për dëshmitarë? Ju e dëgjuat blasfeminë, ç’ju duket?’ Dhe të gjithë gjykuan se meritonte vdekjen.”

Në fillim Jezusi nuk u përgjigj, kështu që kryeprihti e vuri në betim. Duke qenë nën betim, Jezusi duhej

Mund të falim mëkate që janë bërë kundër nesh, por në asnjë mënyrë nuk mund të falim mëkate që janë bërë ndaj vetë Perëndisë. Megjithatë Jezusi tha se e bëri këtë.



Si mendoni?

A jeni dakord që mëkatet e kryera kundërt Perëndisë s'mund të falen nga askush tjetër përveç atij?

të përgjigjej (dhe jam shumë i gëzuar që u përgjigj). Ai iu përgjigj pyetjes, “A je ti Krishti, Biri i Perëndisë së bekuar?” duke thënë, “Unë jam.”

Referenca e Jezusit për “Birin e Njeriut” që do të vinte “me retë e qiellit” ishte një aluzion nga Danieli 7:13-14:

“Unë shikoja disa vegime nate, dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i ditëve dhe iu afrua atij. Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që gjithë popujt, kombet dhe gjuhët t'i shërbenin; sundimi i tij është një sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë, dhe mbretëria e tij është një mbretëri që nuk do shkatërrohet kurrë.”

Njerëzit zakonisht e keqkuptojnë këtë, por termi “Biri i Njeriut” nuk ishte referencë për anën njerëzore të Jezusit, por për anën hyjnore. Kur Jezusi iu referua vetes si Biri i Njeriut ai po i referohej hyjnisë së tij. Në librin *Putting Jesus in His Place (Vendosja e Jezusit në vendin e tij)*, Rob Bauman dhe Ed Komosevski shpjegojnë si lidhet kjo me vizionin e Danielit:

Në vizionin e Danielit figura që dukej si njeri zotëron gjithë autoritetin për të gjykuar dhe sundon mbi një mbretëri të përjetshme. Nuk e shohim aty nocionin e delikatesës dhe varësisë. Edhe përshkrimi i tij si dikush që vinte mbi retë e qiellit e identifikon atë si hyjnor, meqenëse kudo tjetër në Dhiatën e Vjetër imazhi i ardhjes

mbi re përdoret në mënyrë ekskluzive për figura hyjnore. ⁶

Kështu, në aluzionin ndaj Danielit 7:13, Jezusi po shpallte se ishte një figurë qiellore, hyjnore, që do të ulej në të djathtën e Perëndisë, dhe do të ushtronte autoritet suprem mbi të gjithë njerëzit në përjetësi. Prandaj autoritetet judeje u shqetësuan aq shumë – Jezusi kishte kryer blasfemi duke shpallur se ishte Perëndi! Është e qartë se Jezusi ishte i vetëdijshëm për hyjninë e tij.

Një analizë e dëshmisë së Krishtit tregon se ai shpalli se ishte (1) Biri i të Bekuarit Perëndi; (2) Ai që do të ulej në të djathtë të pushtetit, dhe (3) Biri i Njeriut që do të vinte mbi retë e qiellit. Secili nga këto pohime është qartësisht mesianik. Efekti i të treve bashkë është i jashtëzakonshëm. Sinedri, këshilli i lartë i judenjve, i kapi të tre këto pohime, dhe kryepriifti reagoi duke grisur rrobat dhe duke thënë, “Ç’na duhen dëshmitarët?” Ata më në fund e kishin dëgjuar me veshët e tyre nga goja e tij. Ai u dënua nga vetë fjalët e tij.

Sër Robert Anderson, që ka qenë shef i kriminalistikës në Skotland Yard (Scotland Yard – Policia metropolitane e Londrës), vë në dukje: “Asnjë provë mbështetëse nuk është më bindëse se ajo e dhënë nga dëshmitarë armiqësorë, dhe fakti që Zoti pohoi se ishte hyjnor vërtetohet në mënyrë të padiskutueshme nga veprimi i armiqve të Tij. Duhet të kujtojmë se hebrenjtë nuk ishin ndonjë fis i egër e i paditur, por një popull me shumë kulturë dhe shumë fetarë; dhe vdekja e Tij u dekretua pa

asnjë votë kundra pikërisht mbi këtë akuzë nga Sinedri – këshilli i lartë kombëtar – i përbërë nga udhëheqës të shquar fetarë, duke përfshirë njerëz si Gamalieli, filozofi i madh i shekullit të parë, dhe nxënësi i tij i famshëm, Sauli i Tarsit.”⁷

Është e qartë, pra, se kjo ishte dëshmia që Jezusi donte të jepte për veten. Ne shohim gjithashtu se hebrenjtë e kuptuan përgjigjen e tij si një shpallje se ai ishte Perëndi. Në këtë moment ata kishin përballë dy alternativa: që fjalët e tij ishin blasfemi flagrante, ose që ai ishte Perëndi. Gjykatësit e tij e panë qartë këtë – aq qartë sa e kryqëzuan dhe pastaj e tallën se “Ai ka besuar në Perëndinë; le ta lirojë tani në qoftë se e do me të vërtetë, sepse ka thënë: ‘Unë jam Biri i Perëndisë’” (Mateu 27:43).

H. B. Suit (Swete), ish profesor Regius i teologjisë në Universitetin e Kembrixhit, shpjegon domethënien e grisjes së rrobave nga kryepriifti: “Ligji e ndalonte



Si mendoni?

Në një farë mënyre, a nuk duket sikur reagimi i udhëheqësve hebrenj kundër deklaratave të Jezusit, në fakt, i bën të vërteta ato? Nëse do të kishit qenë njëri prej këtyre udhëheqësve si do të kishit reaguar?

Kryepriiftin t'i griste rrobat për çështje private (Levitiku 10:6; 21:10), por kur vepronte si gjykatës, zakoni e donte që të shprehte në këtë mënyrë tmerrin për ndonjë blasfemi të shqiptuar në praninë e tij. Lehtësimi i tij është i dukshëm. Nëse deri tani nuk kishte prova të besueshme, tani nuk ka

më nevojë për to: i burgosuri akuzoi veten.”⁸

Në fillojmë të shohim se ky nuk ishte gjyq i zakonshëm. Siç vë në dukje avokati Ērvin Linton (Irwin Linton), “Ky gjyq është unik midis gjyqeve kriminale sepse çështja këtu nuk janë veprimet e të akuzuarit, por identiteti i tij. Akuza ndaj Krishtit, rrëfimi apo dëshmia, apo më mirë veprimi në prani të gjyqit mbi të cilin u dënua, marrja në pyetje nga guvernatori romak dhe tabela mbi kryq në kohën e ekzekutimit kanë të bëjnë me çështjen e vetme të identitetit dhe dinjitetit të vërtetë të Krishtit. ‘Ç’mendoni për Krishtin? Biri i kujt është ai?’”⁹

Ish gjyqtari i Gjykatës së Lartë të Nju Jorkut, Uilliam Xhei Gejnor (William Jay Gaynor) në fjalimin e tij mbi gjyqin e Jezusit, mbron pozicionin se blasfemia ishte e vetmja akuzë që iu bë atij para Sinedrit. Ai thotë: “Është e qartë nga secili prej ungjijve se krimi për të cilin Jezusi u gjykua dhe u dënua ishte blasfemia:...Jezusi kishte shpallur se kishte pushtet të mbinatyrshëm, që për një qenie njerëzore është blasfemi”¹⁰.

Në shumicën e gjyqeve, i akuzuari gjykohet për ato që ka bërë, por nuk ishte kështu në gjyqin e Jezusit. Ai u gjykua për atë që thoshte se ishte.

Gjyqi i Jezusit duhet të jetë i mjaftueshëm për të demonstruar në mënyrë bindëse se ai rrëfeu hyjninë e tij. Gjykatësit e tij e vërtetojnë këtë. Por gjithashtu, në ditën e

Në shumicën e gjyqeve, i akuzuari gjykohet për ato që ka bërë, por nuk ishte kështu në gjyqin e Jezusit. Ai u gjykua për atë që thoshte se ishte.

kryqëzimit të tij, armiqtë e tij e pranuan se ai shpalli se ishte Perëndia i ardhur në mish. “Po ashtu, edhe krerët e priftërinjve, bashkë me skribët dhe me pleqtë, duke e tallur, i thonin: ‘Ai i shpëtoi të tjerët dhe nuk mund të shpëtojë vetveten; në qoftë se është mbreti i Izraelit, le të zbresë tani nga kryqi dhe ne do të besojmë në të; ai ka besuar në Perëndinë; le ta lirojë tani në qoftë se e do me të vërtetë, sepse ka thënë: ‘Unë jam Biri i Perëndisë.’” (Mateu 27:41-43).

Zot, Gënjeshtar apo i Çmendur

PO QE SE DO TË BËJE NJË KËRKIM NË INTERNET PËR EMRIN JEZUS do të dilnin 181 milion referenca. Kërko për këtë emër në Amazon.com dhe do të gjesh 261 474 libra për të. Duke patur parasysh shumëllojshmërinë e pikëpamjeve mbi të, a është e mundur të jemi të sigurt për Jezusin historik? Shumë njerëz duan ta konsiderojnë Jezusin jo si Perëndi, por si një njeri të mirë e të moralshëm, ose si një profet me urtësi dhe zbulesë të jashtëzakonshme, që tha shumë të vërteta të thella. Studiuesit shpesh lënë të kuptohet se ky është i vetmi konkluzion i pranueshëm që mund të arrish nëpërmjet procesit intelektual. Shumë njerëz thjesht tundin kokën në shenjë miratimi dhe nuk e marrin asnjëherë mundimin të shohin gabimin logjik të këtij arsyetimi.

Jezusi shpalli se ishte Perëndi, dhe për të ishte me rëndësi themelore që njerëzit ta besonin këtë. Ose e besojmë, ose nuk e besojmë. Ai nuk na ka lënë hapësirë

për alternativa të ndërmjetme. Një njeri që shpall ato që ai shpalli për veten e tij nuk mund të jetë një njeri i mirë e i moralshëm apo profet. Kjo mundësi nuk ekziston dhe Jezusi nuk kishte ndër mend që të ajo të ekzistonte.

Si. Es. Luis (C.S.Lewis), profesor në Universitetin e Kembrixhit dhe dikur agnostik, e kuptoi qartë këtë çështje. Ai shkroi,

“Po përpiqem këtu të parandaloj ndonjë të thotë marrëzinë që njerëzit e thonë shpesh për Të: ‘Jam gati ta pranoj Jezusin si një mësues të madh morali, por nuk e pranoj shpalljen e Tij se është Perëndi.’ Kjo është e vetmja gjë që nuk duhet ta themi. Një njeri që ishte thjesht njeri dhe tha ato gjëra që tha Jezusi nuk mund të ishte një mësues i madh morali. Ai ose do të ishte i çmendur, ose do të ishte Djalli i Ferrit. Duhet të zgjidhni. Ose ky njeri ishte dhe është Biri i Perëndisë, ose përndryshe është i çmendur, apo edhe më keq se kaq.”

Pastaj Luis shton:

“Mund ta mbyllësh në çmendinë, mund ta pështysh dhe ta vrasësh si djall, ose mund t’i biesh tek këmbët dhe ta quash Zot dhe Perëndi. Por të mos dalim me marrëzira të tilla “dashamirëse” se ishte një mësues i madh njerëzor. Ai nuk na e ka lënë këtë mundësi dhe nuk e kishte ndër mend të na e linte.”¹

Profesori i Universitetit të Kembrixhit F. J. A. Hort,

që u mor për njëzet e tetë vjet me një studim kritik të Dhiatës së Re, shkruan:

“Fjalët e Tij ishin aq të lidhura ngushtë me Të, saqë nuk kishin kuptim si deklarata abstrakte të së vërtetës të thëna prej Tij si orakull apo profet hyjnor. Hiqi Atë si kryefjala kryesore (megjithëse jo më e larta) e çdo deklarate, dhe ato nuk qëndrojnë.”²

Sipas Keneth Skot Laturet (Kenneth Scott Latourette), historian i krishtëritimit në Universitetin e Jejlit (Yale University):

“Nuk janë mësimet e tij ato që e bëjnë Jezusin aq të veçantë, megjithëse ato do të mjaftonin për ta dalluar. Është një kombinim i mësimëve me personin vetë. Të dy nuk mund të ndahen.” Laturet arrin në përfundimin, “Duhet të jetë e qartë për çdo lexues të vëmendshëm të ungjijve se Jezusi i konsideronte veten e tij dhe mesazhin e tij si të pandashëm. Ai ishte një mësues i madh, por ishte më shumë se kaq. Mësimet e tij për mbretërinë e Perëndisë, për sjelljen njerëzore dhe për Perëndinë ishin të rëndësishme, por ato nuk mund të ndaheshin prej tij – sipas këndvështrimit të tij – pa u zhvlerësuar.”³

Jezusi shpalli se ishte Perëndi. Kjo mund të jetë e vërtetë ose e rreme, dhe kushdo duhet të mendohet për këtë po aq sa duhej të mendoheshin dishepujt e tij kur

Jezusi i pyeti: “Kush thoni ju se jam unë?” (Mateu 16:15). Ka disa alternativa.

Së pari, ta zëmë se deklarata e tij se ishte Perëndi ishte e rreme. Nëse ishte e rreme, kemi dy dhe vetëm dy alternativa. Ai ose e dinte që ishte e rreme, ose nuk e dinte që ishte e rreme. Do të shikojmë secilën mundësi veç e veç dhe të shqyrtojmë provat për to.

A ISHTE GËNJESHTAR?

Nëse, kur Jezusi i bëri ato deklarata e dinte se nuk ishte Perëndi, atëherë ai po gënjente, dhe me qëllim po i mashtronte ndjekësit e tij. Por nëse ishte gënjeshtar, ishte edhe hipokrit sepse i mësoi të tjerët të ishin të ndershëm

Por të mos përfundojmë në marrëzira të tilla “dashamirëse” se ishte një mësues i madh njerëzor. Ai nuk na e ka lënë këtë mundësi dhe nuk e kishte ndër mend të na e linte.”

me çdo kusht, kurse vetë jetonte një gënjeshtër të madhe. Edhe më keq se kaq, ai duhej të ishte djall, sepse u tha të tjerëve t'i besonin për fatin e tyre të përrjetshëm. Nëse nuk i mbështeste dot thëniet e tij dhe e dinte këtë, atëherë ishte shumë i keq derisa i mbante ndjekësit e tij me një shpresë të tillë të rreme. Së fundi, duhej të ishte edhe i marrë, sepse deklaratat e tij se ishte Perëndi e çuan në kryq – deklarata nga të cilat

kishte mundësi deri në minutën e fundit të tërhiqej për të shpëtuar jetën.

Habitem kur dëgjoj aq shumë njerëz që thonë se Jezusi ishte thjesht një mësues i mirë morali. Të jemi

realistë. Si mund të ishte mësues i madh morali dhe me qëllim t'i gënjente njerëzit në lidhje me pikën më të rëndësishme të mësimit të tij – identitetin e tij?

Të arrish në përfundimin se Jezusi gënjeu me qëllim nuk

përkon me atë që dimë për të dhe për rezultatet e jetës dhe mësimet e tij. Kudo ku është treguar për Jezusin, jetët e njerëzve kanë ndryshuar për mirë, kombet kanë ndryshuar për mirë, hajdutët janë bërë njerëz të ndershëm, alkoolikët kanë lënë pijen, persona që urrenin janë bërë njerëz që duan, të padrejtët janë bërë të drejtë.

Uilliam Leki (William Lecky), një nga historianët më të shquar të Britanisë së Madhe dhe kundërshtar i përkushtuar i krishtëritimit të organizuar shkruan:

“I ishte rezervuar krishtëritimit t'i paraqiste botës një ideal i cili, nëpër gjithë ndryshimet e tetëmbëdhjetë shekujve, ka frymëzuar zemrat e njerëzve me një dashuri të zjarrtë, e ka treguar veten të aftë për të vepruar në të gjitha moshat, kombet, temperamentet dhe kushtet, ka qenë jo vetëm shembulli më i lartë i virtytit, por edhe nxitësi më i madh për praktikimin e tij... Të dhënat e atyre tre viteve të shkurtër të jetës së tij aktive kanë bërë më shumë për të rigjeneruar



Si mendoni?

Pse nuk ka shumë kuptim të themi që Jezusi ishte një mësues i mirë morali? A mund të mendoni për ndonjë “mësim morali” të veçantë që Jezusi jua mësoi pasuesve të tij, që akoma ka kuptim sot?

dhe zbutur njerëzimin sesa të gjithë referatet e filozofëve dhe gjitha nxitjet e moralistëve.”⁴

Historiani Filip Shaf (Philip Schaff) thotë:

“Kjo dëshmi, nëse nuk është e vërtetë, duhet të jetë blasfemi e mirëfilltë ose marrëzi. Hipoteza e parë nuk mund të qëndrojë asnjë moment përpara pastërtisë morale dhe dinjitetit të Jezusit, të zbuluar në çdo fjalë dhe vepër të tij, dhe të pranuar nga të gjithë. Vetë-mashtrimi në një çështje kaq të rëndësishme dhe me një intelekt në të gjitha aspektet aq të kthjellët e të shëndetshëm, është po ashtu jashtë çdo logjike. Si mund të ishte një entuziast apo i marrë ai që kurrë nuk e humbi ekuilibrin mendor, që kaloi me qetësi nëpër gjithë telashet dhe përndjekjet, si dielli mbi retë, që gjithnjë u ktheu përgjigjen më të urtë pyetjeve ngacmuese, që me qetësi dhe vetëdije parashikoi vdekjen e tij në kryq, ringjalljen të tretën ditë, ardhjen e Frymës së Shenjtë, themelimin e kishës së tij, shkatërrimin e Jerusalemit – parashikime që janë përmbushur fjalë për fjalë? Një karakter aq origjinal, aq i plotë, aq i qëndrueshëm, aq i përsosur, aq njerëzor dhe i ngritur aq lart mbi gjithë madhështinë njerëzore, nuk mund të jetë as mashtrim, as trillim. Poeti, siç është thënë me vend, në këtë rast do të ishte më i madh se heroi i krijuar prej tij. Do të duhej një më i madh se Jezusi që të shpikte një Jezus.”⁵

Diku tjetër Shaf jep argumente bindëse kundër hipotezës se Krishti mund të ishte gënjeshtar:

“Si, në emrin e logjikës, të arsyesimit, dhe përvojës, mundet një shtirës – domethënë një njeri mashtrues, egoist, i çoroditur —të ketë shpikur karakterin më të pastër dhe më fisnik të njohur në histori dhe ta ketë bërë të duket si i vërtetë, pa ndryshim, nga fillimi në fund? Si mund të kishte hartuar dhe zbatuar një plan mirëbërjeje të padëgjuar më parë, të një magnitude morale dhe sublimiteti të tillë, dhe të sakrifikonte jetën e vet për të, përballë paragjykimeve aq të forta të njerëzve dhe epokës së tij?”⁶

Nëse Jezusi donte që njerëzit ta ndiqnin dhe t'i besonin atij si Perëndi, pse shkoi në kombin hebre? Pse shkoi si një zdrukthëtar i zakonshëm në një fshat të humbur në një vend aq të vogël nga sipërfaqja dhe popullsia dhe aq besimtar në një Perëndi të vetëm? Pse nuk shkoi në Egjipt, ose më mirë në Greqi, ku njerëzit besonin në shumë perëndi dhe në shumë shfaqje të tyre?

Dikush që jetoi si Jezusi, që mësoi si Jezusi dhe që vdiq si Jezusi nuk mund të kishte qenë gënjeshtar. Le të shikojmë alternativa të tjera.

A ISHTE I ÇMENDUR?

Nëse na duket e pakonceptueshme që Jezusi të kishte qenë gënjeshtar, a nuk ka mundësi që ai gabimisht ta ketë pandehur veten për Perëndi? Në fund të fundit,



Si mendoni?

Pse Jezusi zgjodhi t'ju tregonte mesazhin e tij kombit hebre? A kishte Jezusi ndonjë avantazh në punën e tij nga të qëniet zdrukthëtar me profesion?

është e mundur të jesh edhe i singertë, edhe prapë ta kesh gabim. Por duhet të kujtojmë se nëse dikush e mendon veten Perëndi, sidomos në një kulturë shumë monoteiste, dhe iu thotë të tjerëve që fati i tyre

i përjetshëm varet në besimin ndaj tij, atëherë ai nuk është thjesht një ëndërrimtar idealist, por një i çmendur. A është e mundur që Jezusi të ishte i tillë?

Dikush që e beson veten për Perëndi në ditët e sotme trajtohet si dikush që mendon se është Napoleoni. Ai është i deluzionuar dhe i vetë-mashtruar dhe ne do ta mbyllnim në një spital psikiatrik që të mos i bënte dëm vetes dhe të tjerëve. Por tek Jezusi nuk i vërejmë anormalitetet dhe çekuilibrin që shoqërojnë çmendurinë. Nëse ishte i çmendur, atëherë mënyra si e ka mbajtur veten që të mos dukej i tillë është për t'u habitur.

Pionierët e psikiatrisë, Artur Nojs dhe Lorens Kolb, në tekstin *Psikiatria Klinike Moderne*, e përshkruajnë skizofrenin si një person që është më shumë autist sesa realist. Skizofreni dëshiron të largohet nga bota reale. Dhe një njeri që thotë se është Perëndi është mjaft larg realitetit.

Nën dritën e gjërave të tjera që dimë për Jezusin, është e vështirë të imagjinosh që ai kishte probleme mendore. Ai ka thënë disa nga fjalët më të mençura që mbahen mend deri më sot. Udhëzimet e tij kanë çliruar shumë njerëz nga skllavëria mendore. Klark H. Pinok,

profesor i Teologjisë Sistematike në MekMaster Diviniti Kollixi (McMaster Divinity College) thotë: “A mos vallë kishte iluzione në lidhje me madhësinë e tij? A ishte paranoid, mashtrues pa dashje, skizofren? Përsëri, aftësia dhe thellësia e mësimit të tij provojnë vetëm kthjellësinë e tij të plotë mendore. Të ishim edhe ne aq të shëndetshëm mendërisht sa ai!”⁷ Një student në një universitet të Kalifornisë më tha se profesori i tij i psikologjisë kishte thënë në klasë se “ai vetëm duhej të merrte në dorë Biblën dhe t’iu lexonte pjesë nga mësimet e Krishtit shumë prej pacientëve të tij. Nuk u nevojitej më shumë këshillim se kaq.”



Si mendoni?

A dalloni ndonjë aspekt në sjelljen e Jezusit (përveç deklaratës së tij për hyjninë) që sygjeron që ai mund të ishte i çmendur? Nëse do të kishit jetuar në atë kohë, a do t’i dëgjonit mendimet e tij?

Psikologu Dr. Geri Kollins shpjegon se Jezusi

“ishte i dashur, por nuk lejoi që dhembshuria ta paralizonte; nuk kishte ego të fryrë, megjithëse shpesh rrethohej nga turma që e adhuronin; ruajti ekuilibrin pavarësisht se jeta që bënte ishte e ngarkuar; gjithmonë e dinte çfarë po bënte dhe ku po shkonte; i donte shumë njerëzit, edhe gratë dhe fëmijët, që nuk konsideroheshin të rëndësishëm atëherë; i pranonte njerëzit pa e anashkaluar mëkatën e tyre; veprroi me njerëzit në bazë të pozitës ku ishin dhe në bazë

**Nëse një njeri i
zakonshëm do
të deklaronte
që ai ishte
Perëndi atëherë
me siguri do ta
konsideronim
këtë aspekt
si “largim nga
realiteti”.**

*të nevojave unike që kishin. Duke
i patur parasysh të gjitha faktet,
unë nuk shoh shenja që Jezusi
të vuante nga ndonjë sëmundje
mendore... Ai ishte shumë më
i shëndetshëm sesa të gjithë
njerëzit që njoh – përfshi këtu
edhe mua!”⁸*

Psikiatri Xhei Ti Fisher thotë:

*“Po të mblidhje të gjithë artikujt autoritarë të
shkruar nga psikologët dhe psikiatrët më të
kualifikuar mbi temën e higjienës mendore—po
t’i bashkoje dhe t’i pastroje duke lënë jashtë fjalët
e tepërta—po të merrje gjithë thelbin dhe të lije
gjërat anësore, dhe po t’i shprehje këto pjesë
të pastra të njohurisë së pastër shkencore në
mënyrën më koncize nga poetët më të aftë, do të
kishe një përmbledhje të paplotë dhe gjysmake
të Predikimit në Mal. Dhe po ta krahasoje me
këtë të fundit e para do të dukej shumë e varfër.
Për afro dy mijë vjet bota e krishterë ka mbajtur
në duar përgjigjen e plotë për kërkimet e saj të
lodhshme e të pafryte. Këtu .. gjendet modeli për
një jetë të suksesshme me optimizëm, shëndet
mendor dhe paqe të brendshme.”⁹*

Si Es Luis shkruan:

*“Vështirësia historike e dhënies së një shpjegimi
për jetën, thëniet dhe ndikimin e Jezusit më pak*

të vështirë se shpjegimi i krishterë është shumë e madhe. Mospërputhja midis thellësisë dhe kthjelltësisë... së mësimëve të Tij morale dhe megalomanisë së shfrenuar që duhet të gjendet prapa mësimëve të Tij teologjike nëse nuk është vërtet Perëndi nuk është shpjeguar asnjëherë në mënyrë të kënaqshme. Për këtë shkak, hipotezat jo të krishtera pasojnë njëra-tjetrën me pjellorinë e shfrenuar të moskuptimit.”¹⁰

Filip Shaf arsyeton:

“A është vallë një intelekt i tillë—i qartë si qielli, i freskët si ajri i malit, i mprehtë dhe depërtues si shpatë, tërësisht i shëndetshëm dhe i fortë, gjithmonë gati dhe gjithmonë gjakftohtë—i prirur për një iluzion kaq të madh në lidhje me karakterin dhe misionin e tij? Imagjinatë absurde!”¹¹

A ISHTE ZOT?

Unë personalisht nuk mund të dal në përfundimin se Jezusi ishte gënjeshtar apo i çmendur. E vetmja alternativë që mbetet është që ai ishte Krishti, Biri i Perëndisë, siç shpalli vetë. Por pavarësisht nga logjika dhe provat, shumë njerëz duket sikur nuk arrijnë të dalin dot në këtë përfundim.

Në librin *Kodi i Da Vinçit* Den Braun thotë, “Duke e mbështetur zyrtarisht Jezusin si Biri i Perëndisë, Konstandini e ktheu Jezusin në një hyjni që ekzistonte përtej spektrit të botës njerëzore, në një entitet fuqia e të cilit ishte e pasfidueshme.”¹²



Si mendoni?

Pse kaq shumë psikologë e shikojnë Jezusin si një model të shëndetit mendor? Pse ishte ai kaq i kënaqur?

Romancieri Braun do që njerëzit të besojnë idenë që hyjnia e Krishtit u sajua në Këshillin e Nikesë. Megjithëse është diskutuar gjerësisht në opinion, ky “fakt” është hedhur

poshtë nga mbi 99,9 përqind e studiuesve të Biblës që studiojnë historinë e dokumentuar. Ja pse. Dhiata e Re vetë na jep provat më të hershme se Jezusi është hyjnor (shih kapitullin 2). Meqë këto dokumente u hartuan në shekullin e parë, vetëm pak dekada pas ngjarjeve që kishin lidhje me Jezusin, ato janë më shumë se dy shekuj përpara Këshillit të Nikesë. Megjithëse u shkruan nga njerëz të ndryshëm për një larmi qëllimesh, një temë e pagabueshme e përbashkët e tyre është që Krishti është Perëndi.

Etërit e kishës përpara këshillit të Nikesë na japin edhe më shumë prova që Jezusi konsiderohej hyjnor shumë kohë përpara Këshillit të Nikesë. Etërit e kishës përpara këshillit të Nikesë ishin mendimtarë të krishterë që jetuan pas mbylljes së periudhës së Dhiatës së Re (afërsisht viti 100), por përpara Këshillit të Nikesë (viti 325). Ata ishin njerëz si Justin Martiri, Ignati dhe Ireneu. Nuk ka dyshim që ata e konsideronin Jezusin hyjnor. Ja disa nga citimet prej veprave të tyre të asaj kohe:

Ignati i Antiokisë (viti 110 pas Krishtit):

“Perëndia i mishëruar . . . Perëndia vetë i shfaqur në formën e një njeriu.”¹³

Justin Martiri (vitet 100–165 pas Krishtit): “... duke qenë Fjala e Parëlindur e Perëndisë, është Perëndi.”¹⁴

Ireneu (viti 177 pas Krishtit): “... Ati është Perëndi dhe Biri është Perëndi; sepse Ai që ka lindur nga Perëndia është Perëndi.”¹⁵

Melito i Sardës (rreth vitit 177 pas Krishtit): “Ai ishte njeri e megjithatë ishte Perëndi.”

Ndoshta prova më bindëse se Jezusi konsiderohej hyjnor përpara Nikesë vjen nga shkrimtarë jo të krishterë. Satiristi grek Lukiani i Samosatës (rreth vitit 170 pas Krishtit), filozofi romak Celsi (rreth vitit 177 pas Krishtit) dhe guvernatori romak Plini i Riu (rreth vitit 112 pas Krishtit) e bëjnë të qartë se të krishterët e hershëm e besonin se Jezusi ishte hyjnor. Plini i përndoqi të krishterët për shkak të besimit të tyre se Jezusi ishte hyjnor. Plini pranoi: “Ata takoheshin rregullisht para lindjes së diellit në një ditë të caktuar për të kënduar vargje me rradhë midis tyre në nderim të Krishtit si ndaj një perëndie.”¹⁶ Duke patur parasysht këto fakte, dhe shumë të tjera, autorët e *Rishpikja e Jezusit (Reinventing Jesus)* arrijnë në përfundimin: “Të supozosh se Konstandini kishte aftësinë – apo edhe dëshirën – për të manipuluar këshillin që të besonte diçka që tashmë ai (këshilli) nuk e kishte pranuar, është

Personalisht nuk arrij dot në përfundimin që Jezusi ishte gënjeshtar ose i çmendur. E vetmja alternativë e qëndrueshme është që ai ishte – dhe është – Krishti, Biri i Perëndisë.

në rastin më të mirë, një ide qesharake.”¹⁷ Provat janë të qarta: Jezusi besoj se ishte hyjnor shumë kohë përpara këshillit të Nikesë.

Kur e diskutoj materialin e këtij kapitulli me hebrej, përgjigjia e tyre është shumë interesante. U paraqes ato që Jezusi tha për veten dhe pastaj u vë përpara mundësitë që gjenden në trilemë (gënjeshtar, i çmendur ose Perëndi).



Si mendoni?

Nëse provat për Jezusin hyjni janë kaq të qarta dhe domethënëse, pse kaq shumë njerëz vazhdojnë ta refuzojnë identitetin e tij?

Kur i pyes nëse besojnë se Jezusi ishte gënjeshtar, më japin një “Jo!” të prerë. Pastaj i pyes, “A mendoni se ishte i çmendur?” Përgjigjia e tyre, “Patjetër që jo.” “A besoni se është Perëndi?”

Para se të marr frymë dëgjoj një “Absolutisht jo!” buçitëse. Megjithatë, nuk mbetet mundësi tjetër.

Çështja me këto tri alternativa nuk është cila është e mundshme, sepse të tria janë të mundshme. Por pyetja është, “Cila është më e logjikshme?” Nuk mund ta klasifikosh si një mësues të madh morali. Kjo nuk është mundësi fare. Ai është ose gënjeshtar, ose i çmendur, ose Zot dhe Perëndi. Duhet të zgjedhësh. Vendimi yt për Jezusin duhet të jetë më shumë sesa një ushtrim intelektual neutral. Siç shkroi apostulli Gjoni, “...këto janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij” (Gjoni 20:31).

Faktet janë qartësisht në favor të Jezusit si Perëndi.

Po shkenca?

SHUMË NJERËZ PËRPIQEN TA SHTYJNË PËR MË VONË PËRKUSHTIMIN PERSONAL NDAJ KRISHTIT në bazë të supozimit se nëse nuk mund ta provosh diçka në mënyrë shkencore, atëherë nuk është e vërtetë. Meqenëse nuk mund ta provojmë shkencërisht hyjninë e Krishtit apo ringjalljen e tij, atëherë të sofistikuarit e shekullit të njëzet e njëte nuk janë aq budallenj sa ta pranojnë atë si Shpëtimtar.

Shpesh në një orë filozofie apo historie dikush më hedh sfidën, “A mund ta provosh shkencërisht?” Unë zakonisht them, “Epo, unë nuk jam shkencëtar.” Atëherë dëgjoj që klasa kukuriset ndërsa disa zëra thonë gjëra si, “Atëherë mos më fol për këtë,” ose “E sheh? Duhet ta marrësh me besim” (duke nënkuptuar besim të verbër).

Një herë duke shkuar për në Boston me avion, po bisedoja me një pasagjer që ishte ulur afër meje për arsyet pse personalisht besoja se Krishti është ai që tha

se është. Piloti, që po përshëndeste pasagjerët, dëgjo një pjesë të bisedës sonë. “Keni një problem me besimin tuaj,” tha. “Cili është ai?” e pyeta. “Nuk mund ta provoni shkencërisht,” u përgjigj.



Si mendoni?

Përveç fakteve historike, a ka ndonjë tjetër lloj aspekti që ne e dimë që është e vërtetë pavarësisht se janë të paprovuara shkencërisht? Nëse po, për çfarë aspektesh bëhet fjalë?

Habitem me nivelin ku ka rënë të menduarit e kohës së sotme. Ky pilot është si shumë njerëz të tjerë në këtë shekull që mendojnë se nëse nuk mund ta vërtetosh shkencërisht diçka, ajo nuk mund të jetë e vërtetë. Ka shumë fakte që të gjithë i pranojmë si të vërteta megjithëse nuk mund të

vërtetohen me metoda shkencore. Ne nuk mund të provojmë në mënyrë shkencore asgjë në lidhje me asnjë person apo ngjarje në histori, por kjo nuk do të thotë se është e pamundur të kesh prova. Ne duhet të kuptojmë ndryshimin midis provave shkencore dhe atyre që unë i quaj prova historiko-ligjore. Më lejoni të shpjegohem.

Provat shkencore tregojnë se diçka është fakt duke përsëritur një ngjarje në praninë e personit që e vë atë fakt në dyshim. Kjo bëhet në një ambient të kontrolluar ku mund të bëhen vëzhgime, mund të merren të dhëna dhe të vërtetohen hipoteza në mënyrë empirike.

“Metoda shkencore, sido që të përkufizohet, lidhet me matjet e dukurive dhe eksperimentin ose vëzhgimin e përsëritur.”¹ Dr. Xhejms B. Konant, ish president i

Harvardit, shkruan:

*“Shkenca është një seri
konceptesh dhe skemash
konceptuale të ndërlidhura
që janë zhvilluar si rezultat
i eksperimentimit dhe
vëzhgimit, dhe janë të
dobishme për eksperimente
dhe vëzhgime të tjera.”²*

**Shumë njerëz
mbahen fort
pas mendimit
që një gjë
nuk është e
vërtetë nëse
nuk vërtetohet
shkencërisht.**

Vërtetimi i një hipoteze me anë të përdorimit të eksperimenteve të kontrolluara është një nga teknikat kyçe të metodës shkencore moderne. Për shembull, dikush thotë që sapuni Ajvori (Ivory soap) nuk pluskon. Unë them që pluskon, dhe për të vërtetuar atë që thashë e marr dyshuesin në kuzhinë, mbush lavamanin me ujë në temperaturën 28°C dhe hedh brenda sapunin. Plluq! Ne bëjmë vëzhgime, shënojmë të dhënat dhe vërtetojmë hipotezën time në mënyrë empirike: sapuni Ajvori pluskon.

Po që se metoda shkencore do të ishte metoda e vetme për të vërtetuar faktet, ti nuk mund të vërtetoje se pe televizor mbrëmë ose se hëngre drekë sot. Nuk ka se si t'i përsëritësh ato ngjarje në një situatë të kontrolluar.

Këtu përdoret ajo që e quajmë prova historiko-ligjore, që bazohet në demonstrimin se diçka është fakt përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Me fjalë të tjera, ne arrijmë një vendim në bazë të peshës së fakteve dhe nuk kemi asnjë bazë të arsyeshme për të vënë në dyshim

Po qe se metoda shkencore do të ishte metoda e vetme për të vërtetuar faktet, ti nuk mund të vërtetoje se pe televizor mbrëmë ose se hëngre drekë sot. Nuk ka se si t'i përsëritësh ato ngjarje në një situatë të kontrolluar.

vendimin. Prova historiko-ligjore mbështetet në tri lloj dëshmish: dëshmi gojore, dëshmi e shkruar dhe në provat materiale (si arma, plumbi, fletorja). Duke përdorur metodën ligjore për të vërtetuar faktet, ti mund të vërtetosh jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ishte për drekë sot: të kanë parë shokët, kamarieri të mban mend dhe ke faturën e restorantit.

Metoda shkencore mund të përdoret vetëm për të provuar gjëra të përsëritshme. Nuk është e mjaftueshme për të provuar

apo hedhur poshtë shumë pyetje në lidhje me persona apo ngjarje në histori. Metoda shkencore nuk është e përshtatshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla si “A ka jetuar Xhorxh Uashingtoni?” “A ka qenë Martin Luter Kingu udhëheqës i të drejtave civile?” “Kush ishte Jezusi i Nazaretit?” “A u ringjall Jezu Krishti nga të vdekurit?” Këto pyetje janë jashtë fushës së provave shkencore, dhe duhet t'i vendosim në fushën e provave ligjore. Me fjalë të tjera, metoda shkencore, që bazohet në vëzhgim, mbledhje informacioni, hipoteza, deduksion dhe verifikim eksperimental për të gjetur dhe shpjeguar ligjet empirike të natyrës, nuk mund të gjejë përgjigjet përfundimtare për pyetje të tilla si “A mund ta provosh ringjalljen?” “A është shkenca në luftë me fenë?” “A e ka

hedhur poshtë shkenca ekzistencën e Perëndisë?” Në kapitullin tjetër im bir, Shoni, shqyrton deklaratat e “Ateistëve të Rinj” – të cilët besojnë pikërisht këtë gjë.



Si mendoni?

Cilat janë përparësitë e përdorimit të metodës shkencore për të “provuar” diçka? Po mangësitë? Cilat janë përparësitë e përdorimit të metodës historikoligjore? A ju duket sikur ju përdorni njërin ose tjetrin metodë herë pas here?

Sfida e Ateizmit të Ri

NDËRSA UNË (SHONI) ISHA ULUR E PO PIJA NJË makiato në një lokal afër shtëpisë, vura re pak më tutje një vajzë të re që po lexonte një libër me një titull provokues: *Perëndia nuk është i madh: Si feja helmon gjithçka*, nga Kristofer Hiçens. Shkronjat e argjendta bënë kontrast në sfondin e verdhë. I intriguar nga titulli i guximshëm, vendosa ta pyesja për çfarë bënte fjalë libri. Ajo me entuziazëm më mbajti një leksion të gjatë se si feja ka qenë forca më e madhe e së keqes në historinë botërore, si shkenca e ka hedhur poshtë çdo bazë për besim të arsyeshëm, dhe si njerëzit mund të jenë të mirë pa Perëndinë. A kishte të drejtë kjo vajzë e re? A është feja e keqja e ekzistencës njerëzore? A e ka hedhur poshtë shkenca ekzistencën e Perëndisë? A do të ishte vërtet bota më e mirë nëse ne të gjithë do të përqaфонim ateizmin?

Ateizmi nuk është ndonjë gjë e re. Afro 1000 vjet para ardhjes së Krishtit, Mbreti David përshkroi një



Si mendoni?

Cila është arsyeja që “Ateistët e Rinj” kanë fituar kaq shumë mbështetës?

person që thotë në zemër të tij, “Nuk ka Perëndi” (Psalmi 14:1). Gjithmonë ka patur njerëz që e kanë mohuar ekzistencën e Perëndisë, dhe ndoshta gjithmonë do

të ketë. Megjithëse ateistët i kanë shprehur shpesh pikëpamjet e tyre në publik, ndikimi i tyre në opinionin e përgjithshëm ka qenë minimal. Deri në këtë kohë. Kohët e fundit një grup ateistësh entuziastë, militantë dhe të aftë në të shprehur kanë shpërthyer në skenën publike. Audienca që kanë patur është e paprecedent në historinë e ateizmit. Në pak më shumë se një vit, tre nga librat e tyre mbushën raftet e librarive. Sulmin e filloi Sem Harris (Sam Harris) me botimin e *Letër një kombi të krishterë* (Letter to a Christian Nation) (2006), i ndjekur nga Riçard Dokins (Richard Dawkins) me *Iluzioni Perëndi* (The God Delusion) (2006), dhe së fundi Kristofer Hiçens (Christopher Hitchens) me *Perëndia nuk është i madh* (God Is Not Great) (2007). Të tre librat përjetuan shitje të stuhishme, duke kaluar muaj – jo javë – në listat e librave më të shitur. Për shembull *Perëndia nuk është i madh*, arriti numrin një në listën e Nju Jork Tajmsit brenda një muaji nga dalja në shtyp. Në javën e shtatë u hodhën në shtyp afro 300,000 kopje. Ndikimi i të ashtuquajturve Ateistë të Rinj ka shkuar përtej botës së botimeve. Ata kanë shkruar artikuj, kanë folur në qendra studentore, kanë marrë pjesë në debate, janë intervistuar në radio dhe TV dhe kanë vendosur video të panumërta

në YouTube. Ata i kanë ngatërruar njerëzit që ishin në kërkim të së vërtetës dhe kanë lëkundur besimin e shumë besimtarëve. Anketime të kohëve të fundit tregojnë se një numër gjithnjë në rritje i amerikanëve e identifikojnë veten si ateistë dhe agnostikë. Synimi i Ateistëve të Rinj është i thjeshtë: të çrrënjoshin çdo bazë të arsyeshme për besim fetar dhe të bindin teistët të largohen nga besimi. Mos kanë zbuluar ndonjë gjë të re? Mos kanë gjetur prova të reja që hedhin poshtë ekzistencën e Perëndisë? Çfarë e bën Ateizmin e Ri *të ri*?

E njëjta gjë e vjetër

Gazetari i mirënjohur britanik Malkom Magërixh (Malcolm Muggeridge) një herë tha që të gjitha të rejat nuk janë gjë tjetër veçse njerëz të rinj që përjetojnë gjëra të vjetra. Gjërat mund të *duken* të reja, por kjo nuk do të thotë se vërtet *janë* të reja. Kur vjen puna tek ateizmi i ri, nuk ka ndonjë zbulim të ri në shkencë, filozofi apo histori që të lëkundë bazat e krishtëritimit. Pjesa më e madhe e argumenteve të Ateistëve të Rinj janë ricikluar nga ateistët e vjetër si Fridrih Niçe, Zigmund Frojd, Karl Marks dhe Bertrand Rasëll. Megjithatë, ka disa karakteristika që e bëjnë Ateizmin e Ri të veçantë.

Së pari, Ateizmi i Ri kushton më pak. Ateistët e së shkuarës ishin shumë të vetëdijshëm për pasojat e mohimit të Perëndisë. Ata e kishin të qartë se pa Perëndinë ne banojmë në një univers të ftohtë, të errët e të pakuptimtë. Shumë ateistë të vjetër e vajtuan vdekjen e Perëndisë sepse e kuptuan se kjo shembte

**Shumë ateistë
të vjetër e
vajtuan vdekjen
e Perëndisë.
Ateistët e Rinj
e festojnë
vdekjen e
Perëndisë**

themelet e kulturës perëndimore. Ekzistencialisti Alber Kamy e pranonte se vdekja e Perëndisë do të thoshte humbje e qëllimit, e gëzimit dhe e çdo gjëje për të cilën ia vlen të jetohet. Në kontrast me këtë, Ateistët e Rinj e festojnë vdekjen e Perëndisë.

Ata mendojnë se jeta mund të vazhdojë normalisht (dhe madje më mirë) nëse thjesht eliminojmë fenë. Një ateizëm i tillë “i butë”, thotë Profesor Xhon Hot i Universitetit të Xhorxhtaunit, nuk e merr seriozisht ateizmin:

Ateistët e rinj të butë supozojnë se, me anë të Darwinizmit, ne thjesht mund ta lëmë mënjane Perëndinë si Santa Klausin pa na u dashur të shohim kolapsin e plotë të kulturës perëndimore – bashkë me atë që ne e quajmë racionale dhe morale. Të paktën ateistët e fortë e kuptonin që nëse do të jemi vërtet të singertë në ateizmin tonë, i gjithë rrjeti i kuptimeve dhe vlerave që është mbështjellë rreth idesë së Perëndisë në kulturën perëndimore duhet të hidhet në kosh bashkë me qendrën e vet organizuese.¹

Së dyti, në kontrast me forma më të vjetra ateizmi, Ateistët e Rinj nuk kanë tolerancë për besimin fetar. Ata besojnë jo vetëm që feja është e krijuar nga njeriu, por edhe që ajo helmon gjithçka dhe prandaj duhet eliminuar. Në Letër një kombi të krishterë, Sem Harris thotë se “respekti [që e drejta fetare] kërkon për besimet e veta

fetare u jep strehë ekstremistëve të të gjitha besimeve.”² Ndërsa Harris e pranon që liberalët dhe të moderuarit nuk përplasnin avionë në grataçela, ai beson se toleranca e tyre e mbështet një ekstremizëm të tillë. Prandaj ajo duhet çrrënjosur. Nëse plotësohet dëshira e Ateistëve të Rinj, liria e fesë do të jetë një relike e së shkuarës.

Së treti, Ateistët e Rinj i rezervojnë sulmet më të ashpra për krishtërimin. Megjithëse e kritikojnë Budizmin, Islamin, Mormonizmin dhe fetë e tjera, synimi i tyre është qartësisht Perëndia i Biblës. Riçard Dokins e pranon, “Nëse nuk thuhet ndryshe, do të kem kryesisht krishtërimin në mendje.”³

Nëse ke lexuar ndonjë gjë nga Ateistët e Rinj, është e rëndësishme të mbash në mendje fjalët e Mbretit Solomon: “I pari që mbron çështjen e vet duket sikur ka të drejtë, por pastaj vjen tjetri dhe e shqyrton” (Fjalët e Urta 18:17). Me fjalë të tjera, kur dëgjohet vetëm njëra anë e çështjes, faktet shpesh duken bindëse. Por kur dëgjohet e gjithë historia, ajo që u tha në fillim shpesh rrëzohet. Ateistët e Rinj janë bindës – derisa të dëgjohet edhe ana tjetër. Ja ana tjetër.

A është ateizmi më i arsyeshëm?

Ateistët e Rinj besojnë fort se ateizmi qëndron më lart nga ana e arsyes. Sipas Hiçens, feja bazohet “vetëm mbi besimin,” kurse ateizmi nuk kërkon përkushtim besimi sepse mbështetet kryesisht në faktet empirike të shkencës.⁴

Do ta shqyrtojmë nëse ateizmi apo teizmi i shpjegon

më mirë të dhënat shkencore, por më parë duhet të shqyrtojmë një pyetje më themelore: Pse ka kuptim bota natyrore? Ajnshtajni tha një herë se gjëja më e pakuptueshme e kësaj bote është që ajo është e kuptueshme. Ajnshtajni kuptoi një të vërtetë themelore në lidhje me shkencën, atë që ajo mbështetet mbi disa supozime filozofike në lidhje me botën natyrore. Këto supozime përfshijnë ekzistencën e një bote reale të jashtme që është e rregullt dhe e njohshme, dhe aftësinë e mendjeve tona për ta kuptuar atë botë. Shkenca nuk mund të vazhdojë të operojë pa këto supozime. Por kjo ngre një dilemë vërtet të vështirë për ateistin: Nëse mendja u zhvillua nëpërmjet procesit material e të verbër të evolucionit darvinian, atëherë pse duhet t'i besojmë asaj? Pse duhet të besojmë që truri njerëzor – që ishte rezultat i një procesi aksidental – na vë në kontakt me realitetin?

**Ajnshtajni
tha një herë
se gjëja më e
pakuptueshme
e kësaj bote
është që
ajo është e
kuptueshme.**

Shkenca nuk mund të përdoret si përgjigje për këtë pyetje, sepse shkenca vetë mbështetet mbi këto supozime. Edhe vetë Çarlz Darvini ishte i vetëdijshtë për këtë problem: “Gjithmonë më ngrihet dyshimi i tmerrshëm nëse bindjet e një mendjeje njeriu, që është zhvilluar nga mendja e kafshëve më të ulëta, kanë ndonjë vlerë apo mund të jenë të besueshme. Do t'i besonte njeri bindjet e mendjes së një majmuni, nëse ka bindje në një mendje të tillë?”⁵ Ateistët e Rinj vendosin shumë besim

në aftësitë e tyre të arsyetimit, por botëkuptimi i tyre ateist i heq themelet për një siguri të tillë. Në fakt, nëse evolucioni darvinian do të ishte i vërtetë, ne nuk duhet t'iu besonim aftësive tona njohëse sepse ato janë rezultat i një procesi të padrejtuar dhe të paarsyeshëm. Fizikanti fitues i çmimit Tempëllton, Pol Dejvis tha, “Shkenca bazohet në supozimin se universi është tërësisht

Nëse evolucioni darvinian do të ishte i vërtetë, ne nuk duhet t'iu besonim aftësive tona njohëse sepse ato janë rezultat i një procesi të padrejtuar dhe të paarsyeshëm.

racional dhe logjik në çdo nivel. Ateizmi pretendon se ligjet [e natyrës] ekzistojnë pa arsye dhe se universi është në fund të fundit absurd. Si shkencëtar, unë e kam të vështirë ta pranoj këtë. Duhet të jetë një bazament i arsyeshëm, i pandryshueshëm në të cilin është rrënjësor natyra logjike, e rregullt e universit.”⁶ Ateizmi nuk na e siguron një bazament të tillë të arsyeshëm. Në fakt, ateizmi e minon atë. Teizmi e siguron një themel të tillë. Nuk është puna thjesht se natyra racionale e universit përputhet më mirë me teizmin. Niveli i lidhjes shkon më thellë. Një univers racional është gjëja që do të prisnim nëse Perëndia ekziston.

A është shkenca në luftë me fenë?

Shkenca ka qenë në luftë me fenë për shekuj të tërë. Të paktën këtë duan Ateistët e Rinj që ju të mendoni. Megjithëse ky është një besim shumë i përhapur, është thjesht përrallë se feja ka penguar përparimin e

shkencës.⁷ Është në të vërtetë botëkuptimi i krishterë – me këmbënguljen e tij në rregullsinë e universit, me theksin e tij në arsyen njerëzore, dhe me mësimet se Perëndia përlëvdohet kur ne e kuptojmë krijimin e Tij—që hodhi themelet e revolucionit modern shkencor. Shkenca moderne nuk u zhvillua në vakuum, por nga forca që u vunë në lëvizje më së shumti nga krishtërimi. Në *Shkenca dhe Bota Moderne*, matematikani dhe filozofi Alfred North Uajt-Hed konkludon se shkenca moderne u zhvillua kryesisht nga “këmbëngulja mesjetare në arsyeshmërinë e Perëndisë. . .”⁸

Shkenca moderne nuk u zhvillua në vakuum, por nga forca që u vunë në lëvizje më së shumti nga krishtërimi. Nuk është për t’u habitur që shumica e shkencëtarëve të hershëm ishin teistë, duke përfshirë këtu pionierë si Robert Bojl (1627–91), Isak Njuton (1642–1727) Blez Paskal (1623–62), Johanes Kepler (1571–1630), Lui Pastër (1822–95), dhe Frensis Bejkon (1561–1626). Për shumë prej tyre, besimi në Perëndinë ishte motivi i parë për hetimin e botës natyrore. Bejkoni besonte se bota natyrore ishte plot me mistere që Perëndia donte që ne t’i eksploronim. Kepleri e përshkroi kështu motivimin e tij për shkencën: “Qëllimi kryesor i gjithë hetimeve të botës së jashtme duhet të jetë për të zbuluar rregullin e arsyeshëm që është imponuar mbi të nga Perëndia, dhe që na është zbuluar ne në gjuhën e matematikës.”⁹ Hiçensi i zhvlerëson këto bindje fetare të këtyre pionierëve të shkencës, duke argumentuar se për një intelektual të asaj kohe nuk kishte alternativë tjetër të mundshme.¹⁰ Por

kjo e vendos Hiçensin në një pozicion interesant. Nëse besimtarët nuk marrin meritë për kontributet pozitive që kanë bërë ndaj shoqërisë (p.sh. që i kanë dhënë formë shkencës moderne) për arsye se “të gjithë ishin fetarë,” atëherë si mund të fajësohen besimtarët për gjërat e tmerrshme të kryera në emrin e Perëndisë? Ky është qartazi një standart i dyfishtë. Ateistët e Rinj duan t’iu mohojnë besimtarëve çdo meritë, por nga ana tjetër t’iu hedhin gjithë fajin. Për të mbrojtur tezën se “feja helmon gjithçka” Hiçensit i duhet të mbyllë sytë ndaj gjithë provave që pohojnë të kundërtën. Dhe ai e bën këtë me gjithë qejf.

A është ateizmi më shkencor?

Siguria e Ateistëve të Rinj buron nga një fakt qendror: ata besojnë se shkenca është në anën e tyre. Sem Harris thotë, “Besimi në Perëndinë biblik nuk gjen mbështetje në njohuritë shkencore në lidhje me botën që sa vijnë e shtohen.”¹¹ Dhe sipas Hiçensit, sa më shumë që zhvillohet shkenca, aq më pak vend ka për Perëndinë.¹² Po a është kjo e gjitha? Ndërkohë që Ateistët e Rinj duan që ne të besojmë se ekzistenca e Perëndisë mund të mbrohet vetëm nga “boshllëqet” në njohurinë tonë shkencore, në të vërtetë provat shkencore për një projektim inteligjent të gjithësisë kanë shpërthyer vitet e fundit.¹³ Në fakt, një nga ateistët më me ndikim në pesë dekadat e fundit—Entoni Flu (Antony Flew)—ndryshoi mendim në lidhje me Perëndinë pikërisht për këtë arsye. Ateistë të tjerë mund të jenë dëgjuar, por ndikimi i Flu ka qenë i pashoq.



Si mendoni?

Në këndvështrimin tuaj, dëshmitë shkencore shkojnë në mbështetje të egzistencës së Zotit, kundër egzistencës së Zotit apo janë asnjënjë? Ku e mbështesni mendimin tuaj?

Ai mbajti leksionin e tij të famshëm, “Teologjia dhe Falsifikimi” (Theology dhe Falsification) në Klubin Sokratik në Oksford, që në atë kohë drejtohej nga Si Es Luis. Ai u bë artikulli filozofik më i rishtypur për pesë dekada. Librat

dhe leksionet e tij të shumtë i caktuan rrugën ateizmit modern. Pastaj në vitin 2004, Flu bëri një deklaratë tronditëse: Perëndia duhet të ekzistojë. Flu tani beson se shpjegimi më i mirë për botën është ekzistenca e një hyjnie. Pse e ndryshoi mendjen? “Përgjigjia e shkurtër,” shkruan Flu, “është pamja e botës, siç e shoh unë, që ka dalë nga shkenca moderne.”¹⁴ Ateistët e Rinj janë të lirë të shpallin se shkenca është në anën e tyre, por provat tregojnë të kundërtën. Le të shohim dy mistere shkencore që mbeten të pashpjeguara nga shkenca natyrore, por që dëshmojnë fort për Perëndinë.

Misteri i origjinës së jetës

Një nga problemet shkencore më të pashpjegueshme sot është origjina e jetës. Komuniteti shkencor është unanim që ky është një mister i pazgjidhur. Kimisti i Harvardit, Xhorxh Uajtsajds vërejti se çështja e origjinës së jetës është një nga çështjet e mëdha shkencore që mbeten të pazgjidhura.¹⁵ Edhe Sem Harrisi e pranon se origjina e jetës është ende një mister.¹⁶ Problemi i origjinës së

jetës është në thelb një problem informacioni. Me zbulimin e strukturës së ADN-së në vitin 1953, shkencëtarët kuptuan për herë të parë se organizimi dhe zhvillimi i krijesave të gjalla orkestrohet nga informacioni gjenetik. Kjo është arsyeja pse, në një fjalim të shumëcitur, Nobelisti David Baltimor iu referua biologjisë

“I vetmi shpjegim i kënaqshëm për origjinën e një jete kaq ‘të qëllimshme, të vetëpërsëritshme’ siç e shohim në Tokë, është një Mendje pafundësisht inteligjente”.

Antoni Flu, Ish-ateist

moderne si “një shkencë informacioni.” Sa informacion gjendet në gjallesat? Sipas Riçard Dokinsit, informacioni në bërthamën e një amebe të vogël është më i madh se gjithë volumi i Enciklopedisë Britanike (Encyclopedia Britannica).¹⁷ ADN-ja njerëzore përmban shumë më tepër se kaq. Por ADN-ja bën më shumë sesa thjesht ruajtjen e informacionit. Në kombinim me sisteme të tjera të qelizës ajo e përpunon informacionin ashtu siç bën një kompjuter. Prandaj Bill Gejts e përngjason ADN-në me një program kompjuteri, megjithëse shumë më të përparuar se çdo softuer që kanë shpikur njerëzit.¹⁸ Ateistët e pranojnë se nuk kanë as idenë më të vogël si filloi jeta. Dokins e kupton pamundësinë që jeta të ketë filluar vetë, por pastaj e mbyll me një zgjidhje të pabesueshme: fati. Po, fati!¹⁹ A është ky shpjegimi më i arsyeshëm? A mund të dalë informacion nga një proces material i padrejtuar dhe i paarsyeshëm? Përmbajtja e informacionit në ADN ishte një nga arsyet kryesore pse ish-ateisti Entoni Flu ndryshoi mendje në lidhje me Perëndinë. Ai konkludoi:

“I vetmi shpjegim i kënaqshëm për origjinën e një jete kaq ‘të qëllimshme, të vetëpërsëritshme’ siç e shohim në Tokë, është një Mendje pafundësisht inteligjente.”²⁰ Nëse do të na vinte nga hapësira një mesazh me kompleksitetin e Enciklopedisë Britanike pa dyshim që do ta merrnim si provë të një inteligjence jashtë-tokësore. Shpjegimi më i arsyeshëm për ADN-në njerëzore – e cila përmban shumë më tepër informacion se Enciklopedia Britanike – është një Mendje Hyjnore.

Imtësitë e universit

Imagjinoni sikur po ngjiteni në mal dhe arrini në një kasolle të braktisur. Kur afroheni vini re diçka të çuditshme. Brenda frigoriferi është mbushur me ushqimet e tua të preferuara, temperatura është aq sa e do ti, në sfond po luhet kënga jote e preferuar dhe

**Duket se dikush
e ka krijuar
universin
pikërisht duke
na patur ne në
mendje.**

në tavolinë janë gjithë librat dhe DVD-të që të pëlqejnë. Çfarë do të mendoje? Meqë rastësia është e përjashtuar, ka shumë mundësi që do të arrije në përfundimin se dikush po e priste ardhjen tënde. Në

dekadat e fundit, shkencëtarët kanë filluar të kuptojnë se ky skenar është i njëjtë edhe për universin. Duket se dikush e ka krijuar universin pikërisht duke na patur ne në mendje. “Ndërsa shohim universin dhe identifikojmë aksidentet e shumta të fizikës dhe astronomisë që kanë punuar për të mirën tonë,” thotë fizikanti Friman Xh. Dajson, “duket sikur universi duhet ta ketë ditur se po

vinim ne.”²¹ Kjo është arsyeja pse astronomi britanik Fred Hojl vuri re, “Një interpretim i thjeshtë i fakteve sugjeron se një super intelekt ka luajtur me fizikën si edhe me kiminë dhe biologjinë, dhe që nuk ka forca të verbra në natyrë për të cilat ia vlen të flasësh.”²² Fizikantët bien dakord se jeta qëndron në ekuilibër në teshun e një brisku. Shikoni disa shembuj. Së pari, nëse ligji i gravitetit do të ndryshonte vetëm fare pak, universi nuk do të ishte i përshtatshëm për jetën. Në lidhje me forcat e tjera në natyrë, graviteti duhet rregulluar imtësisht në një në 10 në fuqi të 40-të (që do të thotë një në 10,000,000,000,000,000,000,000,000,000,000,000,000,000,000)²³. Së dyti, fizikanti i Kembrixhit, Stiven Hoking vuri re se, “Nëse ritmi i zgjerimit një sekondë pas shpërthimit të madh do të kishte qenë më i vogël me një në njëqind mijë milionë milionë, universi do të ishte mbledhur përsëri përpara se të arrinte këtë madhësi që ka tani.”²⁴ Ka nëntëmbëdhjetë konstante të tilla universale, secila prej të cilave duhet të jetë e rregulluar me imtësi.²⁵ Është e qartë se mundësitë që ne të mos ishim këtu janë shumë të vogla. Në fakt, fizikanti i Oksfordit, Roxher Penroz, arriti në përfundimin se nëse ne i mblidhnim të gjithë ligjet e natyrës që duhet të rregullohen imtësisht, nuk do të mund ta shkruanim dot atë numër, sepse shifrat e nevojshme do të ishin më shumë se numri i pjesëzave elementare në univers.²⁶ Provat për një projektim inteligjent janë aq të shumta sa Pol Dejvis, një fizikant i dëgjuar i Universitetit Shtetëror të Arizonës (Arizona State University), ka konkluduar se natyra miqësore ndaj jetës e universit tonë duket si

një “rakordim.” Ai u shpreh kështu: “Klisheja se ‘jeta qëndron në ekuilibër në tehun e një thike’ është e butë në këtë rast: asnjë thikë në univers nuk e ka tehun aq të hollë.”²⁷ Asnjë shpjegim shkencor për universin, thotë Dejvis, nuk mund të jetë i plotë pa dhënë një shpjegim për këta tregues kaq të shumtë për projektim inteligjent. Disa përpiqen ta shpjegojnë rregullimin e imët duke sugjeruar ekzistencën e shumë universeve, por provat empirike për ta nuk ekzistojnë. Shpjegimi më ekonomik dhe i besueshëm për arsyen pse universi është i rregulluar kaq imtësisht është sepse një Krijues—Perëndia—e bëri ashtu.

A është ateizmi më moral?

Ateistët e Rinj sulmojnë pa mëshirë të këqiat e fesë dhe karakterin e Perëndisë biblik. Moraliteti mund të ekzistojë pavarësisht nga Perëndia, shpallin ata me zë të lartë. Sipas Dokinsit, “Ne nuk kemi nevojë për Perëndinë për të qenë të mirë—apo të këqij.”²⁸ Ateistët e Rinj e denoncojnë me entuziazëm fenë si të keqe dhe lavdërojnë shkencën si të mirë. Por kjo ngre një dilemë të



Si mendoni?

Shkrimtari rus Fjodor Dostojevski tha që pa Zotin çdo gjë është e lejueshme. Për çfarë e kishte fjalën Dostojevski? A mund të ketë një standard moral pa Perëndinë?

vështirë për ateistin: nëse nuk ka Perëndi, nga vijnë detyrimet morale? Nëse “nuk ka asgjë përtej botës natyrore, fizike,”²⁹ siç thotë Dokinsi, atëherë çfarë do të thotë që ekziston e keqja? Meqenëse vlerat morale

nuk kanë veti fizike si lartësia, gjerësia, pesha, si mund të themi se ato janë reale?

Fakti i vështirë për ateizmin është që është shumë e vështirë për të përkufizuar të keqen pa një standard moral të përtejkësibotshëm të të mirës. E keqja është kuptuar gjithnjë si

Është shumë e vështirë për të përkufizuar të keqen pa një standard moral të përtejkësibotshëm të së mirës

shtrembërim i së mirës. Ashtu si e shtrembra nënkupton një standard të së drejtës, e keqja nënkupton një standard të së mirës. Si Es Luis tha shprehjen e famshme se një shkop i përkulur ka kuptim vetëm nën dritën e konceptit të të drejtës. Në mënyrë të ngjashme, mund të ketë të keqe vetëm nëse ka së pari të mirë. Por nëse nuk ka Perëndi (siç shpallin Ateistët e Rinj), atëherë çfarë është e mira? Madje edhe ateisti i ndjerë Xhej El Meki (J. L. Mackie) e pranoi që morali objektiv nuk mund të dilte pa një Perëndi të gjithëfuqishëm. Ekzistenca e vlerave morale objektive është një arsye e fortë për të besuar në Perëndinë. Shqyrtoni këtë argument të thjeshtë:

1. Nëse ekzistojnë vlerat morale objektive, duhet të ekzistojë Perëndia.
2. Vlerat morale objektive ekzistojnë.
3. Si rezultat Perëndia duhet të ekzistojë.

Ne e dimë që vlerat morale objektive ekzistojnë. Ne nuk kemi nevojë të bindemi që, për shembull, të torturosh bebet për qejf është e gabuar. Të gjithë njerëzit e arsyeshëm e dinë këtë. Prandaj meqenëse ekzistojnë vlerat morale, edhe Perëndia duhet të ekzistojë. Në

debatet e tij publike, Kristofer Hiçens rregullisht i sfidon kundërshtarët e tij t'i japin një shembull të një veprimi moral që ateistët nuk mund ta bëjnë. Patjetër nuk ka shembull të tillë. Shumë ateistë janë të njerëzishëm, të dhembshur dhe punëtorë. Por sfida e Hiçensit nuk merr parasysh çështjen kryesore: Si mund t'i shpjegojë ateizmi detyrimet morale? Nëse nuk ka Perëndi, si i justifikojmë të mirën dhe të keqen? Ateizmi është i heshtur në këtë pikë. Kështu, për ironi, një nga kundërshtimet më të përhapura ndaj ekzistencës së Perëndisë përfundon duke qenë një nga arsyet më të mira për të besuar në Të.

A është krishtërimi një mallkim?

Ateistët e Vjetër besonin se feja ishte e rreme. Ateistët e Rinj besojnë se jo vetëm që është e rreme, por është edhe e keqe. Sem Harris e quan fenë, “burimi më i fuqishëm i konfliktit njerëzor, të shkuar e të tashëm.”³⁰ Ateistët e Rinj vazhdimisht paraqesin keqtrajtimin e Galileit, tmerret e Kryqëzatave, Inkuizicionin dhe gjyqet e shtrigave të Salemit në të shkuarën, si edhe abuzimet seksuale të fëmijëve nga priftërinj katolikë në botën e sotme, si prova për mizorinë e krishtëritimit.

Njerëzit pa dyshim kanë bërë gjëra të tmerrshme në emër të Krishtit. Por pse duhet të fajësohet krishtërimi kur janë njerëzit ata që po bëjnë të kundërtën e asaj që mësoi Krishti? A e favorizoi Krishti djegien e shtrigave? A i nxiti Krishti ndjekësit e tij të torturonin heretikët? Patjetër që jo. Në të vërtetë Jezusi mësoi pikërisht të kundërtën. Ai tha t'i duam armiqtë tanë (Mateu 5:44),

të afrojmë ata që shoqëria i konsideron të paprekshëm (Mateu 8:3), dhe të japim jetën për të tjerët (Gjoni 15:13). Po qe se njerëzit do të jetonin vërtet siç jetoi Jezusi, dhuna do të ishte një gjë e së shkuarës. Në librin e tij *Çfarë ka krishtërimi kaq të mirë*



Si mendoni?

Nëse njerëzit do të jetonin sipas mësimeve të Jezusit, si do të dukej bota? A duhet krishtërimi të mbajë barrën e fajit kur njerëzit bëjnë të kundërtën e mësimeve të Jezusit?

(*What's So Great about Christianity*), Dinesh D'Souza demonstroi se Ateistët e Rinj i ekzagjerojnë shumë krimet e kryera në emër të fesë ndërkohë që i zbutin krimet shumë më të mëdha të kryera në emrin e ateizmit. Për shembull, Sem Harris thotë se numri i njerëzve të vrarë në gjyqet e shtrigave të Salemit është 100 000. Cili është numri i vërtetë? Qindra? Mijëra? Dhjetëra mijëra? Në të vërtetë është më pak se 25.³¹ Po ateizmi si del? Është e rëndësishme të mbajmë në mend se çështja nuk është nëse ateistët individualë mund të jenë njerëz të mirë. Patjetër që mund të jenë (dhe shumë janë). Pyetja kyçe është nëse ateizmi, kur adoptohet si filozofia mbizotëruese e një kulture të veçantë, është i mirë apo i keq. Kur kjo pyetje është standardi, bëhet e qartë se asnjë botëkuptim tjetër themelor nuk ka shkaktuar aq mjerim dhe gjakderdhje sa ateizmi. Specifikisht, numri i njerëzve të masakruar nga regjimet ateiste të shekullit të njëzetë si Kina komuniste, Rusia komuniste dhe Gjermania naziste është më shumë se njëqind milion.³² Nuk ka vend të dytë.

Megjithëse të krishterë të caktuar kanë bërë disa gjëra të këqia, trashëgimia e krishtërit në tërësi ka qenë shumë pozitive.

David Berlinski, një hebre jobesimtar që mori doktoraturën (PhD) nga Universiteti i Princetonit (Princeton University), beson se një nga arsytet kryesore për këtë është mungesa e mundësisë për llogaridhënie më në fund: “Ajo që Hitleri nuk e besonte, dhe që Stalini nuk e besonte dhe që

Maoja nuk e besonte dhe që Es Es-ët nuk e besonin dhe që Gestapoja nuk e besonte ... ishte që Perëndia po shikonte ato që po bënin ata.”³³ Megjithëse të krishterë të caktuar kanë bërë disa gjëra të këqia, trashëgimia e krishtërit në tërësi ka qenë shumë pozitive. Të krishterët ngritën spitalet e para, filluan Kryqin e Kuq, udhëhoqën lëvizjen për dhënien fund të skllavërisë, shpikën universitetin dhe ishin udhëçelësit e shkencës moderne. Kur shikojmë lëvizjet që kanë çuar në çlirimin më të madh të njerëzimit, gjejmë ungjillin në zemër të pothuajse të gjithave prej tyre.

Konkluzion

Në analizën përfundimtare, evet mjaft gjë vërtetë erënë lidhje me Ateistët e Rinj është qëndrimi i tyre. Pavarësisht nga retorika e tyre zjarrrë, nuk ka zbulime të reja në shkencë, histori apo filozofi që e rrëzojnë teizmin në përgjithësi dhe krishtërimin në veçanti. Në fakt e kundërta është e vërtetë. Sa më thellë që hyjmë në pjesët e brendshme të qelizës e sa më shumë depërtojmë në univers, aq më shumë i shohim “gjurmet e gishtave” të Perëndisë. Afro

3,000 vjet më parë psalmisti e tha shumë mirë: “Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të Tij. Një ditë i flet ditës tjetër dhe një natë ia tregon tjetrës” (Psalm 19:1-2). Siç e shpall qartë ky psalm, Perëndia mund të njihet nëpërmjet krijimit të Tij. Megjithatë, siç e demonstroi ky libër, Ai e ka bërë veten të njohur specifikisht nëpërmjet personit të Jezu Krishtit, i cili është ende më shumë se zdrukthëtar. Kjo nuk është diçka që e pranojmë verbërisht, por me prova të pakundërshtueshme.

A mund ta provojmë se Jezusi është Biri i Perëndisë? Vetëm metoda historiko-ligjore të ndihmon për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje. Pastaj pyetja parësore bëhet kjo: a mund t'iu besojmë dëshmive dhe provave (p.sh. të Dhiatës së Re)? Një nga gjërat e besimit të krishterë që më ka bërë më shumë përshtypje mua (Xhoshit) është që ai nuk

Një nga gjërat e besimit të krishterë që më ka bërë më shumë përshtypje mua (Xhoshit) është që ai nuk është besim i verbër e i paditur, por i bazuar në prova të forta

është besim i verbër e i paditur, por i bazuar në prova të forta. Sa herë lexojmë në Bibël që një personazhi i kërkohet të ushtrojë besim, e shohim që ai është një besim inteligjent. Jezusi tha, “Ju do ta njihni të vërtetën,” jo do ta injoroni (Gjoni 8:32). Krishtin e pyetën, “Cili është më i rëndësishmi i të gjithë urdhërimeve?” Jezusi u përgjigj, “Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde (Mateu 22:36-37, theksi imi). Problemi me shumë



Si mendoni?

A është e re për ju ideja që besimi mund të jetë i arsyeshëm? Nëse besimi nuk është “i verbër por i arsyeshëm dhe i mbështetur në prova bindëse”, atëherëçfarë mund të jetë një përkufizim i pranueshëm për besimin?

njerëz është që duket se e duan Perëndinë vetëm me zemër. Faktet për Krishtin asnjëherë nuk u shkojnë në mendje. Ne na është dhënë një mendje e aftësuar nga Fryma e Shenjtë për ta njohur Perëndinë, si edhe një zemër për ta dashur dhe vullnet për ta zgjedhur. Ne duhet të funksionojmë në të treja këto fusha për të

patur një marrëdhënie të plotë me Perëndinë dhe për ta përlëvduar Atë. Nuk e di si është për ty, por për mua zemra ime nuk mund të gëzohet në atë që mendja ime e ka refuzuar. Mendja dhe zemra u krijuan për të qenë në harmoni së bashku. Asnjëherë asnjëri nuk është thirrur për të bërë vetëvrasje intelektuale duke i besuar Krishtit si Shpëtimtar dhe Zot.

Në katër kapitujt që pasojnë do t’iu hedhim një sy provave për besueshmërinë e dokumenteve të shkruara dhe të dëshmimeve gojore dhe tregimeve të dëshmitarëve okularë për Jezusin.

A janë të besueshme dokumentet biblike?

DHIATA E RE ËSHTË BURIMI PARËSOR I INFORMACIONIT PËR JEZUSIN. Ky është shkaku që në dy shekujt e kaluar shumë kritikë kanë sulmuar besueshmërinë e dokumenteve biblikë. Duket sikur ka një breshëri akuzash që nuk kanë asnjë bazë historike ose që janë provuar të pavlefshme nga kërkimet dhe zbulimet arkeologjike. Ndërsa po mbaja leksion në Universitetin Shtetëror të Arizonës, një profesor që kishte sjellë studentët e letërsisë m'u drejtua pas një leksioni të mbajtur në ambientet e jashtme në kuadrin e “fjalës së lirë.” Ai tha, “Z. MekDauell, ju po i bazoni të gjitha pretendimet tuaja për Krishtin në një dokument të shekullit të dytë që është i vjetëruar tashmë. Unë iu tregova në mësim sot se Dhiata e Re është shkruar aq shumë kohë pas Krishtit, sa që nuk mund të ishte e saktë në ato që tregonte.” Iu përgjigja, “Zotëri, e kuptoj pikëpamjen tuaj dhe i njoh shkrimet në të cilat e bazoni atë pikëpamje. Por fakti është se ato

shkrime janë provuar që janë të gabuara nga dokumente të zbuluara kohët e fundit të cilat tregojnë qartë se Dhiata e Re është shkruar brenda brezit të Krishtit.”

Burimi i opinionit të atij profesori në lidhje me dokumentet që flasin për Jezusin ishin shkrimet e kritikut gjerman Ferdinand Kristian Baur (Ferdinand Christian Baur). F. C. Baur supozonte se pjesa më e madhe e Shkrimeve të Dhiatës së Re nuk u shkruan deri nga fundi i shekullit të dytë pas Krishtit nga mite dhe legjenda që ishin zhvilluar gjatë intervalit të gjatë midis kohës së Jezusit dhe kohës kur këto tregime u shkruan.

**Në shekullin
e njëzetë
zbulimet
arkeologjike
kishin
konfirmuar
saktësinë e
dorëshkrimeve
të Dhiatës
së Re.**

Por në shekullin e njëzetë zbulimet arkeologjike kishin konfirmuar saktësinë e dorëshkrimeve të Dhiatës së Re. Dorëshkrimet e hershme në papirus (dorëshkrimi John Ryland, i vitit 130 pas Krishtit; papiruset Chester Beatty, të vitit 155 pas Krishtit; dhe papiruset Bodmer II, të vitit 200 pas Krishtit) e ngushtuan hapësirën midis kohës së Krishtit dhe dorëshkrimeve ekzistuese të datave më të vona.

Millar Bërous (Millar Burrows), për shumë vjet profesor i teologjisë biblike në Shkollën Teologjike të Universitetit të Jejlit (Yale University Divinity School), thotë:

“Një rezultat tjetër i krahasimit të greqishtes së Dhiatës së Re me gjuhën e papiruseve [të zbuluara] është shtimi i sigurisë në

transmetimin e saktë të tekstit të Dhiatës së Re vetë.”¹ Zbulime të tilla si ky e kanë rritur sigurinë e studiuesve në lidhje me Biblën.

Uilliam F. Ollbrajt (William F. Albright), që ishte arkeologu më i shquar i Biblës shkruan,

“Mund të themi tashmë me siguri se nuk ka më asnjë bazë të fortë për të datuar ndonjë nga librat e Dhiatës së Re pas vitit 80 pas Krishtit, që do të thotë plot dy breza përpara viteve 130 dhe 150 që pranohen nga kritikët më radikalë të Dhiatës së Re sot.”²

Ai e përsërit këtë pikëpamje në një intervistë për revistën *Krishtërimi Sot (Christianity Today)*.

Sipas mendimit tim, çdo libër i Dhiatës së Re u shkrua nga një hebre i pagëzuar midis viteve dyzet dhe tetëdhjetë të shekullit të parë pas Krishtit (ka shumë mundësi dikur midis viteve 50 dhe 75).³

Sër Uilliam Remzi (Sir William Ramsay), një nga arkeologët më të mëdhenj që kanë jetuar, ishte student i shkollës historike gjermane, që mësonte se libri i Veprave ishte produkt i mesit të shekullit të dytë pas Krishtit dhe jo i shekullit të parë siç pohon të jetë. Pasi lexoi kritikën moderne në lidhje me librin e Veprave, Remzi u bind se ai nuk ishte një tregim besnik i fakteve të kohës së tij (viti 50 pas Krishtit) dhe si i tillë nuk ishte i denjë për t’u marrë në konsideratë nga një historian.

Kështu në kërkimet e tij në historinë e Azisë së Vogël, Remzi i kushtoi pak vëmendje Dhiatës së Re. Puna e tij kërkimore, megjithatë, e detyroi t'i shqyrtonte shkrimet e Lukës, autorit të librit të Veprave. Arkeologu vuri re saktësinë e përpiktë të detajeve historike dhe gradualisht qëndrimi i tij ndaj librit të Veprave filloi të ndryshojë. Ai u detyrua të pohonte:

Luka është historian i rangut të parë. . . . Ky autor duhet vendosur bashkë me historianët më të mëdhenj. ⁴

Për shkak të saktësisë së librit deri në detajin më të vogël, Remzi më në fund pranoi se Veprat nuk mund të jetë një dokument i shekullit të dytë, por i mesit të shekullit të parë. Shumë studiues liberalë po detyrohen të marrin në konsideratë data më të hershme për Dhiatën e Re. Përfundimet e peshkopit anglikan Xhon A. T. Robinson në librin e tij *Redating the New Testament (Ridatimi i Dhiatës së Re)* janë shumë radikale. Puna e tij kërkimore e çoi në bindjen se e gjithë Dhiata e Re ishte shkruar përpara rënies së Jerusalemit në vitin 70 pas Krishtit. ⁵

Sot kritikët e formës, studiues që analizojnë format dhe traditat gojore të lashta mbrapa shkrimeve biblike, thonë se materiali u përcoll në mënyrë gojore derisa u shkrua në formën e ungjijve. Megjithëse tani ata pranojnë që periudha e transmetimit ka qenë shumë më e shkurtër sesa besonin më përpara, ende i mbahen pikëpamjes se ungjijtë morën format e literaturës popullore (legjendave, përrallave, miteve dhe shembëlltyrave).

Një nga provat kryesore kundër kësaj pikëpamjeje është që periudha midis ngjarjeve të Dhiatës së Re dhe kohës së shkrimit të tyre nuk është aq e gjatë sa të lejojë ndryshimin nga fakti në legjendë siç thonë këta kritikë. Duke folur për shkurtësinë e këtij intervali,

Simon Kistemaker, profesor emeritus i Dhiatës së Re në Seminarin Teologjik të Reformuar (Reformed Theological Seminary) shkruan:

*Normalisht akumulimi i folklorit midis njerëzve të kulturave primitive kërkon breza të tërë; është një proces gradual i shpërndarë në shekuj. Por siç e pranojnë edhe kritikët e formës, historitë e ungjijve u formuan dhe u mbledhën brenda më pak se një brezi. Po të ecim me mendimin e kritikëve të formës, atëherë formimi i ungjijve individualë i bie të ketë qenë një projekt i ngjeshur me veprim të përshpejtuar.*⁶

Si mendoni?

A ka pasur ndonjë zbulim arkeologjik të kohëve të fundit që ju ka tërhequr vëmendjen? Cila është arsyeja që këto zbulime “bëjnë kaq shumë zhurmë” në lajmet e gjithë botës?

A. H. McNeile (Meknil), ish Profesor Regius i Teologjisë në Universitetin e Dublinit, sfidon konceptin e kritikës së formës në lidhje me traditën gojore. Ai vë në dukje se kritikët e formës nuk e shikojnë me kujdes traditën e fjalëve të Jezusit. Në kulturën hebreje ishte e rëndësishme që fjalët e një mësuesi të ruheshin me kujdes

Në kulturën hebreje ishte e rëndësishme që fjalët e një mësuesi të ruheshin me kujdes ashtu siç thuheshin dhe të përcilleshin tek të tjerët po në atë mënyrë.

ashtu siç thuheshin dhe të përcilleshin tek të tjerët po në atë mënyrë. Për shembull, 1 Korintasve 7:10, 12, dhe 25 tregojnë ekzistencën e një tradite të mirëfilltë dhe ruajtjen e kujdesshme të saj. Ishte e zakonshme që një student hebre të mësonte përmendësh mësimet e rabinit. Një nxënës i mirë ishte si një “depozitë e stukuar mirë që nuk humbte asnjë pikë” (Mishna,

Aboth, ii, 8). Nëse mbështetemi në teorinë e studiuesit anglikan të Biblës, C. F. Burney në *Poezia e Zotit tonë* (*The Poetry of Our Lord*), mund të supozojmë se pjesa më e madhe e mësimëve të Zotit është në aramaishte në formë poetike, e lehtë për t’u mbajtur mend.⁷ Është e pamundur që në një kulturë të tillë të zhvillohej brenda një kohe aq të shkurtër një traditë legjendash që nuk përputheshin me faktet reale. Studiues të tjerë bien dakord. Pol L. Majer (Paul L. Maier), profesor i historisë së lashtë në Universitetin Uestern Miçigan (Western Michigan University), shkruan: “Argumentet që krishtërimi e sajoi mitin e Pashkëve në një periudhë të gjatë kohe, apo që burimet u shkruan shumë vite pasi ndodhën ngjarjet thjesht nuk janë në përputhje me faktet.”⁸ Duke analizuar kritikën e formës, Ollbrajti shkruan: “Vetëm studiuesit e sotëm, që nuk e kanë as metodën historike, as këndvështrimin e duhur, mund të thurin një rrjetë të tillë hamendjesh si ajo me të cilën kritikët e formës kanë rrethuar traditën e ungjijve.” Konkluzioni i vetë Ollbrajtit

ishte që “një periudhë prej njëzet deri pesëdhjetë vjetësh është tepër e papërfillshme për të lejuar ndonjë humbje të rëndësishme të përmbajtjes thelbësore dhe madje edhe të fjalëve të sakta të Jezusit”⁹ Xhefri L.Sheler (Jeffery L. Sheler), artikullshkrues për fenë për *US News & World Report*, shkruan, “Bibla dhe burimet e saj mbeten të mbështetura fort në histori.”¹⁰

Katër apo njëzet ungjij?

Në romanin e tij tmerrësisht të suksesshëm, *Kodi i Da Vinçit*, autori Den Braun bën deklaratën e guximshme, “Më shumë se tetëdhjetë ungjij u morën në shqyrtim për Dhiatën e Re, por vetëm pak u zgjodhën për t’u përfshirë në të — midis tyre Mateu, Marku, Luka dhe Gjoni.”¹¹ Në vitet 1990 Seminari i Jezusit botoi një libër me titull *The Complete Gospels (Ungjijtë e plotë)* që pretendon të jetë botimi i parë i njëzet ungjijve të njohur nga periudha e hershme e krishterë. Më të famshmit ndër këta janë ungjijtë e Thomait, Judës, Filipit, Pjetrit dhe Marisë. Nënkuptimi është i qartë: këta tekste të lashtë zbulojnë një pamje tjetër të Jezusit, po aq të bazuar sa edhe tradita e lashtë e kishës. A ka ndonjë të vërtetë në këto pretendime? A e kanë humbur katër ungjijtë statusin e tyre të privilegjuar si përçuesit unikë të jetës dhe shërbesës së Jezusit? A po na e transformojnë këta ungjij të sapozbuluar këndvështrimin tonë për krishtërimin? Sado të jashtëzakonshme dhe dramatike të duken këto pretendime, ato thjesht bien nën peshën e analizës historike. Në *Ungjijtë e Fshehur*, historiani



Si mendoni?

A ju besoni librave, artikujve ose dokumentarëve televizivë që flasin për informacion që s'është i lidhur me Biblën por që flasin për besueshmërinë dhe historicitetin e Jezusit? Si do ta krahasonit dëshminë historike për Jezusin me dëshmi të ngjashme për persona të tjerë të njohur?

Filip Xhenkins arrin në përfundimin se “ideja që ungjijtë jokanonikë janë të barazvlefshëm si dëshmitarë të krishtërimit të lashtë është shumë e gabuar.”¹² Sfidë më e madhe për statusin e këtyre ungjijve të tjerë është data e tyre e vonë. Ndërsa të katër ungjijtë u shkruan brenda shekullit të parë, të gjitha të dhënat tregojnë se këta ungjij të tjerë u hartuan

midis viteve 120–250 pas Krishtit, të paktën tre breza larg nga jeta e Krishtit. Për shkak se këta tekste janë shkruar shumë më vonë se katër ungjijtë tradicionalë, nuk ka gjasa që ata të na zbulojnë ndonjë informacion të ri në lidhje me Jezusin historik. Kështu, profesori i Dhiatës së Re, Kreig A. Evans (Craig A. Evans) konkludon, “Të dhënat studimore në lidhje me përdorimin e këtyre ungjijve jashtëkanonikë janë, sinqerisht, turpëruese. . . . Ne kemi zbuluar se këta ungjij jashtëkanonikë nuk ofrojnë informacion të hershëm të besueshëm, të pavarur nga ai që kemi në Ungjijtë e Dhiatës së Re.”¹³ Shpesh jo të krishterët më thonë se nuk mund t’iu besojmë fjalëve që thotë Bibla. “Ajo është shkruar 2000 vjet më parë. Është plot me gabime dhe mospërputhje,” thonë ata. Unë përgjigjem se kam bindjen se mund t’i besoj Biblës.

Pastaj përshkruaj një incident që më ndodhi gjatë një leksioni historie. Unë thashë se besoja se kishte më shumë prova për besueshmërinë e Dhiatës së Re sesa për pothuajse çdo dhjetë vepra të letërsisë klasike të marra së bashku. Profesori ishte ulur në qoshe duke nënqeshur sikur të thoshte, “Epo kjo nuk besohet.” E pyeta pse po qeshte. M’u përgjigj, “Nuk më besohet që ke guximin të thuash në një orë historie se Dhiata e Re është e besueshme. Kjo është qesharake!” Duke dashur të gjeja një pikë të përbashkët për një diskutim prej xhentëlmenësh, e pyeta: “Më thoni zotëri, si historian, cilat janë provat që i aplikoni një shkrimi historik për të përcaktuar saktësinë dhe besueshmërinë e tij?” U habita që ai nuk kishte ndonjë provë të tillë. Në fakt ende nuk kam gjetur një që të më përgjigjet për këtë pyetje. “Unë kam disa prova,” i thashë. I thashë se besoja fort se duhet ta provonim besueshmërinë historike të Shkrimeve biblike me anë të të njëjtave kritere të rrepta që përdorim për të gjitha dokumentet historike. Historiani ushtarak Çonsi Sendërs (Chauncey Sanders) rendit dhe shpjegon tre parimet bazë të historiografisë: *provën bibliografike*, *provën e fakteve të brendshme dhe provën e fakteve të jashtme*.¹⁴ Le të shqyrtojmë secilën prej tyre.

Prova bibliografike

Prova bibliografike është shqyrtimi i mënyrës së transmetimit të dokumenteve të lashta deri në ditët tona. Me fjalë të tjera, meqë nuk i kemi dorëshkrimet origjinale, duhet të bëjmë pyetjen: Sa të besueshme

janë kopjet që kemi? Sa dorëshkrime kanë mbijetuar? Sa përputhen me njëri-tjetrin? Cili është intervali kohor midis origjinalit dhe kopjeve ekzistuese? Ne mund ta vlerësojmë pasurinë e madhe të dorëshkrimeve për Dhiatën e Re duke e krahasuar atë me materialin tekstual që mbështet shkrime të tjera të lashta.

Nga Historia e Tukididit (460–400 para Krishtit) kemi vetëm tetë dorëshkrime të viteve 900 pas Krishtit, pothuaj 1300 vjet pasi u shkrua origjinali.

Edhe dorëshkrimet e historisë së Herodotit janë të një kohe të vonë dhe të pakta. Dhe megjithatë, siç konkludon F. F. Bruce (Brus), Profesor Rajlënds (Rylands) i Kritikës Biblike dhe Ekzegjezës në Universitetin e Mançesterit,

*Asnjë studiues i klasikëve nuk do ta vinte në dyshim autenticitetin e Herodotit apo Tukididit për arsye se dorëshkrimet më të vjetra të veprave të tyre janë mbi 1,300 më të vona se origjinali.*¹⁵

Aristoteli e shkroi *Poetikën* rreth vitit 343 para Krishtit, dhe kopja më e hershme që kemi i përket vitit 1100 pas Krishtit (një hapësirë kohore prej pothuaj 1400 vjetësh), dhe vetëm 49 dorëshkrime ekzistojnë sot.

Cezari e shkroi historinë e tij të luftimeve galike midis viteve 58 dhe 50 para Krishtit dhe sot kemi nëntë apo dhjetë kopje që datojnë një mijë vjet pas vdekjes së tij.

“ ‘Të marrim Tacitin,’ thotë Brus Metzger (Bruce Metzger), autor dhe redaktor i pesëdhjetë librave mbi autoritetin e dorëshkrimeve të Dhiatës së Re,

‘historianin romak që shkroi Kronikat e Romës Perandorake rreth vitit 116 pas Krishtit.

Gjashtë librat e parë ekzistojnë sot vetëm në një dorëshkrim dhe ai ishte kopjuar rreth vitit 850 pas Krishtit. Librat 11-16 janë në një tjetër dorëshkrim të shekullit të njëmbëdhjetë. Librat shtatë deri në 10 kanë humbur.

Kështu që ka një hapësirë të madhe kohore midis kohës kur Taciti e mblodhi dhe e shkroi informacionin e tij dhe kopjeve të vetme ekzistuese. Në lidhje me historianin e shekullit të parë, Jozefin, kemi nëntë dorëshkrime në greqisht të veprës së tij Luftat Hebreje, dhe këto kopje u shkruan në shekujt e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Ka një përkthim në latinisht nga shekulli i katërt dhe materiale mesjetare në rusisht nga shekujt e njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë.

“ ‘Sasia e materialit të Dhiatës së Re,’ rrëfen Mexger, ‘i lë shumë mbrapa të gjitha veprat e tjera të antikitetit.’ ”¹⁶

Kur shkrova librin e parë në vitin 1977, unë dokumentova 4600 dorëshkrime të Biblës në greqisht, shumë më tepër material sesa ekziston për ndonjë libër tjetër të shkruar në lashtësi. Megjithatë, deri në kohën kur po shkruaj këtë libër, janë gjetur edhe më shumë dorëshkrime në greqisht duke e çuar numrin e tyre në rreth 5600. Daniel Uollas (Wallace), profesor i studimeve të Dhiatës së Re në Seminarin Teologjik të Dallasis

(Dallas Theological Seminary) dhe një nga autoritetet kryesorë në botë në lidhje me tekstin në greqisht dhe me dorëshkrimet e Dhiatës së Re thotë,

*Mbi 200 dorëshkrime biblike (90 nga të cilat janë të Dhiatës së Re) u zbuluan në Sinai në vitin 1975 kur u zbulua një pjesë e fshehur e Kullës së Shën Gjergjit. Disa nga këto dorëshkrime janë shumë të lashta. Ato [dorëshkrimet e gjetura rishtaz] të gjitha konfirmojnë që transmetimi i Dhiatës së Re është bërë me mjaft pastërti dhe që Perëndia di si ta ruajë tekstin nga humbja, zhdukja, shkatërrimi. Përveç dorëshkrimeve, ka 50,000 fragmente të vulosura në kuti. Në ato fragmente janë identifikuar rreth 30 dorëshkrime të veçanta të Dhiatës së Re dhe studiuesit besojnë se mund të ketë edhe më shumë.*¹⁷



Si mendoni?

A besoni ju – ose dikush që njihni ju – se meqë teksti biblik është i hershëm nuk mund të besohet? A ka ndonjë dokument tjetër të hershëm që nuk e keni problem ta besoni?

Kur vijmë tek autoriteti dorëshkrimor i Dhiatës së Re, bollëku i materialit është vërtet mbresëlënës në kontrast me dorëshkrimet e teksteve të tjera klasike. Pas zbulimit të dorëshkrimeve të heshme në papirus që mbushën boshllëkun midis kohës së Krishtit

dhe shekullit të dytë, dolën në dritë edhe një shumicë dorëshkrimesh të tjera.

Nga viti 2009 janë në ekzistencë më shumë se njëzet mijë kopje dorëshkrimesh të Dhiatës së Re. Iliada, që është e dyta pas Dhiatës së Re për nga autoriteti i dorëshkrimeve, ka vetëm 643 dorëshkrime në ekzistencë. Studiuesi hebre Jakob (Jacob) Klausner thotë, “Po të kishim të dhëna të lashta si ato në Ungjij për historinë e Aleksandrit apo Cezarit, nuk do të kishim asnjë dyshim për ata, fare.”¹⁸

Sër Frederik Kenion (Sir Frederic Kenyon), i cili ishte drejtor dhe kryebibliotekar në Muzeun Britanik (British Museum) dhe autoriteti i të cilit mbi dorëshkrimet e lashta nuk kalohet nga askush, konkludon:

*Intervali midis datave të origjinaleve dhe provave më të hershme ekzistuese bëhet aq i vogël sa të jetë i pallogaritshëm, dhe themeli i fundit për ndonjë dyshim se mos Shkrimi i Shenjtë nuk na ka ardhur siç ishte shkruar në fillim është hequr. Edhe autenticiteti, edhe integriteti i përgjithshëm i librave të Dhiatës së Re mund të quhen të vërtetuara përfundimisht.*¹⁹

Nga viti 2009 janë në ekzistencë më shumë se njëzet mijë kopje dorëshkrimesh të Dhiatës së Re. Iliada, që është e dyta pas Dhiatës së Re për nga autoriteti i dorëshkrimeve, ka vetëm 643 dorëshkrime në ekzistencë.

Të tjerë bien dakord. Peshkopi anglikan dhe historiani i Dhiatës së Re, Stiven Nill (Stephen Neill) thotë se “ne kemi një tekst shumë më të mirë dhe më të besueshëm për

Dhiatën e Re sesa për çfarëdo vepër tjetër të lashtësisë.”²⁰ Kraig (Craig) Blomberg, ish bashkëpunëtor shkencor në Universitetin e Kembrixhit në Angli dhe tani profesor i Dhiatës së Re në Seminarin e Denverit, shpjegon se tekstet e Dhiatës së Re “janë ruajtur në numër shumë më të madh dhe me shumë më shumë kujdes sesa çdo dokument tjetër i lashtë.” Blombergu konkludon se “97–99% e Dhiatës së Re mund të rindërtohet pa patur ndonjë dyshim.”²¹

Studiuesi i greqishtes së Dhiatës së Re, J. Harold Grinli (Greenlee) shton:

Meqenëse studiuesit pranojnë si përgjithësisht të besueshme shkrimet e klasikëve të lashtë megjithëse dorëshkrimet më të vjetra u shkruan shumë kohë pas origjinaleve dhe numri i dorëshkrimeve ekzistuese është në shumë raste aq i vogël, është e qartë se besueshmëria e tekstit të Dhiatës së Re është e sigurt. ²²

Aplikimi i provës bibliografike ndaj Dhiatës së Re na siguron se ajo ka më shumë autoritet dorëshkrimor sesa çdo vepër tjetër e lashtë. Po t’i shtojmë këtij autoriteti më shumë se 130 vjet kritike intensive tekstuale të Dhiatës së Re, arrijmë në përfundimin se kemi pa dyshim një tekst autentik të Dhiatës së Re.

Ç’mund të themi për variantet biblike?

Në vitin 2005, kritiku i tekstit Bart Ehrman krijoi një stuhi polemikash me botimin e librit të tij *Misquoting Jesus (Keqcitimi i Jezusit)*. Pretendimi i tij ishte i

thjeshtë: dorëshkrimet biblike kanë kaq shumë gabime saqë nuk mund ta rikrijojmë tekstin origjinal. Disa nga këto gabime ishin aksidentale, thotë Ehrman, ndërsa të tjerat ishin me qëllim. Sido që të jetë, thotë ai, Dhiata e Re që kemi sot nuk është e besueshme. Një nga pikat kyçe që Ehrman ngre është ekzistenca e 300,000 deri 400,000 varianteve midis dorëshkrimeve të Dhiatës së Re. Një variant tekstual është çdo rast kur dorëshkrimet e Dhiatës së Re kanë fjalë alternative. Meqenëse Dhiata e Re në greqisht që kemi sot ka afro 138,000 fjalë, ideja që ka dy apo tre herë më shumë variante mund të jetë shqetësuese. Por duhet të kuptojmë se numri i madh i varianteve është rezultat direkt i numrit shumë të madh të dorëshkrimeve të Dhiatës së Re që disponojmë. Nuk ka vepra të tjera të lashtësisë që i afrohen pasurisë së dorëshkrimeve të Dhiatës së Re që janë të disponueshme sot. Sa më shumë dorëshkrime që të kesh, aq më shumë variante. Sa më pak dorëshkrime, aq më pak variante. Por nuk është kjo e gjithë tabloja. Kur i shikon variantet më nga afër ndryshon puna. Në shumicën absolute të rasteve variantet janë ndryshime në drejtshkrimin e fjalëve. Për shembull, emri i Gjonit mund të shkruhet me një n ose me 2 n. Patjetër që një variant i këtij lloji nuk e rrezikon aspak kuptimin e tekstit. Ndryshimet në drejtshkrimin e fjalëve përbëjnë afro 75 përqind të të gjithë varianteve²³. Pra ky numër është 225,000 deri në 300,000 i të gjithë varianteve!

Një kategori tjetër e madhe e varianteve konsiston në sinonimet e përdorura në dorëshkrimet e ndryshme.

Për shembull, disa dorëshkrime mund t'i referohen Jezusit me emrin e Tij të përveçëm, kurse të tjerë mund të thonë “Zoti” ose “Ai.” Ndryshime të tilla nuk e vënë në pikëpyetje kuptimin e tekstit. Kur merren parasysh të gjitha variantet, vetëm gati një përqind ka të bëjë me kuptimin e tekstit. Por edhe ky fakt mund të zmadhohet më tepër seç duhet. Për shembull, ka një mosmarrëveshje nëse 1 Gjoni 1:4 duhet përkthyer, “Po i shkruajmë këto gjëra që gëzimi ynë të jetë i plotë” ose “Po i shkruajmë këto gjëra që gëzimi juaj të jetë i plotë.” Megjithëse kjo mosmarrëveshje ka të bëjë me kuptimin e pasazhit, ajo në asnjë mënyrë nuk vë në rrezik ndonjë doktrinë qendrore të besimit të krishterë. Kjo është arsyeja pse autorët e *Reinventing Jesus (Rishpikja e Jezusit)* arrijnë në përfundimin, “Përgjigjia e shkurtër për pyetjen se cilat të vërteta teologjike rrezikohen nga këto variante është— asnjë.”²⁴ Siç e kemi parë në këtë kapitull, ne mund të kemi një shkallë të lartë sigurie në shkrimet e Dhiatës së Re.

Prova e fakteve të brendshme

Prova bibliografike përcakton vetëm që teksti që kemi tani është ai që u shkrua në fillim. Ende mbetet për të vendosur jo vetëm që shkrimi origjinal është i besueshëm, por edhe deri në çfarë shkalle është i besueshëm. Kjo është detyra e kritikës së brendshme, që është prova e dytë e historicitetit e cituar nga Çonsi Sendërs. Apologjeti Xhon Dabju Montgomeri (John W. Montgomery) na kujton se

studiuesit e historisë dhe letërsisë vazhdojnë të ndjekin parimin shumë të drejtë të Aristotelit që

*besimi duhet të jetë nga ana e dokumentit vetë,
dhe jo të përvetësohet pa të drejtë nga kritiku.*

Montgomeri vazhdon:

*Kjo do të thotë që duhen marrë si të vërteta
deklaratat e dokumentit që po analizojmë
dhe jo të supozohen gabime apo mashtrime
përderisa autori nuk e skualifikon veten me anë
të kontradiktave apo pasaktësive.* ²⁵

Luis Gotshalk (Louis Gottschalk), ish profesor i historisë në Universitetin e Çikagos, e përshkruan metodën e tij historike në një udhëzues të përdorur nga shumë njerëz për hetimin e fakteve historike. Gotshalk vë në dukje se aftësia e shkruesit apo dëshmitarit për të thënë të vërtetën është në ndihmë të historianëve në përpjekjet e tyre për të përcaktuar besueshmërinë, “edhe sikur ajo të përmbahet në një dokument të marrë me forcë apo mashtrim, ose është në një mënyrë tjetër e akuzueshme, ose bazohet në thashetheme, ose është nga një dëshmitar i anshëm.” ²⁶

Kjo aftësi për të treguar të vërtetën lidhet ngushtë me afërsinë e dëshmitarit, edhe nga ana gjeografike, edhe nga ana kohore e ngjarjeve që përshkruhen. Tregimet e Dhiatës së Re për jetën dhe mësimet e Jezusit u shkruan nga njerëz që kishin qenë ose dëshmitarë okularë vetë, ose që i kishin marrë ato nga dëshmitarë okularë të ngjarjeve dhe mësimëve të Krishtit. Shikoni këto pjesë të Dhiatës së Re:

*Mbasi shumë vetë ndërmorën të renditin
tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë,
ashtu si na i përcollën ata që ishin bërë nga
fillimi dëshmitarë okularë dhe shërbyes të fjalës,
m'u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha
gjërat me kujdes që nga fillimi, të t'i shkruaj
sipas radhës, fort i nderuari Teofil, që ti të
njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar.
Luka 1:1-4*

Studiuesit pranojnë saktësinë historike të Lukës. “Konsensusi i përgjithshëm i studiuesve si liberalë, edhe konservatorë është që Luka është shumë i saktë si historian,” shpjegon Xhon Mek-Rei (John McRay), profesor i Dhiatës së Re dhe arkeologjisë në Uiton Kollixh (Wheaton College).

*Ai është erudit, është elokuent, greqishtja e tij
është gati klasike për nga cilësia, ai shkruan si
një njeri i arsimuar dhe zbulimet arkeologjike
po tregojnë përsëri e përsëri që Luka është i
saktë në ato që thotë.²⁷*

Luka nuk është i vetmi shkrimtar biblik që e ka merak raportimin e saktë. Shikoni thënie të tjera:

*Sepse nuk jua bëmë të njohur fuqinë dhe ardhjen
e Zotit tonë Jezu Krisht, duke shkuar pas
përrallash të sajuara me mjeshtëri, por sepse jemi
dëshmitarë okularë të madhështisë së tij. 2 Pjetrit 1:16*

*Atë që pamë dhe dëgjuam, ne po jua shpallim,
që edhe ju të keni bashkësi me ne; dhe bashkësia
jonë është me Atin dhe me Birin e tij, Jezu
Krishtin.* 1 Gjonit 1:3

*Dhe ai që ka parë, ka dëshmuar për këtë, dhe
dëshmia e tij është e vërtetë; dhe ai e di se thotë
të vërtetën, që ju të besoni.* Gjoni 19:35

*Atyre, pasi pati vuajtur, iu paraqit i ngjallur me
shumë prova bindëse, duke u parë prej tyre për
dyzet ditë dhe duke folur për gjërat e mbretërisë
së Perëndisë.* Veprat 1:3

*Sepse ne nuk mund të mos flasim për ato që
kemi parë dhe dëgjuar.* Veprat 4:20

Pas shqyrtimit të dëshmive të gjashtë dëshmitarëve okularë (Mateu, Gjoni, Pali, Pjetri, Jakobi dhe Juda), profesori i apologjetikës, Lin (Lynn) Gardner arrin në përfundimin se në krahasim me provat e veprave të tjera letrare të antikitetit, “ne kemi baza shumë më të mira për vërtetësinë e fakteve në lidhje me Jezusin nga Nazareti.” ²⁸ Kjo afërsi kaq



Si mendoni?

Pasi keni lexuar gjashtë dëshmitarët biblikë më lart, çfarë fraze nga deklaratat e tyre ju bën të konsideroni vërtetësinë e dëshmisë? Çfarë emocionesh duket sikur sjellin këto dëshmi?

e madhe e shkrimtarëve ndaj ngjarjeve që shkruan i e bën dëshminë e tyre shumë të besueshme. Kujtesa e tyre është ende e freskët. Megjithatë historiani duhet të ketë parasysh faktin që dëshmitarët okularë, megjithëse në gjendje për të thënë të vërtetën, me qëllim ose pa dashje mund të japin dëshmi të rreme. Dr. Norman Geisler (Geisler), themelues i Seminarit Ungjillor të Jugut (Southern Evangelical Seminary), e përmbledh dëshminë e dëshmitarëve okularë:

Edhe numri i madh i rrëfimeve të dëshmitarëve okularë të pavarur për Jezusin ... si edhe natyra dhe integriteti i dëshmitarëve vetë lë jashtë çdo dyshimi besueshmërinë e dëshmimeve të apostujve për Krishtin. ²⁹

Shkrimet e Dhiatës së Re për Krishtin qarkullonin në publik në kohën kur ende jetonin bashkëkohësit e tij. Këta njerëz që jetuan në një kohë me Të, me siguri mund të konfirmonin ose mohonin saktësinë e këtyre shkrimeve.

Shkrimet e Dhiatës së Re për Krishtin qarkullonin në publik në kohën kur ende jetonin bashkëkohësit e tij. Këta njerëz që jetuan në një kohë me Të, me siguri mund të konfirmonin ose mohonin saktësinë e këtyre shkrimeve. Kur apostujt po mbronin çështjen e ungjillit, ata iu referuan (edhe përballë me kundërshtarët e tyre më të egër) fakteve që i dinin të dyja palët për Jezusin. Ata nuk thanë vetëm, 'Ne pamë këtë gjë' apo 'Dëgjua atë gjë,' por iu thanë sy ndër sy kritikëve të tyre, "Edhe ju i

dini këto gjëra. I patë vetë, i dini.” Shikojeni sfidën në pasazhet e mëposhtme:

Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjalë: Jezusi Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju me anë të ti tij, siç edhe vet e dini. Veprat 2:22

Dhe, ndërsa Pali i thoshte këto gjëra në mbrojtje të tij, Festi tha me zë të lartë: “Pal, ti je tërbuar; studimet e shumta të bënë të shkallos”. Por ai tha: “Unë nuk jam tërbuar, shumë i shkëlqyeri Fest, por them fjalë të së vërtetës dhe të mendjes së shëndoshë. Sepse mbreti, të cilit unë po i flas lirisht, është i mirinformuar për këto gjëra, sepse unë jam i bindur se asnjë nga këto gjëra nuk është e panjohur për të, sepse e gjithë kjo nuk është bërë në fshehtësi.” Veprat 26:24-26

Duhet kujdes kur u thua kundërshtarëve, “E dini edhe ju,” sepse nëse të tjerët nuk e dinë ose nuk janë dakord për hollësitat, sfida të kthehet kundër ty. Në lidhje me këtë, F.F. Brus thotë:

Predikuesit e hershëm nuk kishin përmballë vetëm dëshmitarë okularë miqësorë; kishte të tjerë më pak miqësorë që i njihnin faktet kryesore të shërbesës dhe vdekjes së Jezusit. Dishepujt nuk mund të rrezikonin me pasaktësira (për të mos folur për manipulime të qëllimshme të fakteve), që do të nxirreshin

në shesh menjëherë nga ata që do të ishin të lumtur ta bënë këtë. Përkundrazi, një nga pikat e forta në predikimin e hershëm apostolik është referimi i sigurt ndaj fakteve që dëgjuesit i dinin; ata nuk thanë vetëm, “Ne jemi dëshmitarë të këtyre gjërave,” por edhe “Siç edhe vetë e dini” (Veprat 2:22). Po të kishte patur ndonjë prirje nga ana e tyre për t’iu shmangur të vërtetës, prania e mundshme e dëshmitarëve armiqësorë në audiencë do të kishte shërbyer si një korrigjim. ³⁰

Lorens Xhei Mek-Ginli (Lawrence J. McGinley) i Kolegjit të Shën Pjetrit (Saint Peter’s College) komenton mbi vlerën e dëshmitarëve armiqësorë në lidhje me ngjarjet e shkruara:

Së pari, dëshmitarët okularë të ngjarjeve në fjalë ishin ende gjallë kur tradita ishte formuar plotësisht; dhe midis atyre dëshmitarëve okularë kishte armiq të egër të lëvizjes së re fetare. Megjithatë tradita deklaronte se po tregonte një sërë ngjarjesh të mirënjohura dhe doktrinash të mësuar publikisht në një kohë kur gënjeshttrat mund dhe do të nxirreshin në shesh. ³¹

Kjo është arsyeja pse historiani i mirënjohur Dejvid Hekit Fishër (David Hackett Fischer), profesor i historisë në Universitetin Brendis (Brandeis University), shpjegon

se fjala e apostujve në cilësinë e dëshmitarëve okularë është “prova më e mirë.”³² Studiuesi i Dhiatës së Re Robert Grant i Universitetit të Çikagos konkludon:

Në atë kohë kur ata [ungjijtë sinoptikë] ishin shkruar ose mund të supozojmë se ishin shkruar, kishte dëshmitarë okularë dhe dëshmia e tyre nuk mund të hidhej poshtë aq lehtë. . . . Kjo do të thotë që ungjijtë duhet të konsiderohen si dëshmi shumë të besueshme të jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit. ³³

Historiani Uill (Will) Durant, që është trainuar në disiplinën e hetimit historik dhe e ka shpenzuar jetën duke analizuar shkrime të lashtësisë, shkruan:

Pavarësisht nga paragjykimet dhe keqkuptimet teologjike të ungjiltarëve, ata kanë shkruar shumë incidente që, po të ishte se po sajnin diçka, duhet t'i kishin fshehur—konkurrimi i apostujve për vende të larta në Mbretëri, arratia e tyre pas arrestimit të Jezusit, mohimi i Pjetrit, pamundësia e Jezusit për të bërë mrekulli në Galile, referencat e disa prej dëgjuesve të tij se ai ishte i çmendur, pasiguria e tij në fillim për misionin e tij, pranimi se nuk dinte gjëra që kishin të bënin me të ardhmen, momentet e hidhërimit, thirrja dëshpëruese nga kryqi; askush që i lexon këto skena nuk mund ta vërë në dyshim realitetin e figurës që gjendet pas tyre. Që disa njerëz të zakonshëm

në një brez të kishin shpikur një personalitet kaq tërheqës, një etikë kaq të lartë, dhe një vizion kaq frymëzues të vëllazërisë së njerëzve, do të ishte një mrekulli shumë më e pabesueshme sesa çdonjëra nga ato që janë shkruar në Ungjij. Pas dy shekujsh Kritike të Lartë skicat e jetës, karakterit dhe mësimëve të Krishtit mbeten mjaft të qarta dhe përbëjnë faktin më mahnitës në historinë e njeriut perëndimor. ³⁴

Prova e fakteve të jashtme

Prova e tretë e historicitetit është ajo e fakteve të jashtme. Çështja këtu është nëse materiale të tjera historike e konfirmojnë apo e mohojnë dëshminë e brendshme të dokumenteve vetë. Me fjalë të tjera, cilat burime, përveç shkrimeve që po analizohen, e mbështesin saktësinë, besueshmërinë dhe autenticitetin e dokumentit? Luis

Prova e tretë e historicitetit është ajo e fakteve të jashtme. Çështja këtu është nëse materiale të tjera historike e konfirmojnë apo e mohojnë dëshminë e brendshme të dokumenteve vetë.

Gotshalk thotë se “konformiteti apo përputhja me fakte të tjera historike ose shkencore është shpesh testi vendimtar i provave, qoftë i një, qoftë i më shumë dëshmitarëve.” ³⁵

Dy miq dhe dishepuj të apostullit Gjon konfirmojnë provat e brendshme që dalin në shkrimet e Gjonit. I pari ishte Papias, peshkopi i Hierapolisit (viti 130 pas Krishtit). Historiani Euseb citon shkrimet e Papiasit si më poshtë:

*Plaku [apostulli Gjon] thoshte edhe këtë:
“Marku, duke qenë përkthyesi i Pjetrit, shkroi
me saktësi gjithçka që ai [Pjetri] përmendi,
thënie apo bëma të Krishtit, por jo sipas
rradhës. Sepse ai nuk ishte as dëgjues, as
shoqërues i Zotit; por më pas, siç thashë, ai
shoqëroi Pjetrin, që i përshtati mësimet e tij
sipas nevojës, jo sikur po bënte një përmbledhje
të thënieve të Zotit. Kështu që Marku nuk bëri
asnjë gabim, duke i shkruar në këtë mënyrë disa
gjëra siç i përmendte ai; sepse ai kishte kujdes
për një gjë, të mos hiqte asgjë nga ato që kishte
dëgjuar, të mos fuste asnjë deklaratë të rreme
midis tyre.”* ³⁶

Miku i dytë i Gjonit ishte njëri nga dishepujt e tij, Polikarpi, që u bë peshkop i Smirnës dhe që kishte qenë i krishterë për tetëdhjetë e gjashtë vjet. Nxënësi i Polikarpit, Ireneu, më vonë pershkop i Lionit, (në vitin 180 pas Krishtit) shkroi ato që kishte mësuar nga Polikarpi (dishepulli i Gjonit):

*Mateu e publikoi ungjillin e tij midis hebrenjve
në gjuhën e tyre, kur Pjetri dhe Pali po
predikonin ungjillin në Romë dhe po themelonin
kishën atje. Pas largimit të tyre [d.m.th. vdekjes,
të cilën tradita me fakte bindëse e vendos në
kohën e përndjekjes së Neronit në vitin 64 pas
Krishtit], Marku, dishepulli dhe përkthyesi i
Pjetrit, na e dha vetë në formë të shkruar thelbin*

e predikimit të Pjetrit. Luka, ndjekësi i Palit, e shkroi në një libër ungjillin e predikuar nga mësuesi i tij. Pastaj Gjoni, dishepulli i Zotit, i cili iu mbështet në kraharor [kjo është referencë ndaj Gjorit 13:25 dhe 21:20] vetë shkroi ungjillin e tij, ndërsa jetonte në Efes, në Azi. ³⁷



Si mendoni?

Edhe pse ka dëshmi arkeologjike, prapë se prapë kritikët shprehen se Shkrimet Biblike nuk janë të sakta historikisht. Për çfarë arsye ata nuk e marrin parasysh këtë lloj dëshmie? Në këtë diskutim, a ka ndonjë dëshmi që është e pamohueshme për ju?

Në librin *Jezusi historik: Prova të lashta për Jetën e Krishtit* (*The Historical Jesus: Ancient Evidence for the Life of Christ*), Geri (Gary) Habermas dokumenton me kujdes provat jashtëbiblike për Jezusin historik. Dokumente greke, romake dhe hebreje ofrojnë mbështetje për elemente kyçe të jetës, shërbesës dhe vdekjes së Jezusit. Këto prova përfshijnë shembuj shumë domethënës

si (1) kryqëzimi i Jezusit nga romakët; (2) adhurimi i Jezusit si hyjni; (3) besimi në ringjalljen e Jezusit; (4) fakti që Jezusi ishte vëllai i Jakobit; dhe (5) varri bosh. Habermas konkludon se “burime të lashta jashtëbiblike paraqesin një shumicë të habitshme detajesh në lidhje me jetën e Jezusit dhe natyrën e krishtërit të hershëm.”³⁸

Arkeologjia shpesh siguron fakte të jashtme të forta. Ajo kontribuon në kritikën biblike jo në fushën e frymëzimit

dhe zbulesës, por duke paraqitur fakte në lidhje me saktësinë e ngjarjeve të shkruara. Arkeologu Xhozef Fri (Joseph Free) shkruan: “Arkeologjia ka konfirmuar mijëra pasazhe që janë hedhur poshtë nga kritikët si jo historikë apo kontradiktorë me faktet e njohura.”³⁹

Ne e kemi parë tashmë se si arkeologjia bëri që Sër Uilliam Remzi të ndryshonte bindjet e tij fillimisht negative në lidhje me historicitetin e Lukës dhe të arrinte në përfundimin se libri i Veprave ishte i saktë në përshkrimin e gjeografisë, veprave të antikitetit dhe shoqërisë së Azisë së Vogël. F. F. Brus vëren se “atje ku Luka është dyshuar për pasaktësi, dhe saktësia është vërtetuar nga ndonjë provë mbishkrimore [e jashtme], mund të themi me të drejtë se arkeologjia e ka konfirmuar shkrimin e Dhiatës së Re.”⁴⁰

A. N. Shëruin-Uajt (Sherwin-White), një historian klasik, shkruan se “për Veprat provat që konfirmojnë historicitetin janë të shumta.” Ai vazhdon duke thënë se “çdo përpjekje për të hedhur poshtë historicitetin edhe në çështje detajesh tani duket absurde. Historianët romakë e kanë marrë atë për të mirëqenë para shumë kohësh.”⁴¹

Pasi u mundova personalisht të hidhja poshtë historicitetin dhe vlefshmërinë e Shkrimeve të Shenjta, u detyrova të arrijnë përfundimin se ato janë të besueshme historikisht. Nëse dikush e hedh Biblën poshtë si historikisht jo të besueshme, atëherë

**Nëse dikush
e hedh Biblën
poshtë si
historikisht jo
të besueshme,
atëherë ai apo
ajo duhet të
hedhë poshtë të
gjithë letërsinë
e antikitetit.**

ai apo ajo duhet të hedhë poshtë të gjithë letërsinë e antikitetit. Asnjë dokument tjetër nuk ka aq shumë prova për të konfirmuar besueshmërinë e vet. Një problem me të cilin përballem gjithmonë është dëshira nga ana e shumë njerëzve për të zbatuar një standard për të testuar letërsinë laike, dhe një standard tjetër për të testuar Biblën. Duhet të zbatojmë të njëjtin standard, sido që të jetë letërsia që po hetojmë, laike apo fetare. Pasi e kam bërë vetë këtë jam i bindur se Bibla është historikisht e besueshme në dëshminë e saj për Jezusin.

Klark H. Pinok, (Clark H. Pinnock), profesor emeritus i teologjisë sistematike në Mek-Master Diviniti Kollixh (McMaster Divinity College), thotë:

*Nuk ekziston asnjë dokument nga bota e lashtë që të mbështetet nga një komplet kaq i shkëlqyer dëshmish tekstuale dhe historike, dhe që ofron një shumicë të tillë të dhënash historike mbi të cilat të merret një vendim inteligjent. Një njeri i sinqertë nuk mund të hedhë poshtë një burim të këtij lloji. Skepticizmi në lidhje me kredencialet historike të krishtërimit bazohet në një paragjykim jo të arsyeshëm [d.m.th. antimbinatyror].*⁴²

Daglas Grotuis (Douglas Groothuis), profesor i asociuar i departamentit të filozofisë së fesë në Seminarin e Denverit, vë në dukje se “Dhiata e Re konfirmohet me anë të dorëshkrimeve të lashta më mirë sesa çdo vepër e letërsisë së lashtë.”⁴³

Kush do të vdiste për një gënjeshtër?

ATA QË E SFIDOJNË KRISHTËRIMIN SHPESH E ANASHKALOJNË NJË FUSHË TË PROVAVE: shndërrimin e apostujve të Jezusit. Jeta e ndryshuar rrënjësisht e këtyre njerëzve na jep dëshmi të fortë për vlefshmërinë e deklaratave të tij.

Meqenëse besimi i krishterë është historik, ne duhet të mbështetemi shumë në dëshmi, të shkruara edhe gojore. Fjala “histori” ka shumë përkufizime, por ai që më duket më i qartë mua është “një njohje e së shkuarës bazuar mbi dëshmi.” Nëse mbështetja në dëshmi të tillë duket sikur i jep historisë një themel të pasigurt, duhet të pyesim, si mund të mësojmë ndryshe për të kaluarën? Si mund ta dimë se ka jetuar Napoleoni? Asnjë nga ne nuk ishte në kohën e tij. Ne nuk e kemi parë apo takuar. Ne s’kemi ç’bëjmë tjetër veçse të mbështetemi në dëshmi.

Njohja jonë e historisë ka një problem të vetvetishëm: a është e besueshme dëshmia? Meqë njohja jonë e krishtërimit bazohet në dëshmi të dhëna në të kaluarën

e largët, duhet të pyesim nëse mund të mbështetemi në saktësinë e tyre. A ishin të besueshme dëshmitë gojore të fillimit për Jezusin? A mund t'iu besojmë atyre që kanë transmetuar saktësisht ato që Jezusi tha dhe bëri? Besoj se mundemi.

Është e vështirë të gjesh njëmbëdhjetë njerëz në histori që të kenë vdekur për një gënjeshtër, duke e ditur se ishte gënjeshtër.

Unë mund t'iu besoj dëshmime të apostujve sepse, nga ata dymbëdhjetë burra, njëmbëdhjetë vdiqën si dëshmorë sepse shpallën dy të vërteta solide: ringjalljen e Krishtit dhe besimin se Ai ishte Biri i Perëndisë. Ata u torturuan dhe u rrahën, dhe më në fund u vranë me metodat më mizore të njohura atëherë: ¹

- 1) Pjetri i quajtur fillimisht Simon—u kryqëzua
- 2) Andrea—u kryqëzua
- 3) Mateu—u vra me shpatë
- 4) Gjoni—vdekje natyrale
- 5) Jakobi, biri i Alfeut—u kryqëzua
- 6) Filipi—u kryqëzua
- 7) Simon Zelotasi—u kryqëzua
- 8) Tadeu—u vra me shigjetë
- 9) Jakobi, vëllai i Jezusit—u vra me gurë
- 10) Thomai—u vra me heshtë
- 11) Bartolomeu—u kryqëzua
- 12) Jakobi, biri i Zebedeut—u vra me shpatë

Përgjigjia që dëgjoj zakonisht është “Vdiqën për një gënjeshtër. Shumë njerëz kanë vdekur për një gënjeshtër. Çfarë provon kjo?”

Po, shumë njerëz kanë vdekur për një gënjeshtër, por duke besuar se ishte e vërteta. Por, po qe se ringjallja nuk do të kishte ndodhur, patjetër që dishepujt do ta dinin. Nuk ka se si të ishin të gënjer për këtë. Prandaj po qe se ishte gënjeshtër, ata jo vetëm që vdiqën për në gënjeshtër, por e *dinin* se ishte gënjeshtër. Është e vështirë të gesh njëmbëdhjetë njerëz në histori që të kenë vdekur për një gënjeshtër, duke e ditur se ishte gënjeshtër.

Le të shohim disa faktorë që do të na ndihmojnë të kuptojmë realitetin e asaj që besonin ata.

1. Ata ishin dëshmitarë okularë

Në librin e tij studimor të vitit 2006 *Jesus and the Eyewitnesses* (*Jezusi dhe dëshmitarët okularë*), profesori i Dhiatës së Re, Riçard Bokam (Richard Bauckham) tregon se të katër ungjijtë japin dëshmi të besueshme që mund të gjurmohen deri tek vetë dëshmitarët okularë.² Apostujt shkruan dhe dishepuj të tjerë folën si dëshmitarë okularë të ngjarjeve që përshkruan. Pjetri tha: “Sepse nuk ua bëmë të njohur fuqinë dhe ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht duke shkuar pas përrallash të sajua me mjeshtëri, por sepse jemi dëshmitarë okularë të madhështisë së Tij” (2 Pjetrit 1:16).

Apostujt e dinin patjetër ndryshimin midis mitit apo legjendës dhe realitetit.

Në letrën e tij të parë, Gjoni theksoi se ata ishin dëshmitarë okularë të gjërave të kishin thënë,



Si mendoni?

A do të vdisje për dikë ose diçka? Pse ndihesh kështu?

duke shpjeguar se si ai dhe apostujt e tjerë e morën informacionin në lidhje me atë që Jezusi “bëri” dhe “tha”:

“Atë që ishte nga fillimi, atë që dëgjuam, atë që pamë me sytë tanë, atë që vështruam dhe duart tona e prekën lidhur me Fjalën e Jetës (dhe jeta u shfaq dhe ne e pamë dhe dëshmojmë për të, dhe ju shpallim jetën e përzeshme që ishte pranë Atit dhe na u shfaq neve), Atë që pamë dhe dëgjuam ne po jua shpallim, që edhe ju të keni bashkësi me ne; dhe bashkësia jonë është me Atin dhe me Birin e Tij, Jezu Krishtin” (1 Gjonit 1:1-3).



Si mendoni?

A keni qënë ndonjëherë dëshmitar okular i një ngjarje?
A iu keni treguar të tjerëve ngjarjen?
A ju besuan? Çfarë e bën një dëshmitar të besueshëm?

Gjoni e filloi pjesën e fundit të ungjillit të tij duke thënë, “Jezusi bëri edhe shumë shenja të tjera në prezencën e dishepujve të tij, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër” (Gjoni 20:30).

Luka tha, “Mbasi shumë vetë ndërmorën të renditin tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë, ashtu si na i përcollën ata që ishin bërë nga fillimi dëshmitarë okularë dhe shërbyes të fjalës, m’u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi, të t’i shkruaj sipas radhës, fort i nderuari Teofil” (Luka 1:1-3).

Pastaj në librin e Veprave, Luka përshkroi periudhën 40 – ditore pas Ringjalljes, kur ndjekësit e Jezusit e vëzhguan Atë nga afër:

“Tregimin e parë e bëra, o Teofil, mbi të gjitha gjërat që Jezusi nisi të bëjë dhe të mësojë, deri në ditën në të cilën u muarr në qiell, pasi u kishte dhënë urdhërime nëpërmjet Frymës së Shenjtë apostujve që ai kishte zgjedhur. Atyre, pasi pati vuajtur, iu paraqit i ngjallur me shumë prova bindëse, duke u parë prej tyre për dyzet ditë dhe duke folur për gjërat e mbretërisë së Perëndisë.” (Veprat 1:1-3).

Tema qendrore e dëshmive okulare që pasojnë është ringjallja e Jezusit. Apostujt ishin dëshmitarë të ringjalljes së Jezusit.

2. Atyre duhej t’ju mbushej mendja

Apostujt menduan se kur Jezusi vdiq, gjithçka mbaroi. Kur ai u arrestua, ata u fshehën (shih Marku 14:50). Kur dëgjuan se varri ishte bosh, ata nuk e besuan në fillim (shih Luka 24:11). Vetëm pasi patën shumë prova bindëse besuan. Pastaj kemi Thomain, i cili tha se do të besonte se Krishti ishte ringjallur vetëm nëse do të vinte gishtin në plagët e Krishtit. Thomai më vonë vdiq si dëshmor për Krishtin. Mos ishte i mashtruar? Ai vuri bast jetën e tij që nuk ishte i mashtruar. Pastaj vjen Pjetri. Ai e mohoi Zotin e tij disa herë gjatë gjyqit dhe më në fund e braktisi. Por diçka e ndryshoi krejt këtë frikakak. Pak kohë pas kryqëzimit dhe varrimit të Krishtit, Pjetri na del në Jerusalemin duke predikuar me guxim, nën kërcënimin e vdekjes, se Jezusi ishte Krishti dhe ishte ringjallur. Më në fund, Pjetri u kryqëzua (me kokë poshtë, siç thotë tradita). Çfarë mund ta ketë kthyer këtë arratiak

së tmerruar në një luan të guximshëm për Jezusin? Pse papritur Pjetri ishte i gatshëm të vdiste për të? Mos ishte i mashtruar? Vështirë. I vetmi shpjegim që ma mbush mendjen është ajo që lexojmë tek 1 Korintasve 15:5, që pas ringjalljes së Krishtit, “ai u pa nga Pjetri.” Pjetri ishte dëshmitar i ringjalljes së Zotit të tij dhe besoi—deri atje sa ishte gati të vdiste për besimin e tij. Shembulli klasik i një njeriu të cilit i është mbushur mendja për diçka kundër vullnetit të vet ishte Jakobi, vëllai i Jezusit. (Megjithëse



Si mendoni?

Shumicën e kohës të afërmit e Jezusit ishin dyshues në lidhje me atë që bëri dhe tha ai. Zakonisht, të afërmit janë ata që i rezistojnë më fort ndryshimit që mund të ndodhë një pjesëtari tjetër të familjes. Pse mendoni që ndodh kështu?

Jakobi nuk ishte njëri nga të Dymbëdhjetët [shih Mateu 10:2-4], ai më vonë u njoh si apostull [shih Galatasve 1:19], si edhe Pali edhe Barnaba [shih Veprat 14:14]]. Kur Jezusi filloi shërbesën, Jakobi nuk e besoi se vëllai i tij ishte Biri i Perëndisë (shih Gjoni 7:5). Pa dyshim Jakobi mori pjesë me vëllezërit e tij në talljen e Jezusit, duke thënë

ndoshta gjëra të tilla si: “A do që njerëzit të besojnë në ty? Pse nuk shkon në Jerusalemin dhe të bësh spektakël me mrekullitë dhe shërimet e tua?” Jakobi duhet të jetë ndjerë i turpëruar që i vëllai shkonte lart e poshtë duke turpëruar emrin e familjes me deklaratat e tij të çmendura: “Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta. Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje” (Gjoni 14:6);

“Unë jam hardhia, ju jeni shermendet” (Gjoni 15:5); “Unë jam bariu i mirë; unë i njoh delet e mia dhe ato më njohin mua” (Gjoni 10:14). Si do të ishte për ju nëse vëllai juaj do të shkonte nëpër qytet duke thënë gjëra të tilla? Por Jakobit i ndodhi diçka. Pasi Jezusi

u kryqëzua dhe u varros, Jakobi po predikonte në Jerusalem. Mesazhi i tij ishte që Jezusi vdiq për mëkatet tona dhe u ringjall dhe është i gjallë. Më vonë Jakobi u bë një nga figurat qendrore në kishën e Jerusalemit dhe shkroi Letrën e Jakobit. Ai e fillon atë letër kështu, “Jakobi shërbëtori i Perëndisë dhe i Zotit Jezu Krisht” (Jakobi 1:1). Më në fund Jakobi u vra me gurë me urdhër të Ananias, kryepriutit.³ Çfarë mund ta kishte

Çfarë mund ta kishte ndryshuar Jakobin nga një përqeshës të turpëruar në një njeri të gatshëm për të vdekur për hyjninë e të vëllait? Jakobi e pa Krishtin e ringjallur dhe besoi.

ndryshuar Jakobin nga një përqeshës të turpëruar në një njeri të gatshëm për të vdekur për hyjninë e të vëllait? Mos ishte i mashtruar? Jo. I vetmi shpjegim i arsyeshëm është ajo që lexojmë në 1 Korintasve 15:7: “Më pas [pas ringjalljes, Krishti] iu shfaq Jakobit.” Jakobi e pa Krishtin e ringjallur dhe besoi. J. P. Moreland, profesor i filozofisë në Shkollën e Teologjisë Talbot (Talbot School of Theology), shpjegon domethënien e faktit që Jakobi, vëllai i Jezusit, më në fund e besoi Jezusin si Mesia:

Ungjijtë na tregojnë se familja e Jezusit, duke përfshirë edhe Jakobin, ishin të turpëruar me ato që Jezusi thoshte. Ata nuk i besonin;

madje e qortuan. Në judaizmin e atëhershëm ishte shumë e turpshme për një rabi kur nuk e pranonte familja. Prandaj, autorët e ungjijve nuk kishin arsye pse ta sajnin këtë skepticizëm po të mos ishte i vërtetë. Më vonë historiani Jozefi na thotë se Jakobi, vëllai i Jezusit, që ishte udhëheqës në kishën e Jerusalemit, u vra me gurë për shkak të besimit në vëllain e tij. Pse ndryshoi jeta e Jakobit? Pali na thotë: Jezusi i ringjallur iu shfaq atij. Nuk ka tjetër shpjegim. ⁴

Po të ishte Ringjallja gënjeshtër, apostujt do ta kishin ditur. Mos kishin rënë dakord të përhapnin një mashtrim kolosal? Kjo nuk përputhet me atë që dimë për moralin e jetës së tyre. Ata personalisht e dënonin gënjeshtren dhe theksonin sinqeritetin. Ata i nxitën njerëzit të mësonin të vërtetën. Historiani Eduard Gibon (Edward Gibbon) në veprën e tij të famshme *The History of the Decline and Fall of the Roman Empire (Historia e të tatëpjetës dhe rënies së perandorisë romake)* jep si një nga pesë arsyet kryesore të përhapjes së shpejtë të krishtërimit “moralin më të pastër, por më të ashpër të të krishterëve të parë.”⁵

Majkëll Grin (Michael Green), bashkëpunëtor i vjetër shkencor në Uiklif Holl në Universitetin e Oksfordit (Wycliffe Hall, Oxford University), vëren se Ringjallja ishte besimi që i ktheu ndjekësit zemërthyer të një rabini të kryqëzuar në dëshmitarët e guximshëm dhe dëshmorët e kishës së hershme. Ky ishte i vetmi besim që ndante ndjekësit

e Jezusit nga judenjtë dhe i ktheu ata në komunitetin e ringjalljes. Mund t'i burgosje, t'i rrihje, t'i vrisje, por nuk mund t'i bëje të mohonin bindjen e tyre që “ditën e tretë ai u ringjall.” ⁶

3. Ata u bënë të guximshëm

Sjellja e guximshme e apostujve menjëherë pasi u bindën për ringjalljen e bën të vështirë të mendosh se ishte një mashtrim. Ata u bënë të guximshëm pothuajse brenda natës. Pas Ringjalljes, Pjetri i cili e kishte mohuar Krishtin, u ngrit dhe shpalli se Jezusi ishte i gjallë edhe nën kërcënimin me vdekje. Autoritetet i arrestuan ndjekësit e Jezusit dhe i rrahën, megjithatë ata shumë shpejt dolën prapë në rrugë duke folur për Jezusin (shih Veprat 5:40-42). Miqtë e vunë re optimizmin e tyre dhe armiqtë vunë re guximin. Të mos harrojmë se apostujt nuk e kufizuan guximin në qytete të vogla. Ata predikuan në Jerusalemin. Ndjekësit e Jezusit mund të mos ishin përballur me torturë dhe vdekje nëse nuk do të kishin qenë të bindur për ringjalljen e Tij. Unanimiteti i mesazhit të tyre dhe sjellja e tyre ishte mahnitëse. Mundësitë që një grup kaq i madh të bjerë dakord për një temë kaq të diskutueshme janë shumë të vogla, megjithatë të gjithë këta burra ranë dakord për të vërtetën e Ringjalljes.

Ndjekësit e Jezusit mund të mos ishin përballur me torturë dhe vdekje nëse nuk do të kishin qenë të bindur për ringjalljen e Tij. Unanimiteti i mesazhit të tyre dhe sjellja e tyre ishte mahnitëse.

Po të ishin mashtrues, është e vështirë të shpjegohet pse të paktën njëri prej tyre nuk u thye nën presionin që provuan. Blez Paskal, filozofi francez shkruan:

Akuza se Apostujt ishin mashtrues është fare absurd. Le ta ndjekim akuzën deri në konkluzionin e saj logjik. T'i përfytyrojmë ata dymbëdhjetë burra, duke u takuar pas vdekjes së Krishtit, dhe duke u marrë vesh për të thënë se Ai u ringjall. Kjo do të kishte qenë një sulm, si ndaj autoriteteve civile, ashtu edhe atyre fetare. Zemra e njeriut është çuditërisht e dhënë pas lëkundjes dhe ndryshimit; ajo lëkundet nga premtime, tundohet nga gjëra materiale. Nëse njëri nga këta burra do të ishte dorëzuar ndaj tundimeve aq tërheqëse, ose do të ishte thyer përpara kërcënimit të burgut e torturës, ata të gjithë do të kishin qenë të humbur. ⁷

“Kur Jezusi u kryqëzua,” shpjegon J. P. Moreland, ndjekësit e tij ishin të dekurajuar dhe të depresuar. Ata nuk kishin më besim se Jezusi ishte dërguar nga Perëndia, sepse besonin se ai që kryqëzohej ishte i mallkuar nga Perëndia. Gjithashtu ata kishin mësuar se Perëndia nuk do ta linte Mesinë e Tij të vdiste. Kështu që u shpërndanë. Lëvizja Jezus u shua që në djep. Pastaj, pas një periudhe të shkurtër kohe, ne i shohim të lënë punët, të mblidhen sërish dhe të përkushtohen për të përhapur një mesazh

shumë specifik—që

Jezu Krishti ishte

Mesia i Perëndisë

që vdiq në kryq, u

rikthye në jetë dhe

që u pa i gjallë prej

tyre. Dhe ata ishin të

gatshëm të shpallnin

gjithë jetën këtë,

pa ndonjë leverdi

nga pikëpamja njerëzore. Nuk është që po i

priste ndonjë vilë në Mesdhe. Jeta që bënë ishte

e vështirë. Shpesh ndenjën pa ngrënë, fjetën

jastë, u përqeshën, u rrahën, u burgosën. Dhe

më në fund, pjesa më e madhe e tyre u ekzekutua

në mënyrë barbare. Për çfarë? Për qëllime të

mira? Jo, sepse ata ishin të bindur pa asnjë fije

dysimi se e kishin parë Jezusin të ringjallur

nga të vdekurit. Ajo që nuk mund të shpjegohet

është se si ky grup njerëzish e krijoi këtë bindje

pa patur një përjetim të Krishtit të ringjallur.

Nuk ka asnjë shpjegim tjetër të pranueshëm.⁸

“Si u kthyen, pothuaj brenda natës,” pyet

Majkëll Grin, “në grupin e papërmbajtshëm të

entuziastëve që i bënë ballë kundërshtimeve,

cinizmit, përqeshjeve, vështirësive, burgut dhe

vdekjes në tre kontinente, duke predikuar kudo

Jezusin dhe ringjalljen?”⁹



Si mendoni?

A i admironi njerëzit

që janë gati të

përkushtohen

deri në vdekje

për njëçështje?

Çfarë ju tërheq te

këta njerëz? Çfarë

ju tremb? A ka

ndonjë gjë që mund

të mësosh prej

përkushtimit të tyre?

Një autor tregon me shumë mjeshtëri ndryshimet që ndodhën në jetët e apostujve:

Në ditën e kryqëzimit ata ishin të mbushur me trishtim; në ditën e parë të javës me gëzim.

Gjatë kryqëzimit ata ishin pa shpresë; ditën e parë të javës zemrat e tyre ishin plot me siguri dhe shpresë. Kur u erdhi fillimisht mesazhi i ringjalljes, ata ishin mosbesues dhe ishte e vështirë t'iu mbushej mendja, por sapo u siguruan, nuk dyshuan më kurrë. Cili ishte

Shumica e ndjekësve të Jezusit u ekzekutuan në forma torturuese. Për çfarë? Sepse ishin të bindur që kishin parë Jezu Krishtin të ringjallur nga të vdekurit.

shkaku i këtij ndryshimi kaq drastik në këta njerëz për një kohë kaq të shkurtër? Thjesht heqja e trupit nga varri nuk mund ta kishte transformuar kurrë shpirtin dhe karakterin e tyre. Tri ditë nuk mjaftojnë për të krijuar një legjendë që do t'i ndikonte kaq shumë. Për t'u krijuar një legjendë duhet kohë. Ky është një fakt psikologjik që kërkon shpjegim të

plotë. Mendoni për karakterin e dëshmitarëve, njerëz që i dhanë botës mësimin më të lartë etik që ajo ka njohur ndonjëherë dhe që, edhe sipas fjalëve të armiqve të tyre, e jetuan atë etikë. Mendoni sa absurde është nga ana psikologjike të përfytyrosh një grup të mundur frikacakësh që dridhen në një dhomë të sipërme një ditë dhe pas pak ditësh shndërrohen në një grup që

nuk ua mbyll dot gojën asnjë përndjekje—dhe pastaj të përpiqesh t'ia atribuosh këtë ndryshim dramatik asgjëje më bindëse sesa një sajimi të mjerë që po përpiqeshin ta luanin në kurrizin e botës. Kjo thjesht nuk ka kuptim. ¹⁰

Historiani i kishës, Keneth Skot Laturet (Kenneth Scott Latourette) shkruan:

Efekti i ringjalljes dhe i ardhjes së Frymës së Shenjtë mbi dishepujt ishte . . . me rëndësi të madhe. Nga njerëz të dekurajuar, të zhgënjyer, që kujtonin me mall ditët kur kishin shpresuar se Jezusi “ishte ai që do ta çlironte Izraelin,” ata u kthyen në një grup dëshmitarësh entuziastë. ¹¹

N.T. Rajt (N. T. Wright), ish profesor i Studimeve të Dhiatës së Re në Universitetin e Oksfordit në Angli, shpjegon,

Historiani duhet të thotë, “Si ta shpjegojmë faktin që kjo lëvizje u përhap si zjarri në ferrishte me Jezusin si Mesia, megjithëse Jezusi ishte kryqëzuar?” Përgjigjia duhet të jetë, mundet të jetë vetëm, sepse Ai u ringjall nga të vdekurit. ¹²

Pol Litl (Paul Little), që ishte profesor i asociuar i ungjillizimit në Shkollën Teologjike Ungjillore Trinia (Trinity Evangelical Divinity School), shtron pyetjen:

A janë këta burra, që ndihmuan në

*transformimin e strukturës morale të shoqërisë, gënjeshhtarë të përsosur apo të çmendur? Këto alternativa janë më të vështira për t'u besuar sesa fakti i Ringjalljes, dhe nuk ka asnjë grimë provash për t'i mbështetur.*¹³

Qëndrueshmëria e apostujve deri në vdekje nuk mund të anashkalohet. Sipas Enciklopedisë Britanike, filozofi Origen shkruan se Pjetri u kryqëzua me kokë poshtë. Historiani i kishës Herbert B. Workman (Herbert B. Workman) e përshkruan vdekjen e apostullit:

*Kështu Pjetri, siç kishte profetizuar Zoti ynë, u “ngjesh” nga dikush tjetër, dhe “u çua” për të vdekur në Rrugën Aureliane, në një vend afër kopshteve të Neronit, në kodrën e Vatikanit, ku shumë nga vëllezërit e tij kishin pësuar një vdekje mizore. Me kërkesën e tij ai u kryqëzua me kokë poshtë, si i padenjë për të vuajtur si Zoti i tij.*¹⁴

Harold Matingli (Mattingly), që ishte profesor emeritus në Universitetin e Lidsit, shkruan në tekstin e tij të historisë: “Apostujt, Shën Pjetri dhe Shën Pali, e vulosën dëshminë e tyre me gjakun e tyre.”¹⁵ Tertuliani shkruan se “anjë njeri nuk do të ishte i gatshëm të vdiste nëse nuk do ta dinte se kishte të vërtetën.”¹⁶ Profesori i jurisprudencës në Harvard, Sajmon Grinlif (Simon Greenleaf), një njeri që ka mbajtur leksione për vite të tëra për mënyrën si të thyesh një dëshmitar dhe të dallosh

nëse ai po gënjen apo jo, konkludon:

Kronikat e luftave pothuajse nuk kanë shembuj të tillë të qëndresës heroike, durimit, dhe guximit të palëkundur. Ata kishin çdo motiv të mundshëm për të rishikuar me kujdes bazat e besimit të tyre, dhe provat e fakteve dhe të vërtetave të mëdha që shpallnin. ¹⁷

Profesori i historisë Lin (Lynn) Gardner pyet,
Pse do të vdisnin për diçka që e dinin se ishte gënjeshtër? Një njeri mund të mashtrohet dhe të vdesë për një gënjeshtër. Por apostujt ishin në gjendje t'i dinin faktet në lidhje me ringjalljen e Jezusit, dhe përsëri vdiqën për të. ¹⁸

Tom Anderson, ish president i Shoqërisë së Avokatëve të Kalifornisë (California Trial Lawyers Association) thotë,

Le të supozojmë se ato që janë shkruar për shfaqjen

e Tij ndaj qindra njerëzve janë të rreme. Unë dua të shtroj një pyetje: Me një ngjarje kaq të publikuar, a nuk mendoni se do të ishte e arsyeshme që një historian, një dëshmitar okular, një kundërshtar të shkruante, për të gjitha kohërat, se e kishte parë trupin e Krishtit?. Heshtja e historisë në lidhje me dëshmi kundër ringjalljes është shurdhuese. ¹⁹

Heshtja e historisë në lidhje me dëshmi kundër ringjalljes është shurdhuese.



Si mendoni?

Sa shumë besueshmëri na ofrojnë dishepujt e Jezusit nga përkushtimi i tyre deri në vdekje për besimin e tyre tek Jezusi? A mund të bënin dishepujt ndonjë gjë më shumë për të treguar përkushtimin dhe sinqeritetin e tyre në lidhje me bindjet e tyre për Krishtin?

J. P. Moreland vëren, “Asnjë historian që njoh nuk dyshon se krishtërimi filloi në Jerusalem vetëm pak javë pas vdekjes së Jezusit në prani të dëshmitarëve okularë miqësorë dhe armiqësorë.”²⁰

Për më tepër, siç konkludon Uilliam Lejn Kreig (William Lane Craig), profesor i filozofisë në Shkollën Teologjike Talbot,

Vendi i varrit të

*Jezusit ishte i njohur si për të krishterët, ashtu edhe për judenjtë. Kështu që, nëse ai nuk do të ishte bosh, do të ishte e pamundur që të dilte një lëvizje e themeluar në besimin në Ringjalljen në po atë qytet ku ky njeri u ekzekutua publikisht dhe u varros.*²¹

Apostujt kaluan përmes provës së vdekjes për të provuar vërtetësinë e asaj që po shpallnin. Unë mendoj se mund t'i besojmë dëshmisë së tyre më shumë sesa asaj të shumë njerëzve që takoj sot. Më vjen keq që gjej kaq shumë njerëz që kanë bindje aq të dobëta, saqë nuk shkojnë as nga ana tjetër e rrugës për to, e jo më të vdesin.

Ç'na duhet një Mesi i vdekur?

SHUMË NJERËZ KANË VDEKUR PËR ÇËSHTJET NË TË CILAT BESONIN. Në vitet 1960, shumë budistë u dogjën të gjallë, në mënyrë që të tërhiqnin vëmendjen e botës në lidhje me padrejtësitë në Azinë juglindore. Në fillim të viteve '70, një student nga San Diego dogji veten si protestë ndaj luftës në Vietnam. Në shtator të vitit 2001, disa ekstremistë myslimanë rrëmbyen avionë me pasagjerë dhe u përplasën në kullat e Qendrës Botërore të Tregtisë dhe në Pentagon për të shkaktuar dëme ndaj një kombi, të cilin ata e konsiderojnë si armik të fesë së tyre. Apostujt mendonin se kishin një kauzë të mirë për të cilën të vdisnin, por ata u shtangën dhe u zhgënjyen kur ajo kauzë e mirë vdiq në kryq. Ata besuan se Ai ishte Mesia. Nuk mendonin se Ai mund të vdiste. Ishin të bindur se Ai ishte i vetmi që mund të vendoste Mbretërinë e Perëndisë dhe të qeveriste popullin e Izraelit dhe vdekja e Tij i bëri pluhur shpresat e tyre.



Si mendoni?

A keni dëgjuar për ndonjë person që ka “kompleksin e Mesias”? A jeni në gjendje ta shpjegosh domethënien e këtij termi? Si ndryshon sjellja e Jezusit nga pritjet që kanë njerëzit për Mesian – Shpëtimtarin?

Për të kuptuar marrëdhënien e apostujve me Krishtin dhe se pse Kryqi ishte kaq i pakuptueshëm për ta, duhet kuptuar mirë qëndrimi kombëtar për Mesinë në kohën e Krishtit. Jeta dhe mësimet e Tij binin shumë ndesh me kuptimin që hebrenjtë kishin për

Mesinë në atë kohë. Hebrenjve u mësohej që në fëmijëri se kur të vinte Mesia, Ai do të ishte një udhëheqës politik fitimtar dhe mbret. Ai do t'i çlironte hebrenjtë nga romakët dhe do t'i kthente Izraelit vendin që i takonte me të drejtë si një komb i pavarur që do të shkëlqente si pishtar në të gjithë botën. Një Mesi i vuajtur ishte “një ide plotësisht e huaj për konceptin që hebrenjtë kishin për Mesinë”.¹

Profesori E. F. Skot (Scott) i Seminarit të Unionit Teologjik jep shpjegimin e tij për atmosferën e kohës së Krishtit:

“Ishte një periudhë trazimi të madh. Për udhëheqësit fetarë ishte pothuajse e pamundur ta përmbanin vrullin e popullit, i cili po priste kudo për shfaqjen e Çlirimtarit të premtuar. Kjo gjendje pritjeje pa dyshim që ishte ushqyer edhe më shumë nga ngjarjet historike të asaj kohe.

Romakët kishin më shumë se një brez që shtypnin lirinë e hebrenjve dhe masat e tyre të

shtypjes kishte nxitur shpirtin e patriotizmit duke i ndezur një zjarr edhe më të fortë. Ëndrra e një çlirimi të mrekullueshëm dhe e një mbreti mesianik, i cili do ta bënte atë realitet, mori kuptim të ri në atë kohë kritike; por kjo ëndërr në vetvete nuk kishte asgjë të re. Pas këtyre trazirave për të cilat kemi prova në Ungjij, ne mund të dallojmë një periudhë të gjatë pritjeje me gjithnjë e më shumë padurim.

Për shumicën e njerëzve Mesia mbetej Ai që kishte qenë për Isaian dhe për bashkëkohësit e tij, Biri i Davidit, i Cili do t'i sillte fitore dhe begati kombit hebre. Nën dritën e referencave që gjejmë në Ungjij, vështirë të vihet në dyshim fakti se koncepti i shumicës së njerëzve për Mesinë ishte kryesisht kombëtar dhe politik.”²

Studiuesi hebre Jozef Klausner shkruan: “Mesia u bë gjithnjë e më shumë jo vetëm një udhëheqës i madh politik, por edhe një njeri me cilësi të larta morale.”³ Jakob Gartenhaus, themelues i Bordit Ndërkombëtar të Misioneve Hebreje, reflekton besimet mbizotëruese hebreje të kohës së Krishtit: “Hebrenjtë e prisnin Mesinë si Atë që do t'i çlironte nga pushtimi romak. ...Shpresa mesianike ishte kryesisht për një çlirim kombëtar.”⁴

Enciklopedia Hebreje pohon se hebrenjtë prisnin me padurim premtimin e çlirimtarit nga shtëpia e Davidit, i cili do t'i çlironte nga

zgjedha e pushtuesit të huaj të urryer, do t'i jepte fund sundimit të papastër romak dhe do të vendoste mbretërinë e Vet të paqes dhe drejtësisë në vendin që i takonte.”⁵

Jezusi ndryshonte kaq shumë nga ideja që kishin gjithë hebrenjtë për Birin e Davidit, sa që vetë dishepujve të Tij u dukej pothuajse e pamundur ta lidhnin idenë e Mesias me Të.

Në atë kohë, hebrenjtë gjenin strehim në Mesinë e premtuar. Apostujt besonin të njëjtat gjëra si njerëzit përreth tyre. Mirëpo, siç thotë Millar Bërous i Shkollës Teologjike të Universitetit të Jejlit pohon, “Jezusi ndryshonte kaq shumë nga ideja që kishin gjithë hebrenjtë për Birin e Davidit, sa që, vetë dishepujve të Tij, u dukej pothuajse e pamundur ta lidhnin idenë e Mesisë me Të.”⁶

Dishepujt nuk i mirëpritën aspak parashikimet e zymta të Jezusit në lidhje me kryqëzimin e Tij (shihni Luka 9:22).

Profesori skocez i Dhiatës së Re A. B. Brus (Bruce), vëren se

duket se ata shpresonin se Ai në fakt thjesht e shikonte me pesimizëm situatën dhe se frikërat e Tij do të dilnin të pabaza...një Krisht i kryqëzuar ishte skandal dhe kontradiktë për apostujt; pothuajse po aq sa vazhdoi të ishte edhe për shumicën e popullit hebre pasi Zoti ishte ngjitur në lavdi.”⁷

Alfred Eders'haim, dikur Lektor Grinfield mbi Septuagintën në Universitetin e Oksfordit, ka të drejtë kur arrin në përfundimin se “koha kur jetoi Krishti ishte shumë e papërshtatshme për të”.⁸ Realiteti i personit ishte plotësisht në kundërshtim me pritjet e asaj kohe.

Ne mund të shohim shumë lehtë në Dhiatën e Re qëndrimin e apostujve ndaj Krishtit. Çdo gjë në Të përputhej me pritjet e tyre për Mesinë mbret.

Pasi Jezusi u tha atyre se duhej të shkonte në Jerusalemin për të vuajtur, Jakobi dhe Gjoni e shpërfillën këtë parashikim të zymtë dhe i kërkuan Atij t’u premtonte se në Mbretërinë e Tij ata do të uleshin në të djathtë e në të majtë të Tij (shihni Marku 10:32-38). Për ç’lloj Mesie po mendonin ata – për një Mesi të vuajtur e të kryqëzuar? Jo.

Ata e shihnin Jezusin si një sundimtar politik.

Ai u tha se ata e kishin keqkuptuar atë që Ai duhej të bënte. Ata nuk dinin çfarë po kërkonin. Kur Ai parashikoi hapur vuajtjen dhe kryqëzimin e Vet, ideja ishte kaq e huaj për apostujt, saqë ata nuk mund ta kuptonin se çfarë donte të thoshte Ai (shihni Luka 18:31-34).

Për shkak se ishin mësuar që në fëmijëri të prisnin Mesinë, ata mendonin se kishin gjetur diçka të mirë.



Si mendoni?

A ka ndonjë ide që kishit rreth Jezusit që tashmë është “tronditur”? Që është konfirmuar? Pse nxënësit e Jezusit e kishin të vështirë të kuptonin me saktësi se kush ishte ai që në fillim?

Pastaj erdhi Kalvari. Të gjitha shpresat se Jezusi ishte Mesia i tyre vdiqën në kryq. Ata u kthyen në shtëpitë e tyre të dekurajuar se gjithë ato vite me Jezusin kishin shkuar dëm.

Xhorxh Eldon Led, ish-profesor i Dhiatës së Re në Seminarin Teologjik Fuller, shkruan:

Kjo është edhe arsyeja pse dishepujt e Tij e braktisën kur u arrestua. Mendjet e tyre ishin kaq plotësisht të mbushura me idenë e një Mesie fitimtar, roli i të Cilit ishte të nënshtronte

Hebrenjtë ishin keqkuptuar. Patriotizmi kombëtar i tyre i kishte bërë ata të prisnin një Mesi që do të shpëtonte kombin e tyre. Por Ai që në fakt erdhi ishte një Mesi që do të shpëtonte botën. Një Mesi, i Cili nuk do të shpëtonte vetëm një komb nga shtypja politike, por gjithë njerëzimin nga pasojat e përjetshme të mëkatit.

armiqtë e Tij, saqë kur e panë të thyer dhe të gjakosur nën goditjet e kamxhikut, të burgosur të pashpresë në duart e Pilatit, dhe kur e panë që e merrnin dhe e çonin tutje, të gozhduar në kryq për të vdekur si një kriminel i zakonshëm, të gjitha shpresat e tyre mesianike për Jezusin u shkatërruan. Është një fakt i mirëfilltë psikologjik se ne dëgjojmë vetëm çfarë jemi të përgatitur të dëgjojmë. Parashikimet e Jezusit për vuajtjet dhe vdekjen e Tij ranë në vesh të shurdhër. Dishepujt, pavarësisht nga paralajmërimet e Tij, nuk ishin të përgatitur për këtë.⁹

Por disa javë pas kryqëzimit, pavarësisht nga dyshimet e tyre të mëparshme, dishepujt ishin në Jerusalem, duke shpallur Jezusin si Shpëtimtarin dhe Mesinë e hebrenjve.

I vetmi shpjegim logjik që unë mund të shoh për këtë ndryshim është ajo që lexoj tek 1 Korintasve 15:5: “edhe se iu shfaq Kefës dhe pastaj të dymbëdhjetëve.”

Çfarë tjetër mund të kishte bërë që dishepujt e dëshpëruar të shkonin të vuanin e të vdisnin për një Mesi të kryqëzuar? Jezusi “Atyre, pasi pati vuajtur, iu paraqit i ngjallur me shumë prova bindëse, duke u parë prej tyre për dyzet ditë dhe duke folur për gjërat e mbretërisë së Perëndisë.” (Veprat e Apostujve 1:3).

Këta njerëz mësuan të vërtetën për identitetin e Jezusit si Mesia. Hebrenjtë ishin keqkuptuar. Patriotizmi kombëtar i tyre i kishte bërë të prisnin një Mesi që do të shpëtonte kombin e tyre. Por Ai që në fakt erdhi ishte një Mesi që do të shpëtonte botën. Një Mesi, i Cili nuk do të shpëtonte vetëm një komb nga shtypja politike, por gjithë njerëzimin nga pasojat e përjetshme të mëkatit. Vizioni i apostujve kishte qenë tepër i vogël. Papritur ata panë të vërtetën më të gjerë. Po, shumë njerëz kanë vdekur për një çështje të mirë, por çështja e mirë e apostujve kishte vdekur në kryq. Të paktën kështu menduan në fillim.



Si mendoni?

A ju ka ndodhur ndonjëherë që pritjet tuaja të jenë përmbysur krejt? Si mendoni se janë ndjerë dishepujt në momentin që e kuptuan se Jezusi ishte Mesia i ringjallur?

Vetëm kontakti i tyre me Krishtin pas ringjalljes i bindi këta njerëz se Ai ishte me të vërtetë Mesia. Për këtë ata dëshmuan jo vetëm me gojën dhe jetën e tyre, por edhe me vdekjen e tyre.

A keni dëgjuar se çfarë i ndodhi Saulit?

XHEKU, NJË MIKU IM I KRISHTERË I CILI KA FOLUR NË shumë universitete, mbërriti në një qendër studentore një mëngjes dhe zbuloi se studentët e kishin rregulluar që ai atë natë të merrte pjesë në një diskutim publik me “ateistin e universitetit.” Kundërshtari i tij ishte një profesor elokuent i filozofisë, kundërshtar i fortë i krishtërit. Xheku do të fliste i pari. Ai parashtroi prova të ndryshme për ringjalljen e Jezusit, si dhe për kthimin në besim të apostullit Pal, e pastaj tregoi dëshminë e tij personale se si Krishti i kishte ndryshuar jetën kur ishte student në universitet.

Kur profesori i filozofisë u ngrit të fliste, ishte disi nervoz. Ai nuk mund t’i mohonte provat për Ringjalljen dhe as dëshminë personale të Xhekut, kështu që sulmoi kthimin radikal në krishtërim të apostullit Pal. Ai përdori argumentin se njerëzit shpesh mund të përfshihen aq shumë psikologjikisht në atë kundër së cilës luftojnë,

saqë përfundojnë duke e pranuar atë.

Miku im buzëqeshi me mirësjellje dhe u përgjigj, “Atëherë, zotëri, kujdes se mos bëheni i krishterë.” Historia e apostullit Pal është një nga dëshmitë më të mëdha për krishtërimin. Sauli nga Tarsi, i cili ishte ndoshta kundërshtari më i egër i krishtëritimit të hershëm, u bë apostulli Pal, folësi më energjik dhe më me ndikim i lëvizjes së re. Pali ishte hebre i kulluar, udhëheqës fetar. Lindja në Tars i dha mundësinë të njëjës me mësimet më të përparuara të kohës së tij. Tarsi ishte një qytet universitar i njohur për filozofët stoikë dhe për kulturën e tij. Straboni, gjeografi grek, e lavdëronte Tarsin për interesin e tij të madh për arsim dhe filozofi.¹

Pali, ashtu si dhe i ati, kishte qytetari romake, që ishte një privilegj shumë i madh. Ai dukej se e njohte mirë kulturën dhe mendimin helen.

Zotëronte në mënyrë të shkëlqyer gjuhën greke dhe shfaqte aftësi të mahnitshme dialektike. Ai shpesh citonte nga poetë dhe filozofë jo shumë të njohur: Në një nga predikimet e veta, Pali citon dhe aludon Epimenidin, Aratin dhe Kleantin: “Në Të ne jetojmë, lëvizim dhe egzistojmë. Ashtu siç kanë thënë disa nga poetët tuaj: “Mos u gënjeni; shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira.” (1 Korintasve 15:33). Në një letër të mëvonshme drejtuar Titit, Pali përsëri citon Epimenidin: “Një prej tyre, pikërisht një profet i tyre, tha,: “Kretasit janë gjithnjë gënjeshtarë, egërsira të këqija, barkpërtacë.” (Titit 1:12).

Pali kishte arsim hebre të cilin e kreu nën doktrinat e rrepta të farisenjve. Kur ishte rreth katërmëdhjetë vjeç,

Pali udërguatë studenten në mentorimin e Gamalielit, që ishte nipi i Hilelit dhe një nga rabinët më të mëdhenj të kohës. Pali pohonte se nuk ishte vetëm farise, por edhe bir farisenjsh (shihni Veprat 23:6). Ai mund të mburrej duke thënë: “Dhe si përparoj në judaizëm më tepër se shumë bashkëkohës të kombit tim, duke qenë jashtëzakonisht i zellshëm për traditat e etërve të mi.” (Galatasve 1:14).



Si mendoni?

Apostulli Pal i ndryshoi krejtësisht bindjet e tij në lidhje me Jezusin pasi përjetoi një takim jetëndryshues me Të. A keni parë ju ndonjëherë një transformim të tillë? A keni përjetuar vetë ndonjëherë një transformim të ngjashëm?

Për ta kuptuar kthimin e Palit është e nevojshme të shikojmë se pse ishte ai kaq anti i krishterë. Ishte përkushtimi i tij ndaj ligjit hebre që ndizte kundërshtimin e tij të paepur ndaj Krishtit dhe kishës së hershme. “Fyerja që Pali ndiente nga mesazhi i krishterë”, siç thotë edhe teologu francez Zhak Dypon (Jacques Dupont),

nuk vinte nga pohimi se Jezusi ishte Mesia [por] ... nga fakti se Jezusit i atribuohet një rol shpëtues, gjë që i zhvishte ligjit të gjithë vlerën në qëllimin e shpëtimit... [Pali ishte] armik i dhunshëm i besimit të krishterë për shkak të rëndësisë që i jepte ligjit si udhë shpëtimi.²

Enciklopedia Britanike (Encyclopaedia Britannica) thotë se anëtarët e një sekti të ri të judaizmit të cilët e

Anëtarët e një sekti të ri të judaizmit të cilët e quanin veten të krishterë godisnin thelbin e mësimit hebre dhe të studimeve rabinike të Palit. Ai e mori me pasion shfarosjen e këtij sekti.

quanin veten të krishterë godisnin thelbin e mësimit hebre dhe të studimeve rabinike të Palit.³ Ai u vu me pasion ta shfaroste këtë sekt (shihni Galatasve 1:13). Kështu Pali nisi t'i përndiqte të krishterët deri në vdekje (shihni Veprat 26:9-11). Ai nisi me këmbëngulje të shkatërronte kishën (shihni Veprat 8:3). U nis për në Damask me dokumenta që e autorizonin të arrestonte ndjekësit e Jezusit dhe t'i sillte ata në Jerusalem

për t'i nxjerrë para gjyqit. Pastaj Palit i ndodhidiçka .

Ndërkaq Sauli, duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit, shkoi te kryepriifti, dhe kërkoi nga ai letra për sinagogat e Damaskut, me qëllim që, po të gjente ndonjë ithtar të Udhës, burra o gra, të mund t'i sillte të lidhur në Jeruzalem. Por ndodhi që, ndërsa po udhëtonte dhe po i afrohej Damaskut, befas rreth tij vetëtiu një dritë nga qielli. Dhe, si u rrëzua përtokë, dëgjoi një zë që i thoshte: “Saul, Saul, përse më përndjek?” Dhe ai tha: “Kush je, Zot?”. Dhe Zoti tha: “Unë jam Jezusi, që ti e përndjek; është e rëndë për ty të godasësh me shkelm kundër gjembave.” Atëherë ai, duke u dridhur i tëri dhe i trembur, tha: “Zot, ç’do ti të bëj unë?”. Dhe Zoti: “Çohu dhe hyr në qytet, dhe do të të thuhet ç’duhet të bësh.” Dhe njerëzit

që udhëtonin me të ndaluan të habitur, sepse dëgjonin tingullin e zërit, por nuk shikonin njeri. Pastaj Sauli u çua nga toka, por, kur i çeli sytë, nuk shihte asnjëri; atëherë e morën për dore dhe e çuan në Damask. Dhe mbeti tri ditë pa të parit, as hëngri as piu.” Veprat 9:1-12

Ndërkohë që vazhdojmë të lexojmë, mund të shohim se pse të krishterët kishin frikë nga Pali,

“Atëherë Anania u përgjigj: “O Zot, nga shumë veta kam dëgjuar për këtë njeri se sa të këqija u ka bërë shenjtoreve të tu në Jeruzalem. Dhe ai ka këtu një autorizim nga krerët e priftërinjve për të burgosur të gjithë ata që thërrasin emrin tënd.” Por Zoti i tha: “Shko, sepse ai është vegla që unë kam zgjedhur për ta sjellë emrin tim përpara johebrenjve, mbretërve dhe bijve të Izraelit. Sepse unë do t’i tregoj atij sa shumë i duhet të vuajë për emrin tim.” Atëherë Anania shkoi dhe hyri në atë shtëpi; dhe, duke i vënë duart, tha: “Vëlla Saul, Zoti Jezus, që të është shfaqur në rrugën nëpër të cilën ti po vije, më ka dërguar që të kesh përsëri dritën e syve dhe të mbushesh me Frymën e Shenjtë.” Në këtë çast i ranë nga sytë disa si luspa, dhe ai fitoi përsëri të parit; pastaj u ngrit dhe u pagëzua. Dhe, mbasi mori ushqim, ai u ripërtëri në forcë. Pastaj Sauli qëndroi disa ditë me dishepujt që ishin në Damask.” Veprat 9:13-19

Si rezultat i këtij përjetimi, Pali e konsideronte veten dëshmitar të Krishtit të ringjallur. Ai më vonë shkroi: “Po a nuk e pashë Jezus Krishtin, Zotin tonë?” (1 Korintasve 9:1). Ai e krahasonte shfaqjen e Jezusit ndaj tij me shfaqjet që Krishti kishte bërë ndaj apostujve të tjerë pas ringjalljes. “Më së fundi m’u shfaq edhe mua...” (1 Korintasve 15:8).

Pali jo vetëm e pa Jezusin, por e pa në një mënyrë të parezistueshme. Ai nuk e shpalli Ungjillin sepse zgjodhi vetë, por sepse nuk kishte ç’bënte. “Sepse, në qoftë se unë predikoj Ungjillin, s’ka asgjë që unë të mburrem, sepse kjo është një nevojë që më është ngarkuar...” (1 Korintasve 9:16).

Vini re se takimi i Palit me Jezusin dhe më pas kthimi i tij ishin të menjëhershëm e të papritur: “Papritmas një dritë e madhe nga qielli vetëtiu rreth meje.” (Veprat 22:6). Ai nuk e kishte idenë se kush mund të ishte ky person qiellor. Kur zëri shpalli se ishte Jezusi nga Nazareti, Pali u shtang dhe filloi të dridhej.

Në ndoshta nuk i dimë të gjitha detajet ose psikologjinë



Si mendoni?

Si mendoni, pse duhej të ishte kaq dramatik konvertimi i Palit? Nga ndryshonte plani që Perëndia kishte për jetën e Palit nga plani që vetë Pali kishte për jetën e tij?

e asaj që i ndodhi Palit në rrugën për në Damask, por këtë e dimë ama: Kjo përvojë ktheu përmbys plotësisht çdo fushë të jetës së tij.

Së pari, karakteri i Palit u transformua në mënyrë radikale. Enciklopedia

Britanike e përshkruan Palin para kthimit në besim si një fanatik fetar aspak tolerant, të hidhur dhe persekutues, krenar dhe zemërak. Pas kthimit të tij, kjo enciklopedi e përshkruan atë si të duruar, të butë, të përmbajtur dhe vetësakrifikues. ⁴

Keneth Skot Laturet thotë: “Gjithsesi, ajo që e harmonizoi jetën e Palit dhe e ngriti këtë temperament pothuajse neurotik nga të qenit askushi, në një pozicion me ndikim të madh ishte një përjetim shpirtëror i thellë dhe revolucionar.” ⁵

Së dyti, marrëdhënia e Palit me ndjekësit e Jezusit u transformua. Ata nuk kishin më frikë nga ai. Pali “qëndroi disa ditë me dishepujt që ishin në Damask.” (Veprat 9:19).

Dhe kur ai shkoi të takonte apostujt e tjerë, ata e pranuan (Veprat 9:27-28).

Së treti, mesazhi i Palit u transformua. Edhe pse ende e donte shumë trashëgiminë e tij hebreje, ai kishte ndryshuar, nga një kundërshtar i hidhur, në një protagonist të vendosur të besimit të krishterë. “Menjëherë ai nisi të predikojë për Jezusin nëpër sinagoga, duke thënë: ‘Ai është Biri i Perëndisë!’” (Veprat 9:20). Bindjet e tij intelektuale kishin ndryshuar. Përvoja e tij e shtrëngonte të pranonte se Jezusi ishte Mesia, në konflikt të drejtpërdrejtë me idetë mesianike të farisenjve. Këndvështrimi i tij i ri për Krishtin do të

Ne ndoshta nuk i dimë të gjitha detajet ose psikologjinë e asaj që i ndodhi Palit në rrugën për në Damask, por këtë e dimë ama: Kjo përvojë ktheu plotësisht përmbys çdo fushë të jetës së tij.

thoshte një revolucion total në të menduarit e tij. ⁶ Zhak Dypon me mprehtësi vëren se pasi Pali “kishte mohuar me pasion që një njeri i kryqëzuar të ishte Mesia, pranoi me siguri se Jezusi ishte vërtet Mesia dhe, për pasojë, i rishikoi të gjitha idetë e tij mesianike.” ⁷

Gjithashtu, Pali tani mund të kuptonte se vdekja në kryq e Krishtit, e cila ngjante si një mallkim nga Perëndia dhe fund i mjerueshëm i një jete, ishte në fakt pajtimi që Perëndia po bënte ndërmjet Vetes dhe botës përmes Krishtit. Pali mundi të kuptonte se nëpërmjet kryqëzimit Krishti mori mbi Vete mallkimin e mëkatit në vendin tonë (shihni Galatasve 3:13) dhe se Perëndia “bëri të jetë mëkat për ne Ai që nuk njihte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në Të.” (2 Korintasve 5:21). Në vend që ta shihte vdekjen e Krishtit si mposhtje, ai e pa atë si një fitore të madhe, të plotësuar nga Ringjallja. Kryqi nuk ishte më një gur pengese, por thelbi i shfajësimit mesianik të Perëndisë. Predikimi misionar i Palit mund të përmbledhet si “duke deklaruar dhe duke u treguar atyre se Krishti duhej të vuante dhe të ringjallej prej së vdekurish dhe duke thënë: ‘Ky Jezusi që unë ju shpall është Krishti.’” (Veprave 17:3).

Së katërti, misioni i Palit u transformua. Ai u shndërrua nga një urrejtës i paganëve në një misionar për paganët. Ai u shndërrua nga një fanatik hebre, në një ungjilltar mes johebrejve. Si hebre dhe farise, Pali i shihte me përçmim paganët si inferiorë ndaj popullit të zgjedhur të Perëndisë. Ajo që i ndodhi rrugës për në Damask e ktheu atë në një apostull të përkushtuar që

kishte si mision të jetës së tij të ndihmonte paganët. Pali kuptoi se Krishti që iu shfaq atij ishte vërtet Shpëtimtari për të gjithë popujt. Pali, nga farise i mirëfilltë, misioni i të cilit ishte të ruante judaizmin e pastër, u bë propagandues i atij sekti të ri e radikal të quajtur krishtërim, të cilin e kishte kundërshtuar me aq ashpërsi. Ndryshimi në të ishte kaq i thellë saqë “të gjithë ata që e dëgjonin çuditëshin dhe thoshnin:

Në vend që ta shihte vdekjen e Krishtit si mposhtje, ai e pa atë si një fitore të madhe, të plotësuar nga Ringjallja. Kryqi nuk ishte më një gur pengese, por thelbi i shfajësimit mesianik të Perëndisë.

‘Po a nuk është ky ai që në Jerusalem përndiqte të gjithë ata që e thërrisnin këtë emër, dhe ka ardhur këtu me synim që t’i çojë si robër te krerët e priftërinjve?’ Por Sauli bëhej gjithnjë e më i fortë dhe i hutonte Judenjtë që banonin në Damask, duke ua vërtetuar se Jezusi është Krishti.” (Veprat 9:21-22).

Historiani Filip Shaf pohon:

*Kthimi i Palit nuk shënon vetëm një pikë kthese në historinë e tij personale, por edhe një epokë të rëndësishme në historinë e kishës apostolike dhe për pasojë edhe në historinë e njerëzimit. Kjo ishte ngjarja më e frytshme që prej mrekullisë së Pentakostit dhe siguroi fitoren universale të krishtërit.*⁸

Një ditë në kohën e drekës në Universitetin e Hjustonit,



Si mendoni?

Në kohën e tij, Pali kishte një status prej njeriu të famshëm, d.m.th. njerëzit e dinin se kush ishte ai. Sot, kur një person i famshëm bëhet i krishterë, cili është reagimi fillestar i shumicës së njerëzve? A duhet që të krishterët e famshëm të vlerësohen me një standart tjetër nga ata të zakonshmit?

Unë u ula pranë një studenti. Ndërkohë që diskutonim për krishtërimin, ai tha se nuk ekzistonte asnjë provë për krishtërimin apo për Krishtin. Unë e pyeta se përse mendonte kështu. Ai ishte student i historisë dhe një nga librat e tij shkollorë ishte një tekst i historisë romake, i cili përmbante një kapitull që fliste për apostullin Pal dhe për krishtërimin. Ky student e kishte lexuar atë kapitull

dhe kishte parë se ai fillonte duke përshtuar jetën e Saulit nga Tarsi dhe mbaronte duke përshtuar jetën e apostullit Pal.

Libri thoshte se nuk ishte e qartë se çfarë e shkaktoi ndryshimin. Unë shkova te libri i Veprave dhe i shpjegova shfaqjen që Krishti bëri ndaj Palit pas ringjalljes. Studenti e kuptoi menjëherë se ky ishte shpjegimi më logjik për kthimin radikal të Palit. Kjo pjesëz prove e munguar bëri që të merrnin kuptim të gjitha pjesët e tjera. Ai u bë i krishterë më pas. Ilajas Endrus (Elias Andrews), ish-drejtor i Kolegjit Teologjik Kuins (Queens Theological College), komenton:

Shumë njerëz kanë parë në transformimin radikal të këtij “fariseu prej farisenjsh” provën

më bindëse për të vërtetën dhe fuqinë e fesë në të cilën ai u konvertua, si dhe vlerën dhe vendin përfundimtar të Personit të Krishtit. ⁹

Arçibald MekBrajd (Archibald McBride), i cili ka qenë profesor në Universitetin e Aberdinit, shkruan për Palin: “Përballë arritjeve të tij...arritjet e Aleksandrit dhe të Napoleonit janë asgjë.” ¹⁰ Studiuesi i hershëm i krishterë, Klementi i Aleksandrisë, thotë se Pali “u lidh shtatë herë me zinxhirë, predikoi Ungjillin në lindje e në perëndim; arriti në kufi të perëndimit; dhe vdiq si dëshmor nën sundimtarët.” ¹¹

Pali pohon përsëri e përsëri se Jezusi i gjallë e i ringjallur kishte transformuar jetën e tij. Ai ishte kaq i bindur për ringjalljen e Krishtit nga të vdekurit, sa që edhe ai vdiq me një vdekje prej dëshmori për besimin e tij. Dy miq të arsimuar në Oksford, autori Xhilibërt Uest (Gilbert West) dhe burri i shtetit, Lord Xhorxh Litëllton (George Lyttleton), ishin të vendosur të shkatërronin themelin e besimit të krishterë. Uesti do të vërtetonte falsitetin e ringjalljes, dhe Litëlltoni do të vërtetonte se Sauli nga Tarsi nuk u konvertua kurrë në krishtërim. Të dy mbërritën në një kthesë të plotë të pozicioneve të tyre dhe u bënë ndjekës të flaktë të Jezusit.

Lord Litëllton shkruan: “Vetëm konvertimi dhe apostullimi i Shën Palit, i shqyrtuar siç duhet, ishte më vete një demonstrim i mjaftueshëm për të provuar se krishtërimi ishte një Zbulesë Hyjnore.” ¹² Ai përfundon se, nëse njëzet e pesë vitet e vuajtjes dhe shërbimit të Palit

për Krishtin ishin realitet, atëherë edhe kthimi i tij ishte i vërtetë, pasi gjithçka që ai bëri filloi me atë ndryshim të papritur. Dhe nëse kthimi i Palit ishte i vërtetë, atëherë Jezu Krishti ishte ngjallur nga të vdekurit, pasi gjithçka që Pali ishte dhe bëri ia atribuoi takimit të tij me Krishtin e ringjallur.

A mund ta mposhtësh një njeri të mirë?

NJË STUDENT I UNIVERSITETIT TË URUGUAJIT MË PYETI DIKUR, “Profesor MekDauëll, pse nuk mundët të gjenit ndonjë mënyrë për ta hedhur poshtë krishtërimin?” Unë iu përgjigja, “Për një arsye shumë të thjeshtë. Nuk isha në gjendje të përgënjeshtroja faktin se ringjallja e Jezus Krishtit ishte ngjarje historike reale.”

Pasi kisha kaluar më se shtatëqind orë duke studiuar këtë temë dhe duke hetuar imtësisht themelet e saj, unë arrita në përfundimin se ringjallja e Jezus Krishtit është ose një nga rrengjet më të këqia, më të mbrapshta e më të pashpirt që i janë bërë ndonjëherë njerëzimit, ose ajo është fakti më i rëndësishëm në histori.

Ringjallja e nxjerr pyetjen: “A është i vërtetë krishtërimi?” prej fushës së filozofisë dhe ekthen atë në një pyetje historie. A ka krishtërimi një bazë të qëndrueshme historike? A disponojmë ne prova të mjaftueshme për të garantuar besimin në ringjalljen?

Ringjallja e Jezus Krishtit është ose një nga rrengjet më të këqia, më të mbrapshta e më të pashpirt që i janë bërë ndonjëherë njerëzimit, ose ajo është fakti më i rëndësishëm në histori.

Ja disa nga çështjet dhe pretendimet që lidhen me këtë pyetje: Jezusi nga Nazareti, një profet hebre, i cili tha se ishte Krishti i profetizuar në Shkrimet hebreje, u arrestua, u gjykua si një kriminel politik, dhe u kryqëzua. Tri ditë pas vdekjes dhe varrimit të Tij, disa gra shkuan te varri i Tij dhe zbuluan se trupi nuk ishte më aty. Dishepujt e Krishtit thanë se Perëndia e ringjalli Atë nga të vdekurit dhe se Ai iu shfaq atyre

shumë herë para se të ngjitej në qiell.

Prej këtij themeli, krishtërimi u përhap nëpër gjithë perandorinë romake dhe ka vazhduar të ushtrojë ndikim të madh në të gjithë botën përgjatë shekujve në vijim.

Pyetja e madhe është: “A ka ndodhur me të vërtetë ringjallja?”

Vdekja dhe Varrimi i Jezusit

Pasi Jezusi u dënua me vdekje, Atij iu zhveshën rrobat dhe, sipas zakonis romak, u fshikullua para se të kryqëzohej.

Aleksander Metherel (Alexander Metherell), i cili ka një diplomë në mjekësi nga Universiteti i Majemit dhe një doktoraturë në inxhinieri nga Universiteti i Bristolit në Angli, ka bërë një ekzaminim të detajuar të fshikullimit të Krishtit nën duart e romakëve. Ai e përshkruan në këtë mënyrë procesin:

*Ushtarët përdornin një kamzhik me rripa
lëkure të gërshetuar dhe me sfera metalike të
thurura në to. Kur kamzhiku godiste mbi mish,
këto sfera shkaktonin mavijosje të thella ose
shembje, të cilat hapeshin si pasojë e goditjeve
të mëtejshme. Kamzhiku kishte gjithashtu pjesë
kockash të mprehta, të cilat e çanin keq mishin.*

*Kurrizi çahej kaq shumë, saqë ndonjëherë
dukeshin edhe pjesë të shtyllës kurrizore nga
çarjet e thella. Fshikullimi shkonte që nga
shpatullat deri poshtë në kurriz, në vithe dhe në
pjesët e prapme të këmbëve. Ishte diçka vërtet e
tmerrshme.*

*Një mjek, i cili ka studiuar rrahjen e stilit romak
ka thënë, “Ndërsa fshikullimi vazhdon, qjerrjet
vazhdonin në muskujt që gjenden pranë skeletit
dhe nxirrnin në dritë shirita mishi të gjallë të
përgjakur. Një historian i shekullit të tretë me
emrin Euseb e ka përshkruar fshikullimin duke
thënë, “Venat e njeriut që vuante këtë dënim
dilnin jashtë dhe shpesh dukeshin edhe muskujt,
ligamentet dhe zorrët e viktimës.”*

*Shumë njerëz vdisnin nga kjo lloj rrahjeje që
para se të kryqëzoheshin. Të paktën viktima
përjetonte dhimbje të tmerrshme dhe kalonte në
gjendje shoku hipovolemik.¹*



Si mendoni?

A keni parë ndonjëherë ndonjë film për jetën e Jezusit në të cilin përfshihej edhe vdekja dhe ringjallja e Tij, si për shembull filmi i Mel Gibsonit “Pasioni i Krishtit”? Çfarë ju vinte në mendje kur shikonit torturën dhe kryqëzimin e Krishtit? A mendoni se Ai i meritonte ato që i ndodhën?

Duke pasur parasysh brutalitetin e fshikullimit, si dhe kryqëzimin që pasoi, është historikisht e sigurt se Jezusi vdiq. Edhe vetë anëtarët e Seminarit të Jezusit që ishte shumë i pëlqyer në vitet 1990, e kanë pranuar vdekjen e Jezusit. Kjo është arsyeja pse Xhon Dominik Krosan (John Dominic Crossan) ka thënë se vdekja e Jezusit me anë të kryqëzimit “është po aq e

sigurt sa ç’mund të jetë e sigurt çdo gjë historike.”²

Sipas zakoneve hebreje për varrimin, trupi i Jezusit më pas u mbështoll me pëlhurë liri. Kjo pëlhurë u lye me rreth tridhjetë e pesë kilogram vajra erëmira, të përziera për të formuar një substancë gomoze (shih Gjoni 19:39-40). Pasi trupi u vendos në një varr të gdhendur në një shkëmb të fortë, një gur tepër i madh, që peshonte rreth dy ton, u vendos me anë levash përpara hyrjes (shih Mateu 27:60).

Një njësi romake me ushtarë shumë të disiplinuar u caktua të ruante varrin. Frika e ndëshkimit që ata njerëz kishin “sillte si pasojë vëmendje të pagabueshme ndaj detyrës, sidomos gjatë rojës së natës.”³ Kjo njësi roje vuri vulën romake mbi varr, një vulë që tregonte fuqinë dhe autoritetin romak.⁴ Kjo vulë kishte si qëllim

të parandalonte aktet e vandalizmit. Kushdo që përpiquej të lëvizte gurin nga hyrja e varrit do të thyente kështu vulën romake dhe si pasojë do të përballej me zemërimin e ligjit romak.

Gjithsesi, pavarësisht nga roja dhe nga vula, varri ishte bosh.

Varri Bosh

Ndjekësit e Jezusit thanë se Ai ishte ringjallur prej së vdekurish. Ata thanë se Ai u ishte shfaqur atyre përgjatë një periudhe prej dyzet ditësh, duke iu paraqitur atyre i gjallë përmes shumë provash bindëse. Apostulli Pal tha se Jezusi iu shfaq më shumë se pesëqind ndjekësve të Vet njëherazi, shumica e të cilëve ishin ende gjallë asokohe dhe mund ta konfirmonin atë që shkruante ai (shihni 1 Korintasve 15:3-8).

Artur Majkëll Remzi (Arthur Michael Ramsey), ish-kryepeshkop i Kanterberit, shkruan: “Unë besoj në Ringjalljen, pjesërisht sepse një seri faktesh janë të pashpjegueshme pa të.”⁵ Varri bosh ishte diçka “tepër e bujshme për t’u mohuar.”⁶ Teologu gjerman Paul Althaus deklaroi se fjalët për Ringjalljen “nuk mund të kishin duruar as edhe një ditë të vetme në Jerusalem, as edhe një orë të vetme, nëse varri bosh nuk do të ishte pranuar si fakt nga të gjithë njerëzit e përfshirë.”⁷

Paul L. Maier del në përfundimin:

Nëse të gjitha provat peshohen me kujdes dhe me ndershmëri, është e justifikueshme, sipas

kanoneve të kërkimeve historike, të arrijmë në përfundimin se [varri i Jezusit] me të vërtetë ishte bosh... Dhe nuk është zbuluar ende asnjë provë sado e vogël nëpër burimet letrare, epigrafite apo në arkeologji që të mund të përgënjeshtrojë këtë deklaratë. ⁸



Si mendoni?

A keni qenë ndonjëherë pjesë e një grupi dhe ndodhi diçka që ju përfshinte të gjithëve? A ishin të njëjta historitë tuaja? Sa e vështirë është t'i bësh të gjithë të tregojnë saktësisht të njëjtën histori?

Si mund ta shpjegojmë varrin bosh?

Bazuar në provat historike më se të bollshme, të krishterët besojnë se Jezusi u ringjall fizikisht në kohë dhe hapësirë reale përmes fuqisë së mbinatyrshme të Perëndisë. Vështirësitë në besim mund të jenë të mëdha, por problemet e

lidhura me mosbesimin janë edhe më të mëdha.

Situata te varri pas Ringjalljes është me shumë rëndësi. Vula romake u thye, gjë që do të thoshte kryqëzim të menjëhershëm me kokë poshtë për këdo që ta kishte thyer. Guri masiv ishte lëvizur jo vetëm nga hyrja, por nga i gjithë vendvarrimi, dhe dukej sikur e kishin ngritur dhe e kishin çuar tutje. ⁹ Rojet romake kishin ikur që aty. Perandori romak bizantin, Justiniani, në Kronikat e tij 49:16 radhit tetëmbëdhjetë shkelje për të cilat një njësi rojesh romake mund të dënohej me vdekje. Në to përfshihej edhe rënia në gjumë apo braktisja e vendrojes.

Gratë erdhën te varri dhe zbuluan se ai ishte bosh. Ato u frikësuan dhe u kthyen që t'u tregonin burrave. Pjetri dhe Gjoni rendën për te varri. Gjoni mbërriti i pari, por nuk hyri brenda. Ai hodhi shikimin brenda dhe pa rrobat e varrit, pak të shfryra, por bosh. Trupi i Krishtit kishte kaluar nëpër to në një ekzistencë të re. Le ta pranojmë: një pamje e tillë do ta bënte këdo besimtar.

Teori Alternative për Ringjalljen

Shumë njerëz kanë nxjerrë teori alternative për të shpjeguar Ringjalljen, por këto teori janë kaq të trilluara dhe jologjike kur i krahason me pretendimet e krishtërit, saqë vetë dobësia e tyre në fakt ndihmon në ndërtimin e besueshmërisë së të vërtetës së Ringjalljes.

Teoria e Varrit të Gabuar

Një teori e parashtruar nga studiuesi britanik i Biblës Kirsop Lejk (Kirsopp Lake) supozon se gratë, të cilat raportuan faktin se trupi nuk ishte më aty, kishin shkuar gabimisht në një varr tjetër atë mëngjes. Nëse është kështu, atëherë edhe dishepujt që shkuan të kontrollonin nëse kjo ishte e vërtetë duhet të kenë shkuar në varrin e gabuar. Gjithsesi, ne mund të jemi të sigurt se autoritetet

Bazuar në provat historike më se të bollshme, të krishterët besojnë se Jezusi u ringjall fizikisht në kohë dhe hapësirë reale përmes fuqisë së mbinatyrshme të Perëndisë. Vështirësitë në besim mund të jenë të mëdha, por problemet e lidhura me mosbesimin janë edhe më të mëdha.

hebreje, të cilat kishin kërkuar që në atë varr të vendosej një njësi roje romake për të parandaluar vjedhjen e trupit, nuk do të ishin gabuar kurrë në lidhje me vendin në fjalë. As rojet romake nuk do të ishin gabuar, pasi ata ishin aty. Nëse do të bëhej fjalë për një varr të gabuar, autoritetet hebreje nuk do të kishin humbur kohë të tregonin trupin në varrin e saktë, duke shuar kështu një herë e përgjithmonë çdo zë për ringjalljen.

Bazuar në provat historike më se të bollshme, të krishterët besojnë se Jezusi u ringjall fizikisht në kohë dhe hapësirë reale, përmes fuqisë së mbinatyrshme të Perëndisë. Vështirësitë për ta besuar këtë mund të jenë të mëdha, por problemet e lidhura me mosbesimin e saj janë edhe më të mëdha.

Teoria e Haluçinacionit

Një tjetër përpjekje për shpjegim thotë se shfaqjet e Jezusit pas Ringjalljes ishin ose iluzione, ose haluçinacione. Kjo teori bie ndesh me parimet psikologjike që shpjegojnë se si ndodhin haluçinacionet. Nuk është e besueshme të mendosh se pesëqind njerëz mund të kenë parë të njëjtin haluçinacion për dyzet ditë. Gjithashtu, teoria e haluçinacionit nuk përputhet me situatën historike ose gjendjen mendore të apostujve. Pastaj, ku ishte trupi i vërtetë i Jezusit, dhe pse nuk e shfaqën atë ata që i kundërviheshin Atij?

Teoria e të fikëtisë

Racionalisti gjerman i shekullit të nëntëmbëdhjetë,

Karl Venturini, e përhapì teorinë e alivanosjes para disa shekujsh dhe kjo teori sugjerohet shpesh edhe sot. Kjo teori pretendon se Jezusi nuk vdiq vërtet; Ai vetëm ra në gjendje të fikëti si pasojë e sflitjes dhe e humbjes së gjakut. Të gjithë menduan se Ai kishte vdekur, por më vonë Ai e rimori veten dhe dishepujt e Tij menduan se kjo ishte ringjallje.

Teologu gjerman David Fridrih Shtraus (David Friedrich Strauss), i cili vetë nuk beson në Ringjalljen, i jep një goditje përfundimtare çdo ideje se Jezusi mund të ishte përmendur nga një gjendje të fikëti:

Është e pamundur që një qenie, e cila ishte arratisur ashtu gjysmë e vdekur nga vend varrimi, që zvarritej e dobët dhe e sëmurë, që kishte nevojë për trajtim mjekësor, që i duhej fashim, inkurajim dhe përkujdesje, dhe i cili, prapë më në fund iu dorëzua vuajtjeve, t'iu jepte dishepujve përshtypjen se ishte Fitimtar mbi vdekjen dhe varrin, Princi i Jetës, një përshtypje kjo që do të përbënte themelin e shërbesës së tyre të ardhshme. Një 'rikthim' i tillë 'nga vdekja' vetëm mund ta dobësonte përshtypjen që Ai kishte lënë në ta në jetë e në vdekje, ose e shumta do t'i kishte dhënë asaj një ton elegjiak, por kurrsesi nuk do ta kishte kthyer keqardhjen e tyre në entuziazëm, apo të kishte ngritur nderimin e tyre deri në adhurim.¹⁰

Teoria e Trupit të Vjedhur

Një teori tjetër thotë se dishepujt e vodhën trupin e Jezusit kur rojet flinin. Dekurajimi dhe frika e dishepujve përbëjnë një argument të fortë kundër kësaj teorie. A mund të imagjinojmë se ata papritur u bënë kaq trima, saqë të përballeshin me një njësi ushtarësh të zgjedhur që ruanin te varri dhe të vidhnin më pas trupin? Ata nuk ishin në atë gjendje shpirtërore që të tentonin diçka të tillë. Duke komentuar mbi propozimin se dishepujt e vodhën trupin e Krishtit, J. N. D. Anderson thotë:

Kjo do të dilte krejt kundër asaj që dimë për ta: mësimi të tyre etik, cilësisë së jetës së tyre, qëndrueshmërisë së tyre në vuajtje dhe persekutim. Dhe as nuk do të niste të shpjegonte transformimin e tyre dramatik nga të arratisur, të trembur e të demoralizuar në dëshmitarë që asnjë kundërshti nuk mund t'i bënte më të heshtnin. ¹¹

Teoria e Trupit të Zhvendosur

Nëse autoritetet e kishin marrë trupin, pse nuk e shpjeguan ata me saktësi se ku e kishin vendosur? Pse nuk e morën ata kufomën, ta vinin në një karrocë e ta sillnin në qendër të Jerusalemit? Një veprim i tillë do ta kishte shkatërruar krejtësisht krishtërimin.

Një teori tjetër thotë se autoritetet romake ose hebreje e hoqën trupin e Krishtit nga varri. Ky shpjegim nuk është më i arsyeshëm se teoria e trupit të vjedhur. Nëse autoritetet e kishin trupin në zotërimin e tyre ose

nëse e dinin se ku ndodhej, pse nuk shpjeguan se e kishin marrë ata trupin, duke i dhënë fund një herë e përgjithmonë predikimit të apostujve në Jerusalem në lidhje me ringjalljen? Nëse autoritetet e kishin marrë trupin, pse nuk e shpjeguan me saktësi se ku e kishin vendosur? Pse nuk e morën kufomën, ta vinin në një karrocë e ta sillnin në qendër të Jerusalemit? Një veprim i tillë do ta kishte shkatërruar krejtësisht krishtërimin.

Xhon Uorik Montgomeri (John Warwick Montgomery) thotë:

*Që të krishterët e hershëm
të kenë mundur të sajojnë një përrallë të tillë
dhe më pas ta kenë predikuar në mes atyre që
shumë lehtë mund ta kishin përgënjeshtuar,
duke paraqitur trupin e Jezusit, është një gjë që
nuk mund të besohet.*¹²

**Nëse
autoritetet e
kishin marrë
trupin, pse nuk
e shpjeguan
ata me saktësi
se ku e kishin
vendosur? Pse
nuk e morën
ata kufomën,
ta vinin në
një karrocë
e ta sillnin
në qendër të
Jerusalemit?
Një veprim
i tillë do
ta kishte
shkatërruar
krejtësisht
krishtërimin.**

Teoria e Trupit të Rivarrosur

Në librin e tij *Empty Tomb* (Varri bosh), Xhefri Xhei Louder (Jeffrey Jay Lowder) përshkruan një hipotezë, sipas së cilës trupi i Jezusit u vendos përkohësisht në varrin e Jozefit nga Arimatea natën e së premtes para se të vendosej në një varr kriminelësh.¹³

Varri i Jezusit ishte bosh, jo sepse Ai u ringjall, por thjesht sepse trupi i Tij u zhvendos diku tjetër. Kështu, dishepujt gabimisht besuan se Ai u ringjall. Kjo hipotezë ka fituar popullaritet të konsiderueshëm në internet.

“Hipoteza e rivarrosjes” fiton mbështetje nga fakti se rivarrimi ishte diçka e zakonshme në Palestinën antike. Por është e rëndësishme të kuptojmë se procedurat që ndiqnin hebrenjtë për rivarrimin ndryshonin së tepërmi nga teoria e propozuar këtu. Tradita hebreje ishte që trupi të varrosej për një vit dhe pastaj, pasi mishi ishte tretur dhe kishin mbetur vetëm kockat, ata i nxirrnin kockat dhe i vendosnin në një osuar.

Problemi i kësaj teorie është se nuk ka asnjë mbështetje, as nga burime biblike, as nga burime jashtëbiblike. Asnjë nga Ungjijtë e Dhiatës së Re nuk të lë të kuptosh se trupi i Jezusit u rivarros. Marku 16:6, ku i riu te varri thotë: “Ai nuk është këtu! Ai u ringjall së vdekuri!” e hedh poshtë plotësisht këtë pikëpamje.

Hipoteza e rivarrimit ka në fakt një problem edhe më të madh. Dr. Majkëll Likona (Michael Licona) vëren:

Më së shumti, edhe sikur hipoteza e rivarrimit të ishte e vërtetë, i vetmi shpjegim që ajo ofron është varri bosh. Por në fakt është interesante se varri bosh nuk bindi asnjë nga dishepujt- përveç Gjonit ndoshta- se Jezusi ishte ngjallur nga të vdekurit. Ajo që i bindi dishepujt ishin shfaqjet e Jezusit, dhe teoria e rivarrimit nuk mund të japë asnjë shpjegim për këto.¹⁴

Nëse trupi i Jezusit thjesht u zhvendos diku tjetër, pse nuk e zbuloi trupin ndonjë nga të afërmit e Tij kur dishepujt filluan të shpallnin ringjalljen? Pse nuk e tregoi trupin ndonjë nga autoritetet dhe ta ndalonte krishtërimin që në hapat e para të tij? Disa kanë sugjeruar se me aq kohë sa kishte kaluar trupi i Jezusit do të ishte i padallueshëm, por duke marrë parasysh klimën e Palestinës, trupi do të ishte i dallueshëm për një kohë mjaft të gjatë.¹⁵



Si mendoni?

A mund të mendoni për ndonjë lloj tjetër shpjegimi të natyrshëm që shpjegon ringjalljen e Jezusit? A ka ndonjë teori që mund të shpjegojë kaq shumë fakte rreth ngjarjes së ringjalljes sa këto që janë shpjeguar në këtë libër?

Teoria e Kopjes

“Krishtërimi nuk ka asgjë origjinale” është një nga shprehjet më të përdorura nga shumë kritikë sot. Në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë shumë studiues besonin se bindjet kryesore të krishtërimin ishin kopjuar nga fetë greko-romake të misterit. Jezusi konsiderohej si një tjetër perëndi “që vdiste e ringjallej” sipas traditës së Osirisit, Mithras, Adonisit dhe Dionisit. Ndërsa kjo teori ka përjetuar një rigjallërim të habitshëm në internet dhe në libra të pëlqyer nga shumë njerëz, ajo është hedhur poshtë nga pothuajse të gjithë studiuesit bashkëkohorë. Ja pse.

Edhe pse mund të ketë disa paralele midis Jezusit

dhe feve të misterit të cilat mund të duken të bindëse në sipërfaqe, ato bien poshtë plotësisht nëse vëzhgohen me imtësi. Osirisi, për shembull, konsiderohet prej shumë vetëve si një perëndi që vdes e ringjallet, i cili vjen nga kohët e Egjiptit të lashtë. Sipas këtij miti, Osirisi u vra nga Sethi dhe u ringjall nga Isisi. Por në vend që të kthehej në botë në një trup të ringjallur, Osirisi u bë mbret i botës së nëndheshme, gjë që e bën shumë të vështirë paralelizimin me ringjalljen historike të Jezusit. Kjo është arsyeja pse Pol Rods Edi (Paul Rhodes Eddy) dhe Greg Boid (Boyd), autorë të librit *The Jesus Legend (Legjenda e Jezusit)* dalin në përfundimin se

“ndryshimet midis krishtërit dhe feve të misterit janë shumë më të thella sesa ngjashmëritë midis tyre. Edhe pse, sigurisht, ka terma paralele të përdorura në krishtërimin e hershëm dhe në fetë e misterit, ka shumë pak prova për koncepte paralele.”¹⁶

Ndryshe nga Jezusi historik, nuk ka asnjë provë për besueshmërinë e historive të quajtura paralele në fetë e misterit. Jezusi nga Nazareti hëngri, fjeti, bëri mrekulli, vdiq dhe u kthye në jetë. Këto mbështeten nga shkrime të besueshme historike. Përkundrazi, perënditë që vdisnin dhe ringjallehin në fetë e misterit kanë qenë mite të pacaktuara në kohë dhe që përsëriteshin çdo vit me ndërrimin e stinëve.

Traktati më i fundit studimor në lidhje me perënditë që vdesin dhe ringjallen është shkruar nga T.N.D.

Metinger, profesor në Universitetin e Lundit. Në librin e tij *The Riddle of Resurrection (Enigma e Ringjalljes)*, Metinger pohon ekzistencën e miteve të perëndive që vdesin dhe ringjallen në botën antike, që, gjithsesi, janë vetëm raste të rralla. Gjithsesi, konkluzioni i tij mbërthen gozhdën e fundit në arkivolin e teorisë së kopjes:

*Me aq sa di unë, nuk ka asnjë provë të ligjshme që vdekja dhe ringjallja e Jezusit të jetë një sajim mitologjik i kopjuar nga mitet dhe ritet e perëndive që vdisnin e ringjallehin të botës përreth. Megjithëse ka vlerë ta krahasosh atë me besimin judaik për ringjalljen, besimi në vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit ruan karakterin e tij unik në historinë e feve. Enigma mbetet.*¹⁷

Prova për Ringjalljen

Profesor Tomas Arnold, autor i librit me tre vëllime *History of Rome (Historia e Romës)* dhe shefi i katedrës së historisë moderne në Oksford, e njeh mirë vlerën e provave në përcaktimin e fakteve historike. Ai thotë:

*Kam studiuar për shumë vjet historinë e kohërave të shkuara duke shqyrtuar e peshuar provat e atyre që kanë shkruar për to dhe nuk di asnjë fakt në historinë e njerëzimit që të jetë vërtetuar më mirë e më plotësisht në çdo anë, sesa shenja e madhe që Perëndia na ka dhënë se Krishti vdiq dhe u ringjall nga të vdekurit.*¹⁸

Studiuesi britanik Bruk Fos Uestkot, i cili ka qenë profesor teologjie në Universitetin e Kembrixhit, thotë:

Nëse i marrim të gjitha provat bashkë, nuk është e tepërt të themi se nuk ka incident historik të mbështetur më mirë ose me prova më të shumëllojshme sesa ringjallja e Krishtit. Asgjë, përveç një qëndrimi tashmë të vendosur për të mos e besuar si të vërtetë, nuk mund të sugjerojë idenë e pamjaftueshmërisë së provave për ringjalljen. ¹⁹

Uilliam Lejn Kreig arrin në përfundimin se “nëse... [përdor] ligjet e zakonshme të vlerësimit të historicitetit, shpjegimi më i mirë për faktet që kemi është se Perëndia e ngjalli Jezusin nga të vdekurit.” ²⁰

Sajmon Grinlif ka qenë një nga juristët më të zotë që Amerika ka nxjerrë. Ai ishte një Profesor i famshëm Rojell për Jurisprudencën në Universitetin e Harvardit dhe pasoi Gjykatësin Xhozef Stori si profesor Dejn në Jurisprudencë në të njëjtin universitet. Kur ishte ende në Harvard, Grinlif shkroi një vëllim në të cilin heton vlerën ligjore të dëshmisë së apostujve në lidhje me ringjalljen e Krishtit. Ai vëren se është e pamundur që apostujt “të kenë ngulur këmbë në shpalljen e të vërtetave që kishin treguar, nëse Jezusi nuk do të ishte ngjallur vërtet prej së vdekurish dhe nëse ata nuk do ta kishin ditur këtë fakt me siguri të plotë.” ²¹

Grinlif arrin në përfundimin se ringjallja e Krishtit është një nga ngjarjet më të vërtetuara në histori sipas

ligjeve të provave ligjore të përdorura në sallat e gjyqeve.

Sër Lajonel Lakhu konsiderohet nga shumë njerëz si avokati më i suksesshëm në botë pasi i ka provuar të pafajshëm 245 raste rradhazi të akuzuarish për vrasje . Ky avokat i shkëlqyer ka analizuar në mënyrë rigoroze faktet historike të ringjalljes së Krishtit dhe deklaroi përfundimisht se: “Unë them pa asnjë mëdyshje se provat për ringjalljen e Jezu Krishtit janë kaq të shumta sa e imponojnë pranimin e saj me anë faktesh që nuk lënë absolutisht vend për dyshim.” ²²

Është e pamundur që apostujt “të kenë ngulur këmbë në shpalljen e të vërtetave që kishin treguar, nëse Jezusi nuk do të ishte ngjallur vërtet prej së vdekurish dhe nëse ata nuk do ta kishin ditur këtë fakt me siguri të plotë.”

Frenk Morison, një tjetër avokat britanik, mori përsipër të mohonte provat për Ringjalljen. Ai mendonte se jeta e Jezusit ishte një nga jetët më të bukura të jetuara ndonjëherë, por kur vinte puna te Ringjallja, Morison thoshte se dikush kishte ardhur dhe kishte futur një mit në historinë e Tij. Ai mendoi të shkruante një shpjegim të ditëve të fundit të Jezusit, duke mos e marrë parasysh Ringjalljen. Avokati mendonte se një vështrim inteligjent dhe racional i historisë do ta përgënjeshtronte plotësisht një ngjarje të tillë. Mirëpo, kur përdori njohuritë e tij ligjore për të analizuar faktet, iu desh të ndryshonte mendim. Në vend të një libri që hidhte poshtë Ringjalljen, ai shkroi librin e tij shumë të shitur Kush e lëvizi gurin? Ai e titulloi kapitullin e parë “Libri që refuzoi të shkruhej.”

Pjesa tjetër e librit konfirmon plotësisht vlefshmërinë e provave për ringjalljen e Krishtit.²³

Xhorxh Eldon Led arrin në përfundimin:

*“I vetmi shpjegim i arsyeshëm për këto fakte historike është se Perëndia e ringjalli Jezusin në formë trupore.”*²⁴

Besimtarët në Jezus Krishtin sot mund të kenë bindje të plotë, siç kishin të krishterët e parë, se besimi i tyre nuk bazohet në mite apo legjenda, por mbi faktin historik të pakundërshtueshëm të Krishtit të ringjallur dhe të varrit bosh.

Geri Habermas, një profesor i shquar dhe shef i departamentit të filozofisë dhe teologjisë në Universitetin Liberti (Liberty University), ka debatuar me ish ateistin dhe studiuesin e famshëm Entoni Flu mbi çështjen “A u ringjall Jezusi nga të vdekurit?” Një gjyqtar profesionist debatesh të cilit iu kërkua të vlerësonte debatin, arrin në përfundimin,

*Provat historike, edhe pse kanë të meta, janë mjaft të forta për t'i drejtuar mendjet e arsyeshme në përfundimin se Krishti vërtet u ringjall nga të vdekurit...Habermas na jep në fakt “prova shumë të mundshme” për vërtetësinë historike të ringjalljes “pa asnjë provë të pranueshme natyraliste kundër saj”.*²⁵

Gjëja më e rëndësishme nga të gjitha është se të gjithë besimtarët mund të përjetojnë në jetën e tyre sot fuqinë e Krishit të ringjallur.

Së pari, ata mund të dinë se mëkatet u janë falur (shihni Luka 24:46-47; 1 Korintasve 15:3). Së dyti, ata mund të jenë të sigurt për jetën e përjetshme dhe për vetë ringjalljen e tyre prej së vdekurish (shihni 1 Korintasve 15:19-26). Së treti, ata mund të çlirohen nga një jetë boshe dhe pa kuptim dhe të shndërrohen në krijesa të reja në Jezu Krishtin (shihni Gjoni 10:10; 2 Korintasve 5:17).



Si mendoni?

A ka domethënie për ju sot fakti se Jezusi u ringjall nga të vdekurit 2000 vjet më parë? Nëse po, si dhe pse?

Cili është vlerësimi dhe vendimi juaj? Çfarë mendoni ju për varrin bosh? Pas shqyrtimit të provave nga një këndvështrim juridik, Lord Darling, ish kryegjyqtar i Anglisë, arrin në përfundimin se “ekzistojnë prova kaq të shumta, pozitive dhe negative, faktike dhe rrethanore, saqë asnjë juri inteligjente në botë nuk mund të mos dilte me verdiktin se historia e ringjalljes është e vërtetë.”²⁶

A mund të ngrihet më këmbë Mesia i vërtetë, ju lutem?

NGA TË GJITHA KREDENCIALET QË KISHTE JEZUSI për të mbështetur deklaratat se ishte Mesia dhe Biri i Perëndisë, një nga më të rëndësishmet shpesh nuk vihet re: Fakti që jeta e Tij përmbushi kaq shumë profeci të lashta. Në këtë kapitull unë do të merrem me këtë fakt mahnitës.

Jezusi iu drejtohej vazhdimisht profecive të Dhiatës së Vjetër për të mbështetur ato që thoshte për Vetën. Galatasve 4:4 thotë, “Por, kur u mbush koha, Perëndia dërgoi Birin e Tij, të lindur prej gruaje, të nënshtruar ligjit.” Këtu kemi një referencë ndaj profecive të plotësuara nga Jezu Krishti. “Dhe, duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, Ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin Atij,” (Luka 24:27). Jezusi u tha atyre, “Këto janë fjalët që Unë ju thoja kur isha ende me ju: se duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me Mua në ligjin e Moisiut, në

profetët dhe në psalmet.” (Luka 24:44). Ai tha, “Nëse do të besonit vërtetë në Moisiun, ju do të më besonit, sepse Abrahami, ati juaj, ngazëllohej në shpresën që të shihte ditën Time...” (Gjoni 8:56).

Apostujt dhe shkruarit e Dhiatës së Re gjithashtu iu referoheshin profecive të përmbushura për të vërtetuar se Jezusi ishte Biri i Perëndisë dhe Mesia. “Por kështu Perëndia i ka përmbushur ato që kishte parathënë me gojën e të gjithë profetëve të Vet, se Krishti i Tij do të vuante.” (Veprat 3:18). “Dhe Pali, sipas zakonisht të vet, hyri tek ata (në shërbesën e sinagogës) dhe tri të shtuna me radhë u paraqiti argumente nga Shkrimet, duke deklaruar dhe duke u treguar atyre se Krishti duhej të vuante dhe të ringjallej prej së vdekurish dhe duke thënë: “Ky Jezusi që unë ju shpall është Krishti.” (Veprat 17:2-3).

“...Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve,” (1 Korintasve 15:3-4).



Si mendoni?

A mendoni se ka ndonjë ndryshim midis një profecie dhe një parashikimi? A është profetizuar ndonjëherë ndonjë gjë për ju në një kohë të mëparshme dhe më pas u realizua? Nga ndryshon kjo nga profecitë që përmbushi Jezusi?

Dhiata e Vjetër përmban gjashtëdhjetë profeci madhore mesianike dhe afërsisht 270 degëzime të tyre të cilat u përmbushën në një person, Jezus Krishtin. Do të ishte mirë t'i konsideronim këto parashikime të përmbushura në Krishtin si të ishin “adresa” e Tij.

Më lejoni të shpjegohem. Ju ndoshta kurrë s'e keni kuptuar rëndësinë e emrit dhe adresës tuaj, por gjithsesi këto detaje ju diferencojnë nga më se gjashtë miliardë njerëz të tjerë të cilët banojnë në këtë planet.

Një Adresë në Histori

Me detaje edhe më të mëdha, Perëndia shkroi një “adresë” në histori për të bërë të dallueshëm Birin e Tij, Mesinë, Shpëtimtarin e njerëzimit, nga kushdo tjetër që ka jetuar ndonjëherë në histori - në të kaluarën, të tashmen apo të ardhmen. Detajet e kësaj adrese mund të gjenden në Dhiatën e Vjetër, një dokument ky i shkruar në një periudhë prej më shumë se një mijë vjetësh dhe që përmban më shumë se treqind referenca të ardhjes së Krishtit. Duke përdorur shkencën e probabilitetit, shohim se mundësitë që vetëm dyzet e tetë prej këtyre profecive të përmbushen në një person janë 1 në 10 në fuqi të 157-të.

Mundësia që adresa e Perëndisë të përputhet me një njeri komplikohet edhe më tej nga fakti se të gjitha profecitë për Mesinë janë bërë të paktën katërqind vjet para se Ai të shfaqej. Dikush mund të sugjerojë se këto profeci janë shkruar pas kohës së Krishtit dhe janë trilluar në mënyrë të tillë që të koincidojnë me jetën e Tij. Kjo mund të duket e mundur derisa të kuptoni se Septuaginta, përkthimi grek i Dhiatës së Vjetër hebreje, është përfunduar rreth 150-200 vjet para Krishtit. Kjo vendos të paktën një hapësirë prej të dyqind vitesh midis shkrimit të profecive dhe përmbushjes së tyre në Krishtin.

Sigurisht Perëndia po shkruante një adresë në histori që vetëm Mesia mund ta përmbushte. Përafërsisht dyzet njerëz kanë pretenduar të jenë Mesia hebre. Por vetëm një- Jezus Krishti- iu është referuar profecive të përmbushura për të vërtetuar pretendimet e Tij, dhe vetëm kredencialet e Tij i mbështesin këto pretendime.

Cilat janë disa nga këto kredenciale? Dhe çfarë ngjarjesh duhej të ndodhnin më parë dhe të përputheshin me shfaqjen e Birit të Perëndisë?

Për të filluar, ne duhet të kthehemi te Zanafilla 3:15, ku gjejmë profecinë e parë mesianike në Bibël: “Dhe Unë do të shtie armiqësi midis teje dhe gruas, midis farës sate dhe farës së saj; fara e saj do të shtypë kokën tënde, dhe ti do të plagosësh thembrën e farës së saj.” Kjo profeci mund t’i referohej vetëm një njeriu në të gjitha Shkrimet. Askush tjetër veç Jezusit nuk mund të quhej “fara” e një gruaje. Gjithë të tjerët që kanë lindur në histori vijnë nga fara e një burri. Versione të tjera thonë të njëjtën gjë kur e identifikojnë këtë fitues mbi Satanin si pasardhësin e një gruaje, kur në të gjithë shembujt e tjerë Bibla i numëron pasardhësit përmes linjës së burrit. Ky pasardhës ose “farë” e një gruaje do të vijë në botë dhe do të shkatërrojë veprat e Satanit (do t’i shtypë kokën).

Te Zanafilla 9 dhe 10 Perëndia e ngushton edhe më adresën. Noeu kishte tre bij: Semin, Kamin dhe Jafetin. Të gjitha kombet e botës mund ta gjejnë origjinën e tyre në njërin nga këta tre njerëz. Por Perëndia i ka eliminuar efektivisht dy të tretat e racës njerëzore nga linja e ardhjes së Mesisë duke specifikuar se Mesia do të vinte përmes linjës së Semit.

Pastaj duke vazhduar më tej deri në vitin 2000 para Krishtit, shohim se Perëndia thirri një njeri të quajtur Abraham që të dilte nga Uri i Kaldeasve. Me Abrahamin, Perëndia u bë edhe më specifik, duke deklaruar se Mesia do të ishte një nga pasardhësit e tij. Të gjitha familjet e tokës do të bekoheshin nëpërmjet Abrahamit (shihni Zanafilla 12:1-3; 17:1-8; 22:15-18). Kur ai pati dy bij, Isakun dhe Ismaelin, shumë nga pasardhësit e Abrahamit u eliminuan kur Perëndia zgjodhi birin e dytë, Isakun, që të ishte paraardhës i Mesisë (shihni Zanafilla 17:19-21; 21:12).

Isaku kishte dy bij, Jakobin dhe Esaun. Perëndia zgjodhi linjën e Jakobit (shihni Zanafilla 28:1-4; 35:10-12; Numrat 24:17). Jakobi kishte dymbëdhjetë bij, prej pasardhësve të të cilëve dolën dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Pastaj Perëndia veçoi fisin e Judës për linjën e ardhjes së Mesisë dhe eliminoi njëmbëdhjetë të dymbëdhjetat e fiseve hebreje. Dhe nga të gjitha linjat familjare brenda fisit të Judës, Ai zgjodhi linjën e Jeseut (shihni Isaia 11:1-5). Mund të shohim se si adresa po ngushtohet ende. Jeseu kishte tetë bij, dhe te 2 Samuelit 7:12-16 dhe te Jeremia 23:5 Perëndia eliminoi shtatë të tetat e linjës familjare të Jeseut duke zgjedhur birin e Jeseut që quhej David. Kështu, në terma gjenealogjie, Mesia duhej të lindë nga fara e një gruaje, linja e Semit, raca e hebrenjve, linja e Isakut, linja e Jakobit, fisi i Judës, familja e Jeseut, dhe shtëpia e Davidit.

Te Mikea 5:2, Perëndia eliminoi të gjitha qytetet e botës dhe zgjodhi Betlehem, me një popullsi prej më



Si mendoni?

A e keni eksploruar ndonjëherë gjenealogjinë tuaj? A keni zbuluar ndonjë informacion interesant rreth familjes suaj? A dini ndonjë gjë për gjenealogjinë e Jezusit? Çfarë ju duket më interesante në gjenealogjinë e Tij?

pak se një mijë vetash, si vendlindje të Mesisë.

Pastaj përmes një serie profecish, Ai përcaktoi madje edhe periudhën kohore që do ta veçonte këtë njeri. Për shembull, te Malakia 3:1 dhe në katër vargje të tjera të Dhiatës së Vjetër thuhet se Mesia duhej të vinte ndërkohë që tempulli i Jerusalemit

ishte ende më këmbë (shihni Psalmi 118:26; Danieli 9:26; Zakaria 11:13; Hagai 2:7-9).¹ Kjo ka domethënie të madhe kur marrim parasysh se tempulli u shkatërrua në vitin 70 pas Krishtit dhe që prej asaj kohe nuk është rindërtuar më.

Isaia 7:14 shton se Krishti do të lindë nga një e virgjër. Një lindje natyrore prej një ngjizjeje mbinatyrore ishte një kriter që shkonte përtej planifikimit dhe kontrollit njerëzor. Profeci të ndryshme tek Isaia dhe te Psalmet përshkruajnë klimën sociale dhe përgjigjen që njeriu i Perëndisë do të marrë: vetë populli i Tij, hebrenjtë, do ta mohojnë, dhe johebrejtë do të besojnë në Të (shihni Psalmet 22:7-8; 118:22; Isaia 8:14, 49:6; 50:6; 52:13-15). Dikush do të vinte para Tij si lajmërues, një zë në shkretëtirë, një që të përgatiste udhën para Zotit, një Gjon Pagëzor (shihni Isaia 40:3-5; Malakia 3:1).

Vini re se si një pasazh në Dhiatën e Re (Mateu 27:3-

10) u referohet disa profecive të Dhiatës së Vjetër të cilat e ngushtojnë edhe më adresën e Krishtit. Mateu përshkruan ngjarjet që ndodhën si pasojë e veprimeve të Judës pasi ky tradhtoi Krishtin. Mateu sqaron se këto ngjarje ishin të parashikuara në pasazhe të Dhiatës së Vjetër (shihni Psalmi 41:9; Zakaria 11:12-13)². Në këto pasazhe Perëndia tregon se Mesia 1) do të tradhtohet, 2) nga një mik, 3) për tridhjetë monedha argjendi, dhe se paratë 4) do të hidheshin në dyshtemenë e tempullit. Kështu adresa bëhet edhe më specifike.

Linja e saktë, vendi, koha dhe mënyra e lindjes, reagimet e njerëzve, tradhtia, mënyra e vdekjes – këtë janë vetëm një pjesë e vogël e qindra detajeve që përbëjnë “adresën” për të identifikuar Birin e Perëndisë, Shpëtimtarin e botës.

Një profeci që daton që nga viti 1012 para Krishtit parashikon gjithashtu se duart dhe këmbët e këtij njeriu do të shpoheshin dhe ai do të kryqëzohej (shihni Psalmi 22:6-18; Zakaria 12:10; Galatasve 3:13). Ky përshkrim i mënyrës se si do të vdiste u shkrua tetëqind vjet para se romakët ta përdornin kryqëzimin si një metodë ekzekutimi. Linja e saktë, vendi, koha dhe mënyra e lindjes, reagimet e njerëzve, tradhtia, mënyra e vdekjes – këtë janë vetëm një pjesë e vogël e qindra detajeve që përbëjnë “adresën” për të identifikuar Birin e Perëndisë, Shpëtimtarin e botës.

A ishin të rastësishme këto profeci të përmbushura?

Një kritik mund të thotë, “Disa nga këto profeci mund të jenë përmbushur në njerëz të tjerë.”

Po, ma merr mendja se mund të gjenden një ose dy profeci që përputhen me njerëz të tjerë, por jo të gjashtëdhjetë profecitë kryesore dhe 270 degëzime të tyre. Në fakt, për vite me radhë, shoqëria botuese Krisçën Viktëri (Christian Victory) në Denver ka ofruar një çmim prej një mijë dollarësh për këdo që do të mund të gjente një person tjetër përveç Jezusit, qoftë i gjallë apo i vdekur, që të mund të përmbushte vetëm gjysmën e profecive mesianike të shënuara në librin *Messiah in Both Testaments (Mesia në të dy Dhiatat)* të Fred Xhon (John) Meldau. Nuk patën asnjë fitues.



Si mendoni?

Sa e mundur mendoni se është që një person të përmbushë kaq shumë parashikime të lashta që ishin thënë qindra vite para se personi të kishte lindur? Si ka mundësi që Jezusi e bëri këtë?

A mundej që një person të përmbushte të gjitha profecitë e Dhiatës së Vjetër? Në librin e tyre *Shkenca flet (Science Speaks)*, Pitër Stonër dhe Robert Njuman kanë bërë llogaritje për të analizuar këtë probabilitet. Në parathënien e këtij libri,

H. Harold Hartzler nga American Scientific Affiliation (Shoqata e Shkencëtarëve Amerikanë) thotë:

Dorëshkrimi i “Shkenca flet” është shqyrtuar

*me kujdes nga një komitet me anëtarë të Shoqatës së Shkencëtarëve Amerikanë dhe nga Këshilli Ekzekutiv i të njëjtit grup dhe është arritur në përfundimin se, në përgjithësi, ky libër është i besueshëm dhe i saktë për sa i përket materialit shkencor të paraqitur në të. Analiza matematike e përfshirë në të bazohet në parimet e probabilitetit të cilat janë tërësisht të qëndrueshme, dhe profesor Stoneri i ka zbatuar këto parime në një mënyrë të përshtatshme dhe bindëse.*³

Probabilitetet që vijnë tregojnë se rastësia hiqet si mundësi. Stoneri thotë se duke zbatuar shkencën e probabilitetit ndaj tetë prej profecive, “zbulojmë se shanset që ndonjë njeri të ketë jetuar deri më tani e të ketë përmbushur që të teta këto profeci janë 1 në 10 në fuqi të 17-të.”⁴ Kjo do të thotë 100,000,000,000,000,000. Për të na ndihmuar ta kuptojmë këtë probabilitet të habitshëm, Stoneri e ilustron atë duke supozuar sikur

Të marrim 10 në fuqi të 17-të dollarë argjendi dhe t'i shtrijmë ata në të gjithë sipërfaqen e Teksasit. Ata do ta mbulojnë gjithë këtë shtet me një trashësi prej rreth 60 cm. Tani vërimi një shenjë njëres prej këtyre monedhave të argjendta dhe përziejeni mirë gjithë masën e tyre, përgjatë gjithë sipërfaqes së shtetit. Lidhini sytë një njeriu dhe i thoni se mund të udhëtojë sa të dojë nëpër shtet, por se duhet

të kapë një monedhë argjendi dhe të thotë se është e duhura, pra monedha e shënuar. Sa mundësi do të kishte ai për të kapur monedhën e duhur? Po aq mundësi sa kishin profetët për të shkruar këto tetë profeci dhe këto të përmbusheshin në një njeri, që nga koha e tyre e deri më sot, po qe se do t'i kishin shkruar ato nga mendja e tyre. Tani këto profeci ose janë frymëzuar nga Perëndia, ose profetët i shkruan siç i menduan. Në rastin e dytë, profetët kishin vetëm një mundësi në 10 në fuqi të 17-të që ato të përmbusheshin në një njeri, por ato u vërtetuan në Jezu Krishtin.

Kjo do të thotë se vetëm përmbushja e këtyre tetë profecive vërteton se Perëndia i frymëzoi ato me një saktësi të cilës i mungon vetëm një mundësi në 10 në fuqi të 17-të për të qenë absolute.⁵

Një kundërshtim tjetër

Disa njerëz thonë se Jezusi u përpoq me dashje që të përmbushte profecitë hebreje. Ky kundërshtim ndaj Tij duket i pranueshëm derisa të kuptojmë se shumë nga detajet e ardhjes së Mesisë ishin plotësisht përtej kontrollit njerëzor. Një shembull është vendi i lindjes. Kur Herodi i pyeti kryepriiftërinjtë dhe skribët se ku duhej të lindte Krishti, ata iu përgjigjën, “Në Betlehem...sepse kështu është shkruar nëpërmjet profetit”(Mateu 2:5). Do të ishte marrëzi të mendonim se ndërkohë që Maria

dhe Jozefi shkonin për në qytetin e parashikuar, Jezusi, nga barku i nënës së Tij, thoshte, “Nënë, nxito se nuk do arrijmë dot në kohë.”

Gjysma e profecive ishin të tilla që Krishti nuk mund të kishte asnjë kontroll mbi përmbushjen e tyre: mënyra e lindjes, tradhtia e Judës dhe çmimi i tradhtisë, mënyra e vdekjes, reagimi i njerëzve, talljet dhe pështyrjet, shikimet dashakeqe, hedhja short për rrobat e Tij dhe hezitimi i ushtarit për t’ia grisur rrobën. Për më tepër, Krishti nuk mund të shkaktonte lindjen e Tij nga fara e një gruaje, sipas linjës së Semit, nga pasardhja e Abrahamit dhe të gjitha ngjarjet e tjera që çuan në lindjen e Tij. Nuk është për t’u habitur që Jezusi dhe apostujt iu referoheshin profecive të përmbushura për të mbështetur fjalët e Tij se Ai ishte Biri i Perëndisë.

Pse i hyri Perëndia gjithë kësaj pune? Besoj se Ai donte që Jezu Krishti të kishte të gjitha kredencialet e nevojshme kur të vinte në botë. Por prapë se prapë, një nga gjërat më ngazëllyese në lidhje me Jezusin është se Ai erdhi për të ndryshuar jetët e njerëzve. Vetëm Ai i vërtetoi si të sakta ato qindra profeci të Dhiatës së Vjetër që përshkruanin ardhjen e Tij. Dhe vetëm Ai mund të përmbushë profecinë më të madhe nga të gjitha për ata

**Pse i hyri
Perëndia
gjithë kësaj
pune? Besoj
se Ai donte që
Jezu Krishti të
kishte të gjitha
kredencialet
e nevojshme
kur të vinte në
botë. Por prapë
se prapë, një
nga gjërat më
ngazëllyese
në lidhje me
Jezusin është
se Ai erdhi për
të ndryshuar
jetët e
njerëzve.**



Si mendoni?

Nga tri provat kyçe të paraqitura në këtë libër-besueshmëria e Biblës, provat historike për ringjalljen dhe profecitë e përmbushura- cila ju duket më bindëse? Pse?

që e pranojnë - premtimin e jetës së re: “Do t’ju jap një zemër të re dhe do të shtie brenda jush një shpirt të ri” (Ezekieli 36:26). “Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja” (2 Korintasve 5:17).

A nuk ka ndonjë rrugë tjetër?

GJATË NJË SERIE LEKSIONESH NË UNIVERSITETIN E TEKSASIT, një student i vitit të fundit m'u afrua dhe më pyeti,: “Pse është Jezusi e vetmja rrugë për të pasur një marrëdhënie me Perëndinë?” Unë u kisha thënë se Jezusi shpalli se ishte e vetmja rrugë për te Perëndia, se dëshmia e Shkrimeve dhe e apostujve ishte e besueshme dhe se kishte mjaft prova për të garantuar besimin në Jezusin si Shpëtimtar e si Zot. Gjithsesi ky student kishte ende pyetje: “Pse Jezusi dhe vetëm Jezusi? A nuk ka ndonjë rrugë tjetër për te Perëndia?” Çuditërisht, njerëzit, ashtu si dhe ky djalë i ri, kërkojnë vazhdimisht për alternativa. “Po Buda? Muhamedi? A s’është e mundur që njeriu thjesht të jetojë një jetë të mirë? Nëse Perëndia është kaq i dashur, atëherë a nuk duhet t’i pranojë të gjithë njerëzit ashtu siç janë?”

Pyetje të tilla i dëgjoj shpesh. Në shoqërinë e hapur që kemi sot, njerëzit duket se irritohen nga deklaratat

ekskluzive se Jezusi është e vetmja rrugë për te Perëndia dhe i vetmi burim i faljes së mëkateve dhe i shpëtimit. Ky qëndrim tregon se shumë njerëz thjesht nuk e kuptojnë natyrën e Perëndisë.



Si mendoni?

Si do ta përshkruanit Perëndinë? Nga e kanë origjinën idetë tuaja për Perëndinë? A ka në Jezusin ndonjë gjë që ju habit e që nuk përputhet me përshkrimin për Perëndinë?

Ne mund ta gjejmë thelbin e keqkuptimit të tyre në pyetjen që ata bëjnë zakonisht: “Si mundet që një Perëndi i dashur të lejojë që dikush të shkojë në ferr?” Unë shpesh e kthej pyetjen dhe i pyes njerëzit, “Si mundet një Perëndi i shenjtë dhe i drejtë të

lejojë një person mëkatar në praninë e Tij?” Shumë njerëz e kuptojnë Perëndinë si një Perëndi të dashur, por nuk shkojnë më tej. Ai nuk është vetëm një Perëndi i dashurisë, por edhe një Perëndi që është i drejtë dhe i shenjtë.

Ai nuk mund ta tolerojë mëkatin në parajsën e Tij më shumë sesa do ta toleronim ne në shtëpinë tonë një qen të qelbur e të sëmurë. Ky keqkuptim rreth natyrës themelore dhe karakterit të Perëndisë është shkaku i shumë problemeve teologjike dhe etike.

Kryesisht, ne e njohim Perëndinë përmes attributeve të Tij: shenjtëria, dashuria dhe drejtësia. Megjithatë, atributet e Tij nuk janë pjesë e Tij në të njëjtën mënyrë siç janë pjesë tonat atributet që kemi zhvilluar. Ne mund ta kuptojmë se është mirë të jesh i sjellshëm dhe

ta zhvillojmë këtë atribut si pjesë tonën. Me Perëndinë është ndryshe. Atributet e Perëndisë, vetë qenia e Tij, përfshijnë cilësi të tilla si shenjtëria, dashuria dhe drejtësia. Për shembull, mirësia nuk është një pjesë e Perëndisë, por diçka që është e vërtetë për vetë natyrën e Tij. Atributet e Perëndisë e kanë burimin e tyre në atë që është Perëndia. Ai

Ne e njohim Perëndinë përmes attributeve të Tij. (– shenjtëria, dashuria dhe drejtësia. Ai nuk i përvetësoi këto cilësi; ato rrjedhin nga natyra e Tij)

nuk i ka zhvilluar ato për të ndërtuar natyrën e Tij; ato rrjedhin nga ajo. Kështu që kur themi se Perëndia është dashuri, ne nuk nënkuptojmë se një pjesë e Perëndisë është dashuri, por se dashuria është një atribut që është pjesë e qenësishme e Perëndisë. Kur Perëndia do, Ai nuk po merr një vendim për këtë; Ai thjesht është Vetvetja.

Ja problemi që na intereson neve: Nëse natyra e Perëndisë është dashuri, si ka mundësi që Ai të dërgojë dikë në ferr? Përgjigjja me pak fjalë është se njerëzit nuk i dërgon Perëndia në ferr. Ata shkojnë atje për shkak të zgjedhjeve të tyre. Për ta shpjeguar këtë, duhet të kthehemi pas deri te Krijimi. Bibla sqaron se Perëndia i krijoi burrin dhe gruan që të ndante me ta dashurinë dhe lavdinë e Tij. Por Adami dhe Eva zgjodhën të rebeloheshin kundër Perëndisë dhe të shkonin në rrugën e tyre.

Ata e lanë dashurinë dhe mbrojtjen e Perëndisë, duke e ndotur veten me atë natyrë kokëfortë, lakmitare dhe krenare që quhet mëkat. Perëndia i deshi burrin dhe gruan, edhe kur ata e refuzuan, prandaj donte t'i

shpëtonte nga rruga vdekjeprurëse që kishin zgjedhur. Por Perëndia hasi me një dilemë.

Perëndia nuk është vetëm i dashur, por edhe i shenjtë e i drejtë, prandaj mëkati nuk mund të mbijetojë në praninë e Tij. Vetë natyra e Tij e shenjtë dhe e drejtë do ta shkatërronte njeriun mëkatar. Kjo është arsyeja pse Bibla thotë se “Paga e mëkatit është vdekja” (Romakëve 6:23). Kështu pra, si mund ta zgjidhte Perëndia këtë dilemë dhe t’i shpëtonte burrin dhe gruan?

Trinia e Shenjtë, Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë, mori një vendim të mahnitshëm. Jezusi, Perëndia Bir, do të merrte trajtë njerëzore. Ai do të bëhej Perëndia-njeri. Për këtë lexojmë në kapitullin e parë të Ungjillit të Gjoni, ku thuhet, “Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne” (Gjoni 1:14). Edhe Filipianëve 2 na tregon se Krishti Jezus e zhveshi Veten nga të drejtat e Tij prej Perëndie dhe mori formë njerëzore (shihni Filipianëve 2:6-7).



Si mendoni?

A ka marrë ndonjëherë ndonjeri një dënim në vendin tuaj? A ndryshoi marrëdhënia juaj me këtë person pas kësaj? A do të ishit të gatshëm të bënit të njëtën gjë për atë person, edhe sikur ta meritonte dënimin?

Jezusi ishte njeriu Perëndi. Ai ishte plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi.

Ana e tij njerëzore nuk e mpaku anën e Tij hyjnore, dhe ana e Tij hyjnore nuk e mbizotëroi anën e Tij njerëzore. Ai zgjodhi të jetonte një jetë pa mëkat, në bindje të plotë ndaj Atit. Deklarata biblike: “paga e

mëkatit është vdekja” nuk e akuzonte Atë. Ai nuk ishte vetëm njeri i kufizuar, por edhe Perëndi i pakufizuar, prandaj kishte kapacitetin e pafundëm për të marrë mbi Vete mëkatet e botës.

Kur Jezusi u ekzekutua në kryq, rreth dy mijë vjet më parë, Perëndia e pranoi vdekjen e Tij si zëvendësuese për tonën. Natyra e drejtë e Perëndisë u kënaq. Drejtësia u krye; një dënim u pagua. Kështu në atë moment, natyra e dashur e Perëndisë ishte e lirë nga detyrimet e drejtësisë dhe Ai mund të na pranonte sërish e të na ofronte atë që kishim humbur në Eden, atë marrëdhënie origjinale në të cilën ne mund të përjetonim dashurinë dhe lavdinë e Tij.

Shpesh i pyes njerëzit, “Për kë vdiq Jezusi?” Zakonisht ata përgjigjen, “Për mua” ose “Për botën.” Dhe unë u them, “Po, është e vërtetë, por për kë tjetër vdiq Jezusi?” Ata përgjithësisht e pranojnë se nuk e dinë. Unë u përgjigjem, “Për Perëndinë Atë.” Krishti nuk vdiq vetëm për ne, por edhe për Atin.

Ai ishte po aq njeri sikur të mos kishte qenë kurrë Perëndi dhe po aq Perëndi sikur të mos kishte qenë kurrë njeri.

Kjo tregohet edhe në pjesën e fundit të Romakëve 3, në të cilën disa versione të Biblës e quajnë vdekjen e Jezusit si një “plotësim” (shihni Romakëve 3:25).

Fjala *plotësim* do të thotë përmbushja e një kërkesë apo kriteri. Kur Jezusi vdiq në kryq, Ai nuk vdiq vetëm për ne, por edhe për të plotësuar kërkesat apo kriteret e drejta e të shenjta që janë pjesë e pandashme e natyrës së

Perëndisë. Ai na pastroi që ne të mund të qëndronim të pastër në praninë e Tij.

Disa vjet më parë unë kam dëgjuar një histori të vërtetë që ilustron qartë se çfarë bëri Jezusi në kryq për të zgjidhur problemin që kishte Perëndia në lidhje me mëkatin tonë. Një vajzë të re e ndaloi policia sepse po ngiste makinën me shpejtësi mbi normën. Polici i preu gjobën dhe e çoi para gjykatësit. Gjykatësi lexoi akuzën dhe e pyeti, “Fajtores apo e pafajshme?” Vajza u përgjigj, “Fajtores.” Gjykatësi përplasi çekiçin dhe i vuri asaj si dënim një gjobë prej njëqind dollarësh ose dhjetë ditë burg. Pastaj ai bëri diçka të habitshme. U ngrit, hoqi rrobën e gjykatësit, zbriti nga podiumi, nxori kuletën dhe pagoi gjobën e vajzës së re. Pse? Gjykatësi ishte babai i saj. Ai e donte të bijën, por prapë ishte gjykatës. Ajo kishte shkelur ligjin dhe ai nuk mund t’i thoshte ashtu si pa të keq, “Meqë të dua shumë, të fal.”



Si mendoni?

A ju duket e vështirë ta falni dikë që ju ka bërë keq? Çfarë çmimi paguajnë shumica e njerëzve kur i falin të tjerët?

Po ta bënte këtë, nuk do të ishte gjykatës i drejtë. Nuk do ta mbronte ligjin. Por për shkak të dashurisë për bijën e tij, ai ishte i gatshëm të hiqte rrobën e tij prej gjykatësi, të zbriste

në pozicionin e saj, të pranonte marrëdhënien e tij si babai saj dhe t’ia paguante gjobën.

Kjo histori ilustron pak atë që bëri Perëndia për ne nëpërmjet Jezu Krishtit. Ne mëkatuam dhe Bibla thotë: “Paga e mëkatit është vdekja.” Kur Perëndia na shikon,

pavarësisht se na do shumë, Ai duhet të përplasë çekiçin e gjykatësit dhe të thotë vdekje, sepse Ai është një Perëndi i drejtë. Por, për shkak se është edhe një Perëndi i dashur, Ai u tregua i gatshëm të zbriste nga froni i Tij në formën e njeriut Jezus Krisht dhe të paguante çmimin për ne, që ishte vdekja e Tij në kryq.

Në këtë pikë, shumë njerëz bëjnë një pyetje të natyrshme: “Pse nuk mundet Perëndia thjesht të falë pa kërkuar asnjë pagesë?” Një drejtues në një kompani të madhe më tha një herë: “Punëtorët e mi i dëmtojnë shpesh pajisjet, shpërdorojnë materialet dhe prishin mjetet e dhe unë thjesht i fal. Po më thua se unë mund të bëj diçka që Perëndia nuk mund të bëjë?” Ky drejtues nuk arrinte të kuptonte se falja atij i kushtonte diçka. Kompania

e tij paguante për prishjet që bënin punëtorët duke i rregulluar e duke i zëvendësuar artikujt. Kudo që ka falje, ka edhe zëvendësim. Për shembull, le të supozojmë se bija ime thyen një llampë në shtëpi. Unë jam një baba i dashur dhe e fal. E përqafoj bijën time dhe i them: “Mos qaj, zemër. Babi të do shumë dhe të fal.” Zakonisht ata që e dëgjojnë këtë histori thonë, “Ja kështu duhet të bëjë edhe Perëndia.” Pastaj vjen pyetja: “Po për llampën kush do të paguajë?” Fakti është se unë do të paguaj. Falja ka gjithmonë një çmim. Supozojmë se dikush ju fyen në

Falja ka gjithmonë një çmim. Perëndia pagoi çmimin për faljen tonë nëpërmjet kryqëzimit – një pagesë që as Buda, as Muhamedi, Konfuci ose ndonjë udhëheqës tjetër fetar nuk mund ta ofrojë.

sy të të tjerëve dhe më vonë ju i thoni me plot hir: “Unë të fal.” Kush e mban çmimin e asaj fyerje? E mbani ju. Ju do të mbani dhembjen e gënjeshtërs dhe humbjes së reputacionit në sy të atyre që ishin dëshmitarë të fyerjes.

Kjo është ajo që Perëndia ka bërë për ne: Ai ka thënë: “Unë të fal.” Por Ai e pagoi Vetë në kryq çmimin për faljen. Kjo është një pagesë që as Buda, as Muhamedi, as Konfuci dhe as ndonjë tjetër udhëheqës fetar ose etik nuk mund të ofrojë. Askush nuk mund ta paguajë çmimin thjesht “duke jetuar një jetë të mirë.” E di që tingëllon përjashtuese, por duhet ta themi sepse është e vërtetë: Nuk ka rrugë tjetër përveç Jezusit.

Ai ndryshoi jetën time

ATO QË JU KAM TREGUAR NË KËTË LIBËR janë gjëra që kam mësuar duke shqyrtuar provat për krishtërimin, pasi miqtë e mi në universitet më sfiduan ta vija në provë të vërtetën e besimit të tyre. Mund të mendoni se pasi shqyrtova provat u bëra menjëherë i krishterë. Por, pavarësisht provave të bollshme, unë ndjeja një hezitim të fuqishëm për ta bërë këtë hap. Mendja ime ishte e bindur për të vërtetën. Nuk kisha si të mos e pranoja se Jezus Krishti duhet të ishte tamam Ai që tha se ishte. Mund ta shihja qartë se krishtërimi nuk ishte mit, as fantazi ëndërrimtarësh, nuk ishte as rreng punuar të paditurve, por ishte në fakt një e vërtetë me themele të forta. Unë e dija të vërtetën, por prapë vullneti më tërhiqte në drejtim tjetër.

Ngurroja për dy arsye: kënaqësia dhe krenaria. Unë mendoja se po të bëhesha i krishterë do të hiqja dorë nga argëtimi dhe nga kontrolli. Unë e ndieja Jezu

**Mendja më
thoshte se
krishtërimi
ishte i vërtetë,
por vullneti im
po rezistonte
me sa fuqi
kishte.**

Krishtin në derën e zemrës sime, duke më folur, “Shiko, Unë kam qëndruar vazhdimisht te dera jote duke trokitur. Nëse më dëgjon që të thërras dhe ma hap derën, Unë do të hyj brenda.” (perifrazuar nga Zbulesa 3:20). Unë e mbaja të mbyllur fort atë

derë. Nuk doja t’ia dija nëse Ai kishte ecur mbi ujë apo se kishte kthyer ujin në verë. Nuk doja asnjë që të më prishte punë. Nuk dija mënyrë më efikase për të prishur kohët e mira që po kaloja. Unë i quajta kohë të mira, por në fakt isha i mjerë. Isha një fushë beteje e gjallë. Mendja më thoshte se krishtërimi ishte i vërtetë, por vullneti im po rezistonte me sa fuqi kishte.

Pastaj ishte dhe problemi i krenarisë. Asokohe mendimi se mund të bëhesha i krishterë më shkatërronte egon. Unë sapo kisha vërtetuar se të gjitha mendimet e mia të mëparshme kishin qenë të gabuara dhe se miqtë e mi kishin pasur të drejtë. Sa herë që hasja me ata të krishterë entuziastë, konflikti i brendshëm merrte flakë. Nëse keni qenë ndonjëherë në shoqëri njerëzish të lumtur kur vetë ndiheshit i mjerë, e dini se sa të acaron gëzimi i tyre. Ndonjëherë unë ngrihesha, ikja nga grupi dhe dilja me vrap nga unioni studentor. Gjërat arritën deri aty sa shkoja në shtrat në orën dhjetë të darkës por nuk më zinte gjumi deri në katër të mëngjesit. Nuk mund ta hiqja nga mendja problemin. Duhej të bëja diçka para se ky problem të më luante mendsh.

Isha përpjekur gjithmonë të isha njeri me mendje të

hapur, por jo aq të hapur sa të më dilnin trutë jashtë. Siç thotë edhe Xh.K. Çesterton (G. K. Chesterton), “Qëllimi i hapjes së mendjes, ashtu si hapja e gojës, është që pastaj ta mbyllësh prapë mbi diçka të fortë.” Unë e hapa mendjen time dhe më në fund e mbylla duke futur brenda realitetin më të fortë që kisha përjetuar ndonjëherë. Në 19 dhjetor 1959, në orën 8:30 të darkës, gjatë vitit të dytë të universitetit, unë u bëra i krishterë.

Dikush më pyeti, “Nga e di që u bëra i krishterë?”

Një nga përgjigjet ishte e thjeshtë: “Kjo gjë ma ndryshoi jetën.” Është pikërisht ky transformim që më siguron se vërtet u bëra i krishterë. Atë natë unë u luta për katër gjëra për të vendosur një marrëdhënie

me Krishtin e ringjallur e të gjallë dhe jam mirënjohës që kjo lutje ka pasur përgjigje.

Në fillim thashë, “Zot Jezus, të falenderoj që vdiqe në kryq për mua.” Gjëja e dytë që thashë ishte, “I pranoj ato gjëra në jetën time që nuk të kënaqin Ty dhe të kërkoj të më falësh e të më pastrosh.” Perëndia na thotë, “Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhën si bora.” (Isaia 1:18). E treta gjë që thashë ishte, “Tani të hap derën e zemrës e të jetës dhe të besoj Ty si Shpëtimtarin dhe Zotin tim. Merre Ti kontrollin e jetës time. Më bëj ashtu si më ke krijuar të jem.” Gjëja e fundit që u luta

Si mendoni?

Tani që jeni në fund të librit, a ka ndryshuar ndonjë nga mendimet tuaja për Jezusin? A jeni nxitur për të lexuar më shumë për Të? Për të folur me të tjerë që ia kanë dorëzuar jetën Atij?

Nga e di që u bëra i krishterë? Më ka ndryshuar jetën. Besimi im nuk është mbështetur në padituri por në prova, faktet historike, dhe Fjalën e Perëndisë.

ishte, “Të falenderoj që erdhe në jetën time përmes besimit.” Ishte një besim i bazuar jo në padije, por në prova, në fakte të historisë dhe në Fjalën e Perëndisë.

Jam i sigurt se keni dëgjuar njerëz të flasin për “rrufenë” që i goditi kur patën përvojën tyre të parë fetare. Për mua nuk ishte diçka kaq dramatike.

Pasi u luta nuk ndjeva asgjë. Vërtet asgjë. Dhe ende nuk më kanë dalë as krahë ëngjëllorë, as aureolë mbi kokë. Në fakt, pasi mora atë vendim unë u ndjeva më keq. “Oh, mos! Në ç’valle kam hyrë?” thosha me vete. Ndihesha vërtet sikur bërë një marrëzi (dhe jam i sigurt se disa njerëz mendojnë se vërtet kisha bërë!).

Ndryshimi nuk ishte i menjëhershëm, por ishte real. Brenda gjashtë deri tetëmbëdhjetë muajve, e kuptova se nuk kisha bërë marrëzi. Jeta ime kishte ndryshuar vërtet. Në atë kohë unë bëra një debat me drejtorin e departamentit të historisë së një universiteti në njërin nga shtetet qendrore të Sh.B.A.-së. Po i tregoja për jetën time të re dhe ai më ndërpreu duke më thënë, “MekDauell, mos do të më thuash se Perëndia ta ka ndryshuar jetën vërtet? Më trego si.” Pasi më dëgjoi për dyzet e pesë minuta, më në fund më tha, “Dakord, dakord, mjafton!”

Një ndryshim për të cilin i tregova atij ishte se isha çliruar nga mungesa e qetësisë. Para se të pranoja Krishtin, unë kisha nevojë të isha gjithnjë i zënë me diçka. Kisha nevojë të shkoja nga shtëpia e të dashurës,

në ndonjë festë, në unionin studentor, ose të vija vërdallë me shokët. Ecja në qendrën studentore me mendjen të pushtuar nga një vorbull konfliktesh. Ulesha dhe përpiquesha të studioja ose të mendoja thellë, por nuk mundesha. Por pasi mora atë vendim për Krishtin, më pushtoi një lloj paqeje mendore. Mos më keqkuptoni; nuk dua të them se pushuan të gjitha konfliktet. Ajo që gjeta në këtë marrëdhënie me Jezusin nuk ishte aq shumë mungesa e konfliktit, sesa aftësia për ta zgjidhur atë. Këtë nuk e këmbeja me asgjë në botë.

Një fushë tjetër që filloi të ndryshonte ishte inati im i keq. Unë merrja zjarr menjëherë nëse dikush më shihte shtrembër. Kam ende shenja nga një zënkë



Si mendoni?

A ka ndonjë fushë të caktuar të jetës suaj që do të donit që Perëndia ta ndryshonte?

në të cilën për pak sa nuk e vrava një person kur isha në vitin e parë të universitetit. Inati kishte qenë aq shumë pjesë e imja, sa që nuk isha përpjekur kurrë ta ndryshoja. Një ditë ndesha një krizë që normalisht duhej të më bënte të shpërtheja, por në fakt unë ndenja i qetë dhe i përmbajtur. Inati më kishte ikur! Kjo nuk ishte vepra ime; Jezusi më ndryshoi. Kjo nuk do të thotë se u bëra i përsosur. Katërmbëdhjetë vjet me rradhë vetëm një herë e humba gjakftohtësinë. Por kur e humba, e prisha punën.

Jezusi më ndryshoi edhe në diçka tjetër. Nuk jam krenar për këtë që do të them, por e përmend sepse ka shumë njerëz të tjerë që kanë nevojë për të njëjtin

ndryshim, dhe unë dua t'u tregoj atyre burimin e atij ndryshimi: marrëdhënia me Krishtin e ringjallur e të gjallë. Problemi që kisha ishte urrejtja. Unë kisha një barrë të rëndë urrejtjeje që më shtypte. Nga jashtë nuk dukej, por nga përbrenda më gërryente vazhdimisht. Isha i inatosur me njerëz, me gjëra, me çështje. Isha i pasigurt. Sa herë që takoja dikë që ishte ndryshe nga unë, ai person shndërrohej në një kërcënim për mua dhe unë reagoja me nivele të ndryshme urrejtjeje.

**Ajo që gjeta
në këtë
marrëdhënie
me Jezusin nuk
ishte aq shumë
mungesa e
konfliktit, sesa
aftësia për ta
zgjidhur atë**

Një person e urreja më shumë se këdo tjetër në botë, babain tim. E urreja me gjithë shpirt. Më vinte turp që ai ishte pijaneci i qytetit. Nëse jeni nga një qytet i vogël dhe babai yt është pijanec, atëherë e kuptoni ç'dua të them. Bëhet një fakt që e dinë të gjithë. Shokët e mi të gjimnazit

talleshin e bënin shakara për të pirët që bënte babai im. Ata nuk mendonin se kjo gjë më mërziste, sepse unë u bashkohesha shakave dhe qeshja bashkë me ta. Unë qeshja nga jashtë, por nga brenda qaja. Shkoja në haur dhe e gjeja nënën të rrahur aq keq sa nuk mund të ngrihej, shtrirë në plehun e lopëve. Kur kishim miq për vizitë, unë e nxirrja babain dhe e çoja te hauri, e lidhja dhe e parkoja makinën e tij në oborrin e pasmë të shtëpisë. Miqve u thoshim se kishte shkuar diku. Nuk mendoj se ka njeri që të urrejë dikë më shumë sesa e urreja unë tim atë.

Rreth pesë muaj pasi mora atë vendim për Krishtin, në jetën time hyri një dashuri aq e fuqishme nga Perëndia

saqë e mori atë urrejtje, e ktheu përmbys dhe e zbrazti. Unë isha në gjendje ta shikoja tim atë drejt e në sy dhe t'i thosha, “Babi, unë të dua.” Dhe e kisha me të vërtetë. Duke marrë parasysh disa gjëra që i kisha bërë atij, kjo gjë e tronditi me të vërtetë.

Pasi u transferova në një universitet privat, përfundova në spital për shkak të një aksidenti të rëndë me makinë. Kur më çuan në shtëpi për ta marrë veten, babai erdhi të më takonte. Çuditërisht, atë ditë ishte esëll. Por dukej i nervozuar dhe ecte lart e poshtë nëpër dhomë. Pastaj shpërtheu e tha: “Bir, si mund të duash një baba si unë?” Unë iu përgjigja, “Babi, para gjashtë muajsh unë të përbuzja.” Pastaj i tregova historinë e kërkimeve dhe përfundimeve të mia në lidhje me

**Një person
e urreja më
shumë se këdo
tjetër në botë,
babain tim.
Rreth pesë
muaj pasi mora
atë vendim
për Krishtin,
në jetën time
hyri një dashuri
aq e fuqishme
nga Perëndia
saqë e mori
atë urrejtje, e
ktheu përmbys
dhe e zbrazti.**

Jezu Krishtin. I thashë: “Unë kam vendosur besimin tim në Krishtin, kam marrë faljen e Perëndisë, e kam ftuar Atë në jetën time dhe Ai më ka ndryshuar. Nuk mund të ta shpjegoj të gjithën, babi, por Perëndia ma ka larguar urrejtjen dhe e ka zëvendësuar me dashuri. Unë të dua dhe të pranoj kështu siç je.”

Biseduam gati një orë dhe pastaj unë përjetova një nga emocionet më të mëdha të jetës time. Ky njeri që ishte babai im, ky njeri që më njëhte mua shumë mirë e që për pasojë nuk mund t'i hidhja hi syve, më pa e më

tha: “Bir, nëse Perëndia mund të bëjë në jetën time ato që kam parë se ka bërë në ty, atëherë edhe unë dua t’ia jap këtë mundësi. Dua t’i besoj Atij si Shpëtimtarit dhe Zotit tim.” Nuk mund të imagjinoj një mrekulli më të madhe se kjo.



Si mendoni?

Pse është e vështirë të veçohet besimi i krishtërimin nga njeriu Jezus Krisht? A mund ta kuptoni se si të dyja këto gjëra shihen shpesh si të kundërta me njëra-tjetrën?

Zakonisht, pasi një person pranon Krishtin, ndryshimet në jetën e tij ose të saj ndodhin në një periudhë prej disa ditësh, javësh, muajsh ose edhe vitesh. Në jetën time ndryshimi ndodhi për rreth gjashtë deri tetëmbëdhjetë

muaj. Por jeta e babait tim ndryshoi para syve të mi. Ishte sikur Perëndia të kishte zbritur e të kishte ndezur dritën në të.

As më parë e as më pas nuk kam parë një ndryshim kaq dramatik. Babai im ka prekur pije alkoolike vetëm një herë që atëherë. E çoi deri te buzët dhe pastaj, pa e pirë, e flaku tutje. Përgjithmonë. Unë mund të arrij vetëm në një përfundim për këtë: Marrëdhënia me Jezu Krishtin të ndryshon jetën.

Ju mund të qeshni me krishtërimin, mund ta tallni e ta quani qesharak. Por krishtërimi ka efekt. Ai të ndryshon jetën. Në fakt duhet të them Jezu Krishti të ndryshon jetën. Krishtërimi nuk është fe, nuk është sistem, nuk është ide etike, nuk është fenomen psikologjik. Është person. Nëse besoni në Krishtin, filloni të vëzhgoni

sjelljet dhe veprimet tuaja, sepse Jezu Krishti ka marrë përsipër t'ua ndryshojë jetën.

Kështu pra, siç edhe mund ta shihni, gjetja e besimit tim në Krishtin ka qenë një proces, i cili filloi me një kërkim kryeneç dhe që u shndërrua në një jetë të ndryshuar. Duket se shumë njerëz sot kanë nevojë për atë jetë të re që gjeta unë, por nuk janë gati ta vënë krishtërimin në provë. Ndoshta një pjesë e ngurrimit të tyre vjen nga vështirësia për të pranuar diçka si të vërtetë absolute kur sot theksi vihet mbi tolerancën dhe multikulturalizmin. Ose ndoshta ky ngurrim buron nga frika se mos eksplorimi më shumë do të ngrinte dyshime mbi besimin tek Krishti sesa ta vërtetonte atë.

A përbën pengesë për besimin në Krishtin puna kërkimore? Jo sipas Edwin Jamauçit, një nga ekspertët botërorë të historisë së lashtë. Jamauçi, i cili është diplomuar disa herë nga Universiteti Brendis, shprehet në mënyrë të prerë: “Për mua, provat historike e kanë përforcuar përkushtimin tim ndaj Jezus Krishtit si Biri i Perëndisë që na do dhe që vdiq për ne dhe u ringjall nga të vdekurit. Kaq e thjeshtë është.”¹

Kur e pyetën nëse studimi historik i Dhiatës së Re e kishte dobësuar besimin e tij, eksperti i dorëshkrimeve të lashta, Brus Mexger u përgjigj menjëherë: “Ky studim ma ka përforcuar besimin. Kam bërë pyetje tërë jetën time. Kam gërmuar tekstin, e kam studiuar imtësisht dhe sot e di me siguri se besimi im në Jezusin ka qenë me baza të sakta, shumë të sakta...”²

Citime të tilla si këto prej dy studiuesve të respektuar

Krishtërimi nuk është fe; nuk është një sistem; nuk është një ide etike; nuk është një fenomen psikologjik. Ai është një person. Nëse besoni në Krishtin, filloni të vëzhgoni sjelljet dhe veprimet tuaja, sepse Jezu Krishti ka marrë përsipër t'ua ndryshojë jetën.

e mbështesin qëllimin tim për shkruarjen e këtij libri të vogël. Jam përpjekur t'ju tregoj se identiteti, fjalët dhe vepra e Krishtit qëndrojnë të patundura si fakte të forta historike, të konfirmuara nga provat e historisë, profecisë dhe arsyes. Njohja me këto fakte do t'ju japë një themel të qëndrueshëm e të besueshëm ku të mbaheni ndërsa ndërtoni jetën mbi to siç kam bërë unë dhe miliona të krishterë të tjerë.

Por pavarësisht fortësisë së fakteve dhe autenticitetit të përvojës, krishtërimi nuk është diçka që mund t'ua japësh njerëzve me zor. Besimi në Krishtin nuk mund t'i imponohet askujt. Ju jetoni jetën tuaj dhe unë jetoj jetën time. Ne të gjithë jemi të lirë t'i marrim vendimet vetë. Unë vetëm mund t'ju tregoj ato që kam mësuar. Pas kësaj, se çfarë bëni me to është puna juaj.

Ndoshta lutja që bëra unë do t'ju ndihmojë: “Zot Jezus, kam nevojë për Ty. Të falenderoj që vdiqe për mua në kryq. Më fal dhe më pastro. Që në këtë moment unë të besoj Ty si Shpëtimtarin dhe Zotin tim. Më bëj ashtu si doje të isha kur më krijove. Amen.”

SHËNIMET:

Kapitulli 2: Çfarë e bën Jezusin kaq të ndryshëm?

1. Augustus H. Strong, Systematic Theology (Philadelphia: Judson Press, 1907), 1:52.
2. Archibald Thomas Robertson, Word Pictures in the New Testament (New York: Harper & Brothers, 1932), 5:186.
3. Leon Morris, "The Gospel According to John," The New International Commentary on the New Testament (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1971), 524.
4. Charles F. Pfeiffer and Everett F. Harrison, eds., the Wycliffe Bible Commentary (Chicago: Moody, 1962), 943–44.
5. Lewis Sperry Chafer, Systematic Theology (Dallas: Dallas Theological Seminary Press, 1947), 5:21.
6. Robert M. Bowman and J. Ed Komoszewski, Putting Jesus in His Place: The Case for the Deity of Christ (Grand Rapids, MI: Kregel, 2007), 246–47.
7. Robert Anderson, The Lord from Heaven (London: James Nisbet, 1910), 5.
8. Henry Barclay Swete, The Gospel According to St. Mark (London: Macmillan, 1898), 339.
9. Irwin H. Linton, The Sanhedrin Verdict (New York: Loizeaux Bros., 1943), 7.
10. Charles Edmund Deland, The Mis-Trials of Jesus (Boston: Richard G. Badger, 1914), 118–19

Kapitulli 3: Zot, Gënjeshhtar, apo i Çmendur?

1. C. S. Lewis, Mere Christianity (New York: Macmillan, 1960), 40–41.
2. F. J. A. Hort, Way, Truth, and the Life (New York: Macmillan, 1894), 207.
3. Kenneth Scott Latourette, A History of Christianity (New York: Harper & Row, 1953), 44, 48.
4. William E. Lecky, History of European Morals from Augustus to Charlemagne (New York: D. Appleton, 1903): 2:8–9.
5. Philip Schaff, History of the Christian Church (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1962), 109.
6. Philip Schaff, The Person of Christ (New York: American Tract Society, 1913), 94–95.
7. Clark H. Pinnock, Set Forth Your Case (Nutley, NJ: Craig Press, 1967), 62.
8. Gary R. Collins, quoted in Lee Strobel, The Case for Christ (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1998), 147.
9. James T. Fisher and Lowell S. Hawley, A Few Buttons Missing (Philadelphia: Lippincott, 1951), 273.
10. C. S. Lewis, Miracles: A Preliminary Study (New York: Macmillan, 1947), 113.
11. Schaff, The Person of Christ, 97.
12. Dan Brown, The Da Vinci Code, 233.
13. Ignatius of Antioch, Letter to the Ephesians, kapitulli 7.
14. Alexander Roberts, First Apology, The Ante-Nicene Fathers, vol. 1 (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1993), 184.
15. Irenaeus, Proof of the Apostolic Preaching, kapitulli 47.
16. Pliny, Letters and Panegyricus, trans. Betty Radice, Loeb Classical Library (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1969): 10.96(2.289). 1

17. J. Ed Komoszewski, M. James Sawyer, Daniel B. Wallace, Reinventing Jesus (Grand Rapids, MI: Kregel, 2006), 215.

Kapitulli 4: Po Shkenca?

1. Enciklopedia e re Britanike: Micropaedia, 15th ed., s.v. “metoda shkencore.”
2. James B. Conant, Science and Common Sense (New Haven, CT: Yale University Press, 1951), 25.

Kapitulli 5: Sfïdat e Ateizmit të Ri

1. John F. Haight, God and the New Atheism (Louisville, KY: Westminster John Knox Press, 2008), 22.
2. Sam Harris, Letter to a Christian Nation (New York: Vintage Books, 2006), ix.
3. Richard Dawkins, The God Delusion, botrimi i 2-të me hyrje (New York: Mariner Books, 2008), 58.
4. Christopher Hitchens, God Is Not Great: How Religions Poisons Everything (New York: Têelve, 2007), 122, 5.
5. Marrë nga një letër drejtuar W. Graham (3 Korrik 1881), cituar në Autobiografinë e Çarls Darvinit dhe Letra të Zgjedhura (1892; ribotuar, New York: Dover, 1958).
6. Paul Davies, “What Happened Before the Big Bang?” në “God for the 21st Century”, redaktuar nga Russell Stannard (Philadelphia: Templeton Foundation Press, 2000), 12.
7. John C. Lennox, God’s Undertaker: Has Science Buried God? (Oxford, England: Lion Hudson, 2007), 22-25.
8. Alfred North Whitehead, Science and the Modern World (New York: The Macmillan Company, 1925), 17.
9. Cituar nga John C. Lennox, God’s Undertaker: Has Science Buried God? (Oxford, England: Lion Hudson, 2007), 20.
10. Hitchens, God Is Not Great, 63–67.
11. Harris, Letter to a Christian Nation, 72.
12. Hitchens, God Is Not Great, 151.
13. William A. Dembski and Sean McDowell, Understanding Intelligent Design (Eugene, OR: Harvest House, 2008).
14. Antony Flew and Roy Abraham Varghese, There Is a God: How the World’s Most Notorious Atheist Changed His Mind (New York: HarperCollins, 2007), 88.
15. George M. Whitesides, “Revolutions in Chemistry” (Priestly Medalist address), Chemical & Engineering News 85(13) (26 Mars 2007): 12–17, mund të gjëndet online në adresën <http://pubs.acs.org/cen/coverstory/85/8513cover1.html> (e hapur për herë të fundit në 23 Prill 2007).
16. Harris, Letter to a Christian Nation, 71.
17. Richard Dawkins, The Blind Watchmaker (New York: Norton, 1987), 17–18.
18. Bill Gates, The Road Ahead (Boulder, CO.: Blue Penguin, 1996), 228.
19. Dawkins, The God Delusion, 168.
20. Flew and Varghese, There Is a God, 132.
21. Freeman J. Dyson, Disturbing the Universe (New York: Harper & Row, 1979), 250.

22. Cituar nga Paul Davies, *The Accidental Universe* (Cambridge:Cambridge University Press, 1982), 118.
23. Paul Davies, *Superforce: The Search for a Grand Unified Theory of Nature* (New York: Simon and Schuster, 1984), 242.
24. Stephen Hawking, *A Brief History of Time* (Neë York: Bantam Books, 1996), 126.
25. Walter L. Bradley, "The 'Just So' Universe," në librin "Signs of Intelligence", redaktuar nga William A. Dembski and James M. Kushiner (Grand Rapids, MI.: Brazos Press, 2001), 169.
26. Roger Penrose, *The Emperor's New Mind* (New York: Oxford, 1989), 344.
27. Paul Davies, *Cosmic Jackpot* (New York: Houghton Mifflin, 2007), 149.
28. Dawkins, *The God Delusion*, 258.
29. Në të njëjtin libër, 35.
30. Sam Harris, *The End of Faith: Religion, Terror, and the End of Reason* (New York: W.W. Norton, 2005), 35.
31. Dinesh D'Souza, *What's So Great about Christianity* (Washington, D.C.: Regnery, 2007), 207.
32. Në të njëjtin libër, 214.
33. David Berlinski, *The Devil's Delusion: Atheism and Its Scientific Pretensions* (New York: Crown Forum, 2008), 26.

Kapitulli 6: A janë të besueshme dokumentet biblike?

1. Millar Burrows, *What Mean These Stones? The Significance of Archeology for Biblical Studies* (New York: Meridian Books, 1956), 52.
2. William F. Albright, *Recent Discoveries in Bible Lands* (New York: Funk and Wagnalls, 1955), 136.
3. William F. Albright, *Christianity Today*, nr. 7 (18 Janar 1963): 3.
4. Sir William Ramsay, *The Bearing of Recent Discovery on the Trustworthiness of the New Testament* (London: Hodder and Stoughton, 1915), 222.
5. John A. T. Robinson, *Redating the New Testament* (London: SCM Press, 1976).
6. Simon Kistemaker, *The Gospels in Current Study* (Grand Rapids, MI: Baker, 1972), 48–49.
7. A. H. McNeile, *An Introduction to the Study of the New Testament* (London: Oxford University Press, 1953), 54.
8. Paul L. Maier, *First Easter: The True and Unfamiliar Story in Words and Pictures* (New York: Harper & Row, 1973), 122.
9. William F. Albright, *From the Stone Age to Christianity*, second edition (Baltimore: John Hopkins Press, 1946), 297–98.
10. Jeffery L. Sheler, *Is The Bible True?* (New York: HarperCollins Publishers, 1999), 41.
11. Dan Brown, *The Da Vinci Code*, 231.
12. Philip Jenkins, *Hidden Gospels: How the Search for Jesus Lost Its Way* (New York: Oxford University Press, 2001), 83.
13. Cituar në librin "Hidden Gospels" nga Philip Jenkins, 98–99.
14. Chauncey Sanders, *Introduction to Research in English Literary History* (Neë York: Macmillan, 1952), 143 e në vazhdim.
15. F. F. Bruce, *The New Testament Documents: Are They Reliable?* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1964), 16.

16. Bruce Metzger, cituar nga Lee Strobel në librin "The Case for Christ" (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1998), 60.
17. Korrespondencë personale me Dan Eallace, 6 Janar 2003.
18. Jacob Klausner, cituar nga Will Durant, Caesar and Christ: The Story of Civilization, Pjesa 3 (New York: Simon and Schuster, 1944), 557.
19. Sir Frederic Kenyon, The Bible and Archaeology (New York: &Row, 1940), 288–89.
20. Stephen Neill, The Interpretation of the New Testament (London: Oxford University Press, 1964), 78.
21. Craig L. Blomberg, "The Historical Reliability of the New Testament," në librin "Reasonable Faith" i autorit William Lane Craig (Wheaton, IL: Crossway, 1994), 226.
22. J. Harold Greenlee, Introduction to New Testament Textual Criticism (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1954), 16.
23. Cituar nga J. Ed Komoszewski, M. James Sawyer, Daniel B. Wallace, në librin "Reinventing Jesus", 215.
24. Në të njëjtin libër, 109.
25. John Warwick Montgomery, Where Is History Going? (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1969), 46.
26. Louis R. Gottschalk, Understanding History (New York: Knopf, 1969), 150.
27. John McRay, cituar nga Strobel, The Case for Christ, 97.
28. Lynn Gardner, Christianity Stands True (Joplin, MO.: College Press, 1994), 40.
29. Norman L. Geisler, Christian Apologetics (Grand Rapids, MI: Baker, 1988), 316.
30. F. F. Bruce, The New Testament Documents, 33.
31. Lawrence J. McGinley, Form Criticism of the Synoptic Healing Narratives (Woodstock, MD: Woodstock College Press, 1944), 25.
32. David Hackett Fischer, Historian's Fallacies: Toward a Logic of Historical Thought, cituar nga Norman L. Geisler, Why I Am A Christian (Grand Rapids, MI: Baker, 2001), 152.
33. Robert Grant, Historical Introduction to the New Testament (New York: Harper & Row, 1963), 302.
34. Will Durant, Caesar and Christ, 557.
35. Gottschalk, Understanding History, 161.
36. Eusebius, Ecclesiastical History, libri 3, kap. 39.
37. Irenaeus, Against Heresies, 3.1.1.
38. Gary Habermas, The Historical Jesus: Ancient Evidence for the Life of Christ (Joplin, MO: College Press, 1997), 224.
39. Joseph Free, Archaeology and Bible History (Wheaton, IL: Scripture Press, 1964), 1.
40. F. F. Bruce, "Archaeological Confirmation of the New Testament," Revelation and the Bible, redaktuar nga Carl Henry (Grand Rapids, MI: Baker, 1969), 331.
41. A. N. Sherwin-White, Roman Society and Roman Law in the New Testament (Oxford: Clarendon Press, 1963), 189.
42. Clark H. Pinnock, Set Forth Your Case (Nutley, NJ: Craig Press, 1968), 58.
43. Douglas R. Groothuis Jesus in an Age of Controversy (Eugene, OR: Harvest House, 1996), 39.

Kapitulli 7: Kush do të vdiste për një gënjeshtër?

1. Asnjë nga këto vdekje, përveç asaj të Jakobit të Zebedeut nuk është shkruar në Dhiatën e Re. Megjithëse martirizimi i shumicës prej tyre konfirmohet nga burime të tjera historike, disa nga metodat me të cilat u vranë na kanë ardhur nga tradita e vjetër.
2. Richard Bauckham, *Jesus and the Eyewitnesses* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 2006).
3. Flavius Josephus, *Antiquities of the Jews*, xx, 9:1.
4. J. P. Moreland, cituar nga Lee Strobel, *The Case for Christ* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1998), 248.
5. Edward Gibbon, cituar nga Philip Schaff, *History of the Christian Church* (Peabody, MA.: Hendrickson Publishers, 1996), kap. 3.
6. Michael Green, "Editor's Preface" in George Eldon Ladd, *I Believe in the Resurrection of Jesus* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1975), vii.
7. Blaise Pascal, cituar nga Robert W. Gleason, ed., *The Essential Pascal*, trans. G. F. Pullen (New York: Mentor-Omega Books, 1966), 187.
8. J. P. Moreland, cituar nga Strobel, *The Case for Christ*, 246–47.
9. Michael Green, *Man Alive!* (Doëners Grove, IL: InterVarsity, 1968), 23–24.
10. Citim nga J. N. D. Anderson, "The Resurrection of Christ," *Christianity Today* (29 Mars 1968).
11. Kenneth Scott Latourette, *A History of Christianity* (New York: Harper & Brothers Publishers, 1937), 1:59.
12. N. T. Wright, *Jesus: The Search Continues*. Teksti i kësaj video mund të gjendet duke kërkuar "Jezusi: Kërkimi vazhdon" (Jesus: The Search Continues) në faqen e internetit të "the Ankerberg Theological Research Institute" www.johnankerberg.org.
13. Paul Little, *Know Why You Believe* (Wheaton, IL: Scripture Press, 1971), 63.
14. Herbert B. Workman, *The Martyrs of the Early Church* (London: Charles H. Kelly, 1913), 18–19.
15. Harold Mattingly, *Roman Imperial Civilization* (London: Edward Arnold Publishers, 1967), 226.
16. Tertullian, cituar nga Gaston Foote, *The Transformation of the Twelve* (Nashville: Abingdon, 1958), 12.
17. Simon Greenleaf, *An Examination of the Testimony of the Four Evangelists by the Rules of Evidence Administered in the Courts of Justice* (Grand Rapids, MI: Baker, 1965), 29.
18. Lynn Gardner, *Christianity Stands True* (Joplin, MO.: College Press, 1994), 30.
19. Korrespondencë personale me Tom Anderson, 6 Janar 2003.
20. J. P. Moreland *Scaling the Secular City* (Grand Rapids, MI: Baker, 1987), 137.
21. William Lane Craig, cituar nga Strobel, *The Case for Christ*, 220.

Kapitulli 8: Ç'na duhet një Mesi i vdekur?

1. *Encyclopedia International* (New York: Grolier, 1972): 4:407.
2. Ernest Findlay Scott, *Kingdom and the Messiah* (Edinburgh: T. & T. Clark, 1911), 55.
3. Joseph Klausner, *The Messianic Idea in Israel* (New York: Macmillan, 1955), 23.

4. Jacob Gartenhaus, "The Jewish Conception of the Messiah," Christianity Today (13 Mars 1970); 8–10.
5. Jewish Encyclopaedia (New York: Funk and Wagnalls, 1906): 8:508.
6. Millar Burrows, More Light on the Dead Sea Scrolls (London: Secker & Warburg, 1958), 68.
7. A. B. Bruce, The Training of the Twelve (Grand Rapids, MI: Kregel, 1971), 177.
8. Alfred Edersheim, Sketches of Jewish Social Life in the Days of Christ (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1960), 29.
9. George Eldon Ladd, I Believe in the Resurrection of Jesus (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1975), 38.

Kapitulli 9: A keni dëgjuar se çfarë i ndodhi Saulit?

1. Encyclopaedia Britannica, s.v. "Paul, Saint."
2. Jacques Dupont, "The Conversion of Paul, and Its Influence on His Understanding of Salvation by Faith," Apostolic History and the Gospel, ed. W. Ward Gasque and Ralph P. Martin (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1970), 177.
3. Encyclopaedia Britannica, s.v. "Paul, Saint."
4. Një të njëjtin material.
5. Kenneth Scott Latourette, A History of Christianity (New York: Harper & Row, 1953), 76.
6. W. J. Sparrow-Simpson, The Resurrection and the Christian Faith (Grand Rapids, MI: Zondervan Publishing House, 1968), 185–86.
7. Dupont, "The Conversion of Paul, and Its Influence on His Understanding of Salvation by Faith," 76.
8. Philip Schaff, History of the Christian Church (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1910): 1:296.
9. Encyclopaedia Britannica, s.v. "Paul, Saint."
10. Archibald McBride, cituar në "Chambers's Encyclopedia" (London: Pergamon Press, 1966): 10: 516.
11. Clement, cituar nga Philip Schaff, History of the Apostolic Church (New York: Charles Scribner, 1857), 340.
12. George Lyttleton, The Conversion of St. Paul (New York: American Tract Society, 1929), 467.

Kapitulli 10: A mund të rrëzohet njeriu i mirë?

1. Alexander Metherell, cituar nga Lee Strobel, The Case for Christ (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1998), 195–96.
2. John Dominic Crossan, Jesus: A Revolutionary Biography (New York: HarperOne, 1995), 145.
3. George Currie, The Military Discipline of the Romans from the Founding of the City to the Close of the Republic. Një pjesë e shkëputur nga teza e tij publikuar nga Universiteti i Indianës, 1928, 41–43.
4. A. T. Robertson, Word Pictures in the New Testament (New York: R. R. Smith, 1931), 239.
5. Arthur Michael Ramsey, God, Christ and the World (London: SCM Press, 1969), 78–80.
6. James Hastings, ed., Dictionary of the Apostolic Church (New York: C. Scribner's Sons, 1916): 2:340.

Më shumë se zdrukthëtar

7. Paul Althaus, cituar nga Wolfhart Pannenberg, *Jesus—God and Man*, trans. Lewis L. Wilkins and Duane A. Priebe (Philadelphia: Westminster Press, 1968), 100.
8. Paul L. Maier, "The Empty Tomb as History," *Christianity Today* (28 Mars 1975): 5.
9. Josh McDowell, *Evidence That Demands a Verdict* (San Bernadino, CA: Campus Crusade for Christ International, 1973), 231.
10. David Frederick Strauss, *The Life of Jesus for the People* (London: Ëilliams and Norgate, 1879): 1: 412.
11. J. N. D. Anderson, *Christianity: The Witness of History* (London: Tyndale Press, 1969), 92.
12. John Warwick Montgomery, *History and Christianity* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1972), 78.
13. Jeffrey Jay Lowder, "Historical Evidence and the Empty Tomb Story" in *The Empty Tomb: Jesus Beyond the Grave*, Jeffrey Jay Lowder and Robert Price, eds. (Amherst, MA: Prometheus, 2005), 267.
14. Cituar nga Lee Strobel, *The Case for the Real Jesus*, 146.
15. Stephen T. Davis, "The Counterattack of the Resurrection Skeptics," në *Philosophia Christi*, vol. 8, no. 1 (2006): 55.
16. Paul Rhodes Eddy and Gregory A. Boyd, *The Jesus Legend* (Grand Rapids: Baker Books, 2007), 142.
17. T. N. D. Mettinger, *The Riddle of Resurrection: "Dying and Rising Gods" in the Ancient Near East* (Stockholm: Almqvist and Wiksell, 2001), 221.
18. Thomas Arnold, *Christian Life—Its Hopes, Its Fears, and Its Close* (London: T. Felloëes, 1859), 324.
19. Brooke Foss Westcott, cituar në Paul E. Little, *Knock on Your Door: You Believe* (Eheaton, IL: Scripture Press, 1967), 70.
20. William Lane Craig, *Jesus: The Search Continues*. Teksti i kësaj video mund të gjendet duke kërkuar "Jesus: The Search Continues" në faqen e internetit të "the Ankerberg Theological Research Institute" (www.johnankerberg.org)
21. Simon Greenleaf, *An Examination of the Testimony of the Four Evangelists by the Rules of Evidence Administered in the Courts of Justice* (Grand Rapids, MI: Baker, 1965), 29.
22. Sir Lionel Luckhoo, cituar nga Strobel, *The Case for Christ*, 254.
23. Frank Morison, *Who Moved the Stone?* (London: Faber and Faber, 1930).
24. George Eldon Ladd, *I Believe in the Resurrection of Jesus* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1975), 141.
25. Gary Habermas and Anthony Flew, *Did Jesus Rise from the Dead? The Resurrection Debate* (San Francisco: Harper & Row, 1987), xiv.
26. Lord Darling, cituar nga Michael Green, *Man Alive!* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1968), 54.

Kapitulli 11: A mund të ngrihet më këmbë Mesia i vërtetë, ju lutem?

1. Për një diskutim më të plotë rreth profecive të librit të Danielit kapitulli 9 shikoni librin e Xhosh MekDauell, *The New Evidence That Demands a Verdict* (Nashville: Nelson, 1999), 197–201.
2. Mateu ia atribuon pasazhin e cituar në kapitullin 27:9-10 profeti Jeremia, por pasazhi në fakt është cituar nga profeti Zakaria 11:11-13.

Kjo “ngatërresë” në fakt sqarohet shumë lehtë kur e kuptojmë se si ishin organizuar shkrimet e shenjta të hebrenjve. Shkrimet hebreje ishin të ndara në tre ndarje të mëdha: ligji, shkrimet, dhe profetët. Libri i profetit Jeremia ishte i pari në listën e ndarjes së profetëve. Për këtë arsye, shpesh, studiuesit hebreje në vend që të citonin specifikisht profetin të cilit po i referoheshin, thjesht citonin koleksionin e shkrimeve profetike duke përdorur emrin e profetit që kishte librin e parë në koleksion – dmth Jeremian.

3. H. Harold Hartzler, nga parathënia e librit “Science Speaks” të autorit Peter W. Stoner, (Chicago: Moody, 1963).
4. Stoner, Science Speaks, 107.
5. Në të njëjtin libër.

Kapitulli 13: Ai ndryshoi jetën time

1. Edwin Yamauchi, cituar nga Lee Strobel, The Case for Christ (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1998), 90.
2. Bruce Metzger, cituar nga Strobel, The Case for Christ, 71.

Rreth autorëve

Xhosh Mek-Douell është diplomuar me master në teologji nga Universiteti Teologjik Talbot në Kaliforni. Në vitin 1964 ai u bashkua me organizatën *Instituti Jeta e Re* dhe prej asaj kohe ka udhëtuar në shumë vende të botës, duke u përqendruar në tema tërheqëse për të rinjtë.

Xhoshi ju ka folur më shumë se 10 milion të rinjve në rreth 84 vende të botës, pjesa më e madhe e këtyre bisedave ka ndodhur në qendra të ndryshme universitare. Ai ka shkruar (vetëm dhe në bashkëpunim me autorë të tjerë) më shumë se 110 libra, të cilat janë botuar në më shumë se 35 milion kopje në gjithë botën. Ndër librat e tij më të njohur renditën: *Provat që kërkojnë vendim*, *Dashuria e vërtetë pret*, romanin *Dëshmitari* etj.

Xhoshi dhe gruaja e tij Doti, jetojnë në Kaliforni dhe kanë katër fëmijë të rritur.

Shon Mekdouell është një mësues, autor dhe folës i respektuar. Ai u diplomua me rezultate të shkëlqyera në Universitetin Teologjik të Talbotit në Kaliforni, me dy mastera: në teologji dhe filozofi. Ai është autor i disa librave ndër të cilët: “Etika: Të jesh i guximshëm në çfarëdolloj botë”, bashkautor i librit “Të kuptojmë teorinë e mendjes inteligjente”, dhe “Dëshmi rreth ringjalljes”.

Shoni është nderuar me çmimin “Mësuesi i vitit” për zonën e San Juan Capistrano në vitin 2008. Ai është ftuar në programe të ndryshme radiofonike. Mund ta lexoni mendimet e Xhosh në blogun e tij në anglisht www.seanmcdowell.org.

Në Prill të vitit 2000, Shon u martua me Stefaninë. Ata kanë dy fëmijë, Skotin dhe Shonën, dhe jetojnë në Kaliforni.

Historia e Tij Mund të Ndryshojë Jetën Tënde

Kur ishte i ri, Xhosh Mek-Dauelli e quante veten agnostik dhe mendonte se krishterimi ishte i kotë. Madje vendosi t'i luftonte të krishterët, duke u përpjekur të hidhte poshtë thëniet e Krishtit se ishte Zot. Por, për çudinë e tij, zbuloi se provat tregonin të kundërtën: Jezu Krishti nuk ishte thjesht një zdrukthëtar i zakonshëm hebre, po vetë Zoti, ashtu siç deklaronte që ishte.

Që nga botimi i parë, në vitin 1977, ky libër i ka nxitur lexuesit të bëjnë pyetjen: “Cili është Jezusi?” Xhosh Mek-Dauelli i ndihmon ata që t'i përgjigjen kësaj pyetjeje dhe të vendosin vetë, në bazë të informacionit, fakteve shkencore dhe historike që sjell për Biblën, për Jesusin dhe ringjalljen e Tij, nëse Ai ishte gënjeshtar, i çmendur apo Zot.

Libri lexohet si një dokument personal kërkimor, i cili i rreshton me saktësi faktet nga burime të besueshme që vijnë nga shkencëtarë laikë e nga teologë konservatorë.

Gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe e kuptueshme për të gjithë, pa shumë terma teologjikë.

Ky libër që numëron sot më shumë se 15 milionë kopje të shitura dhe që është përkthyer në shumë gjuhë të botës, ka ndikuar jetët e miliona njerëzve.

Botimi që keni në dorë është një ripunim i materialit origjinal që ka bërë autori Xhosh

Mek-Dauell, bashkë me djalin e tij, Shonin.

“Cili ishte Jezu Krishti në të vërtetë?”

“A ishte vërtet Zoti që thoshte se ishte?”

“Si ta dimë me siguri?”

“A kanë të drejtë ateistët?”

Lexoni historinë, peshoni faktet, përjetoni dashurinë e Tij dhe pastaj shikoni se çfarë do të ndodhë.

ISBN 978-99956-851-4-0



9 789995 685140 >



info@ijr.al
www.ijr.al